

KOALICIONI PËR PËRGATITJEN E RAPORTEVE ALTERNATIVE NË SHQIPËRI

Albanian Coalition for the Preparation of the Alternative Reports - ACPAR

**RAPORTI I OJF-ve
MBI SITUATËN E GRAVE DHE
VAJZAVE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Me ndihmën e:

Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri

Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare

Qendra e Aleancës Gjimore për Zhvillim

Qendra për Popullsinë dhe Zhvillimin

Qendra “VATRA”

Qendra për Zhvillimin e Grave Rurale

Qendra e Informacionit dhe Kërkimeve për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri

Shërbimi Ligjor Falas Tiranë

Shoqata “Refleksione”

Shoqata e Personave që Jetojnë me HIV/AIDS në Shqipëri

Unioni “Amaro Drom”

Nisma për Të Drejtat e Grave (Chemonics International. Inc)

Grupi Shqiptar për të Drejtat e Njeriut

Redaktuar nga:

ALTIN HAZIZAJ

ME MBËSHTETJEN E:



Tiranë, Dhjetor 2006



Refleksione
Gjërat janë gati të ndryshojnë



Njoftim për Copyright-in
Ky botim është copyright © 2006
i Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri / DCI Shqipëri
(CRCA – Tiranë / Shqipëri)

Të gjithë lexuesit janë të lejuar të printojnë, kopjojnë ose shpërndajnë pjesë ose të gjithë botimin, por gjithmonë duke bërë të qartë dhe duke i dhënë atributin kryesor Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri - CRCA. Ky botim nuk mund të shitet pa lejen me shkrim të CRCA.

Opinionet e shprehura në këtë botim jo detyrimisht shprehin ose përfaqësojnë politikën ose opinionet e CRCA ose ato të Olof Palme International Center dhe SIDA.

Financuar nga: Olof Palme International Center dhe SIDA

Botuar nga CRCA / DCI, Tiranë

Botuar në Shqipëri, Dhjetor 2006

HYRJJE DHE FALENDERIME

Gjatë vitit 2006, Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri - CRCA, një nga organizatat kryesore të shoqërisë civile në vend, inicioi krijimin e Koalicionit për Përgatitjen e Raporteve Alternative në Shqipëri, me qëllim kryesor jo vetëm përgatitjen e raporteve alternative për Konventat e OKB-së të ratifikuara nga shteti shqiptar, por njëkohësisht edhe koordinimin e përgjigjes së OJF-ve ndaj shkeljeve të të drejtave të njeriut në vend.

Kësaj iniciative të CRCA iu përgjigjën një grup i madh i organizatave të të drejtave të njeriut, grave, fëmijëve dhe minoriteteve në Shqipëri, duke treguar edhe një here organizimin e mirë të shoqërisë civile në vend, si dhe kapacitetet e ngritura nga sektori i tretë gjatë 16 viteve të tranzicionit.

Shkrimi i një Raporti Alternativ nuk është një detyrë e lehtë. Gjatë këtyre viteve shumë pak OJF janë përfshirë në shkrimin e Raporteve Alternative për Konventat e OKB-së, si psh CRCA, GSHDNJ, KSHH dhe CLCI, prandaj krijimi i Koalicionit ishte një sprovë për të gjithë OJF-të në Shqipëri për të parë nëse një grup kaq i gjerë mund të koordinohet dhe shkruante një raport të plotë, në rastin konkret Raportin Alternativ për Konventën CEDAW. Gjatë këtyre muajve të gjitha organizatat së bashku kanë ngritur një bashkëpunim të shkëlqyer të koordinimit të punës, shkëmbimit të informacionit dhe shkrimit të një Raporti Alternativ. Kjo mund të shërbejë si një proces model për koalicione të tjera brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Sa më sipër dëshirojmë të shprehim falenderimet tona për të gjitha organizatat dhe individët që iu përgjigjën pozitivisht dhe u bënë pjesë e Koalicionit për Përgatitjen e Raporteve Alternative në Shqipëri. Këto organizata janë: Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, Qendra e Aleancës Gjinore për Zhvillim, Qendra për Popullsinë dhe Zhvillimin, Qendra “VATRA”, Shërbimi Ligjor Falas Tiranë, Shoqata “Refleksione”, Unioni “Amaro Drom”, Qendra për Zhvillimin e Grave Rurale dhe Nisma për Të Drejtat e Grave (Chemonics International. Inc).

Falenderime të veçanta i shprehim të gjithë ekspertëve të OJF-ve të angazhuara në shkrimin e raportit.

Kjo iniciativë është mbështetur nga Olof Palme International Center dhe SIDA dhe për këtë gjejmë rastin të falenderojmë zyrat respektive, jo vetëm për mbështetjen që i kanë dhënë CRCA-s gjatë këtyre viteve, por dhe mbështetjen që i japin forcimit të sektorit të shoqërisë civile dhe rritjes së respektimit të të drejtave të njeriut në Shqipëri.

Duke patur parasysh detyrimet e Shtetit shqiptar si palë në një sërë konventash ndërkombëtare të të drejtave të njeriut pranë OKB-së, Koalicioni për Nxitjen e Përgatitjes së Raporteve Alternative do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2007 të rishikojë sesi i ka përmbushur detyrimet e tij Shteti shqiptar për zbatimin e standarteve të të drejtave të njeriut të OKB-së, si dhe zbatimin e rekomandimeve të Komiteteve të OKB-së.

Së fundi, dëshirojmë të falenderojmë znj. Blerina Metaj, Koordinatore e Programit “Të drejtat e fëmijëve – një e drejtë demokratike”, për koordinimin, komunikimin dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet të gjithë anëtarëve të Koalicionit.

Av. Altin Hazizaj
Drejtor i CRCA

**RAPORTI I OJF-ve
MBI SITUATËN E GRAVE DHE
VAJZAVE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Përgatitur nga:

**KOALICIONI PËR PËRGATITJEN E
RAPORTEVE ALTERNATIVE NË SHQIPËRI**

Redaktuar nga:

ALTIN HAZIZAJ

Tiranë 2006

PËRMBAJTJA

	Faqe
1. Përmbledhje e Përgjithshme	7
2. Mjedisi politik në Shqipëri dhe të drejtat e grave	9
3. Raporti Alternativ CEDAW për Shqipërinë	12
- Neni 1 – Përkufizimi i diskriminimit	12
- Neni 2 – Detyrimet për të eleminuar diskriminimin	13
- Neni 3 – Nxitja e barazisë	21
- Neni 4 – Përsheptimi i barazisë ndërmjet burrit dhe gruas	23
- Neni 5 – Stereotipet e shoqërisë	25
- Neni 6 – Trafiku dhe prostitucioni	26
- Nenet 7, 8 – Diskriminimi në jetën politike dhe publike	32
- Neni 9 – Kombësia dhe shtetësia	39
- Neni 10 – Barazia e të drejtave kulturore dhe e drejta për t'u arsimuar dhe trainuar	40
- Neni 11 – Punësimi	44
- Neni 12 – Kujdesi shëndetësor dhe planifikimi familjar	49
- Neni 13 – Ekonomia dhe jeta sportive- kulturore	52
- Neni 14 – Gruaja rurale	53
- Neni 15 – Barazia përpara ligjit	56
- Neni 16 – Jeta private dhe familjare	58
4. Gruaja dhe media	60
5. Konkluzione	63
6. Rekomandime	71
7. Database i OJF-ve	76

LISTA E SHKURTIMEVE

CEDAW	Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave e OKB-së
CLCI	Qendra për Nisma Ligjore Qytetare
CRCA	Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri
CDRW	Qendra për Zhvillimin e Grave Rurale
GSHDNJ	Grupi Shqiptar për të Drejtat e Njeriut
GADC	Qendra e Aleancës Gjimore për Zhvillim
INSTAT	Instituti i Statistikave
KDF	Konventa për të Drejtat e Fëmijëve
KMB	Komiteti për Mundësi të Barabarta
KSHH	Komiteti Shqiptar i Helsinkit
QSH	Qeveria Shqiptare
MPÇSSHB	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
TLAS	Shërbimi Ligjor Falas Tiranë
UT	Universiteti i Tiranës

LISTA E GRAFIKEVE DHE TABELAVE

Grafik 1	Mekanizmi Shtetëror për Çështjet Gjimore
Grafik 2	Skema e Zbatimit të Ligjit për Barazinë Gjimore
Grafik 3	Struktura e Komitetit për Mundësi të Barabarta
Tabela 1	Grup mosha e grave dhe e vajzave të përfshira në trafikim
Tabela 2	Zonat nga vijat grate dhe vajzat e trafikuar
Tabela 3	Përbërja e Parlamentit, Qershor 2005
Tabela 4	Pjesëmarrja e Gruas në Qeveri, Qershor 2005

1. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Raporti Alternativ paraqet shkallën e zbatimit të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) në Shqipëri, të ratifikuar nga shteti palë në Maj 1994. Organizatat kontribuese në shkrimin e raportit janë përpjekur të analizojnë dhe të nxjerrin në pah arritjet dhe mangësitë në punën e Shtetit shqiptar, për të vënë në zbatim Konventën dhe Rekomandimet e Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit të Grave të OKB-së.

Legjislacioni shqiptar përmbush një pjesë të mirë të rekomandimeve të CEDAW-t. Ai ofron garanci të përgjithshme që të gjithë shtetasit shqiptarë kanë të drejtën e trajtimit të barabartë, pavarësisht nga gjinia. Megjithatë, këto ligje rrallë shkojnë përtej një deklarimi bazë për barazi. Realiteti paraqitet më problematik për gratë. Ligjet ekzistuese rrallë vihen në zbatim apo bëhen të detyrueshme. Mbizotëron një mungesë besimi në aftësinë e sistemit të drejtësisë për të zgjidhur problemet që prekin gratë, si për shembull diskriminimi gjinor. Natyra patriarkale e shoqërisë shqiptare vazhdon të bëhet përcaktuese e rolit të grave në shoqëri. Ndonëse shfaqen në mjaft fusha, pabarazia mes burrave dhe grave është më e theksuar në politikë dhe në marrëdhëniet familjare. Për fat të keq shteti shqiptar ka marrë vetëm disa masa të pakta kundër diskriminimit apo pengesave të tjera që ndeshin gratë.¹

Kushtetuta, së bashku me shtyllat kryesore të legjislacionit shqiptar, si Kodi Penal, Kodi Civil, Kodi i Punës dhe ai i Familjes janë miratuar pas ratifikimit të Konventës dhe instrumentave të tjerë ndërkombëtarë dhe europianë, kështu që pasqyrojnë pjesën më të madhe të parimeve të rëndësishme të të drejtave të njeriut, si barazia dhe mosdiskriminimi. Ligji për një Shoqëri Gjinore të Barabartë është më i fundit mes këtyre ligjeve dhe synon të garantojë jo vetëm barazi formale para ligjit, por edhe barazi të mundësive për burrat dhe gratë.

Megjithatë, këto ligje, nuk shoqërohen nga procedura dhe mekanizma të qarta, të tilla që t'i ndihmojnë qytetarët të mbrojnë të drejtat e tyre, ndërsa aktet nënligjore, të cilat bëjnë të mundur zbatimin në praktikë të këtyre ligjeve, ende mungojnë ose janë të paplota. Veç kësaj, disa ligje duken qartë që kanë nevojë për rishikim dhe ndryshime, si për shembull Kodi Penal, Ligji për Shërbimin Shëndetësor dhe Ligji për Sigurimet Shoqërore, ndërkohë që Shqipërisë i mungon ende legjislacioni për dhunën në familje.

Për t'iu përgjigjur drejt pjesëmarrjes së ulët të gruas në vendim-marrje, misionet diplomatike dhe përgjithësisht në postet drejtuese, kuotat ose sisteme të tjera të ngjashme mund të propozohen nga legjislacioni si masa të veçanta të përkohshme.

Ndërsa meshkujt dhe femrat konsiderohen të barabartë para ligjit, në realitet, femrat diskriminohen në të gjitha fushat e jetës. Edhe në rastet kur barazia përpara ligjit ekziston teknikisht, mekanizmat për zbatim nuk ekzistojnë ose janë joefektive; informacioni për zbatimin e ligjeve mungon.

Stereotipet e roleve gjinore dhe natyra patriarkale e shoqërisë janë pengesa kryesore për të arritur përputhjen me CEDAW. Shumë femra dhe meshkuj nuk e njohin diskriminimin gjinor si të tillë, por në fakt e shohin atë thjesht si një "mënyrë jetese." Pabarazia është veçanërisht e dukshme në tre fusha: politikë (udhëheqje dhe vendim-marrje), ekonomi (punësim dhe gjenerim i të ardhurave), dhe marrëdhëniet në martesë dhe familje.

Në fushën politike, numri i grave të zgjedhura në pozita shtetërore ra në mënyrë të dukshme gjatë viteve 1990-të dhe ky numër vazhdon të mbetet i ulët.

Në fushën ekonomike, tranzicioni ka goditur veçanërisht seriozisht gratë përse i përket punësimit. Gratë janë përjashtuar nga sektorë të ndryshëm të punës; kjo lidhet me atë se si gratë përkufizohen (kryesisht për t'u kujdesur për familjen), moshën e tyre, paragjykimet rreth aftësive të grave për të kryer detyra të shkallëve të ndryshme të vështirësisë, dhe mungesën e besimit që gratë mund të japin po aq rezultate sa dhe burrat nëse punësohen në nivele të larta. Gratë nuk kanë pushtet ekonomik. Pozicioni i tyre ekonomik ka patur një influencë negative në aftësinë e tyre për të marrë pjesë në sektorin e biznesit. Për shembull, gratë kanë vëshirësi për të marrë kredi financiare, sepse ato zakonisht kanë në pronësi

¹ Raport për Vlerësimin e Zbatimit të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas në Shqipëri. Botim i USAID Shqipëri, përgatitur nga Chemonics International. Tiranë, Dhjetor 2005

shumë kolateral të vogël, si për shembull prona. Për më tepër, Shqipëria nuk ka programe të veçanta huadhënieje ose asistencë trainuese për gratë që të inkurajojnë nismat e tyre të biznesit.

Së fundi, megjithëse meshkujt dhe femrat kanë të njëjtat të drejta dhe përgjegjësi ligjore gjatë martesës, çiftet priren të ndjekin rolet gjinore tradicionale. Nuk është e pazakontë për gratë që të kenë përgjegjësitë kryesore për administrimin e familjes dhe për t'u kujdesur për fëmijët ndërsa punojnë me kohë të plotë.

Gratë ndeshen me probleme edhe në fusha të tjera. Dhuna ndaj grave është një problem serioz në Shqipëri. Shumë viktime vazhdojnë ta shohin dhunën në familje si një çështje private dhe nuk kanë dëshirë të përfshijnë në të policinë. Komuniteti i OJF-ve ka luajtur një rol aktiv në luftën ndaj dhunës kundër grave dhe në adresimin e nevojave të grave të dhunuara. Për shembull, OJF-të administrojnë klinika ligjore, operojnë linja këshillimi, mbajnë strehëza për gratë dhe vajzat e dhunuara dhe kanë propozuar legjislacion që ka për qëllim të luftojë dhunën në familje. Për më tepër, megjithë vëmendjen e rritur, trafiku i grave dhe vajzave mbetet ende shqetësues.

Ndërsa ligji garanton shërbime falas të kujdesit shëndetësor për gjithë individët e siguruar, në realitet marrja e këtyre shërbimeve është shpesh e lidhur me pagesa ilegale nën dorë. Konceptualizuar në këtë mënyrë, shërbimet cilësore të kujdesit shëndetësor janë shpesh të paarrtshme si nga femrat dhe meshkujt për shkak të paaftësisë së tyre për të përballuar financiarisht shërbime të tilla. Gjithashtu, mjediset e kujdesit shëndetësor në zonat rurale, kur këto ekzistojnë, janë në kushte shumë të këqija. Më gjerësisht, shumë ekspertë u shprehën se marrja e shumë përfitimeve nga qeveria, duke përfshirë ato që lidhen me shëndetin, është gjithashtu e pakënaqshme si për meshkujt dhe femrat.

Arsimi është një prioritet i vazhdueshëm në të gjithë Shqipërinë. Shkalla e lexim shkrimit për meshkujt dhe femrat mbi moshën 15 vjeç është e lartë si në zonat urbane dhe ato rurale. Më shumë se 50 përqind e studentëve në universite janë femra. Pjesa më e madhe e problemeve në lidhje me frekuentimin e shkollës dhe marrjen e një arsimimi cilësor janë të dukshme për nxënësit nën 15 vjeç. Vajzat në zonat rurale janë veçanërisht në rrezik për të lënë shkollën. Në të njëjtën kohë, sistemi arsimor duket se përforcon stereotipet e roleve gjinore në tekstet mësimore dhe materiale të tjera, si dhe nëpërmjet qëndrimeve të mësuesve.

Përpjekjet e Shqipërisë për të përmirësuar statusin e grave dhe vajzave kanë qenë modeste. Shqipëria nuk ka marrë masa të veçanta për të informuar qytetarët e saj për CEDAW ose të sigurojë zbatimin e saj. Për këtë qëllim në Shkurt 2006, Shoqata Refleksione, me mbështetjen e Nismës për të Drejtat Ligjore të Grave (WLRI/Chemonics International-USAID), ndërmorri një fushatë ndërgjegjësimi të publikut mbi CEDAW, që zgjati për një periudhë gjashtë mujore.

2. MJEDISI POLITIK NË SHQIPËRI DHE TË DREJTAT E GRAVE DHE VAJZAVE

Shqipëria është Republikë Parlamentare dhe Kuvendi i Shqipërisë është organi kryesor dhe i vetëm ligjvënës. Ai funksionon nëpërmjet një dhome parlamentare ku ulen 140 deputetë, nga të cilët 100 zgjidhen nëpërmjet votimit të drejtëpërdrejtë maxhoritar, ndërsa 40 të tjerë nëpërmjet listave emërore të propozuara më parë nga Partitë politike. Parlamenti ka një kryetar dhe dy zv-kryetarë. Që prej vitit 2005 Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë është zgjedhur një grua, gjë e cila shënon një arritje për shoqërinë shqiptare dhe partitë politike në Shqipëri. Në parlament ka nëntë grupe parlamentare që përfaqësojnë partitë politike të të gjithë spektrit politik. Në Shqipëri është e ndaluar me ligj krijimi i partive politike fashiste ose që nxisin urrejtjen fetare dhe etnike. Për këtë qëllim në Shqipëri nuk ekzistojnë parti politike ekstremiste dhe partitë ekzistuese mund të përshkruhen se i përkasin qendrës së djathtë ose asaj të majtë.

Ndarja e pushteteve në Shqipëri garantohej nga Kushtetuta e vitit 1998, e cila përcakton rolin dhe fuqinë e tyre. Tre janë pushtetet kryesore të qeverisjes në Shqipëri: Legjislativ-i cili ushtrohet nga Kuvendi; Ekzekutivi-organi më i lartë i të cilit është Këshilli i Ministrave dhe Sistemi Gjyqësor, i cili ushtrohet nga Gjykatat e Larta, Gjykatat e Apelit e Gjykatat e shkallës së parë.

Roli i Presidentit është i kufizuar dhe për kompetencat që i janë dhënë, ai vlerësohet si figurë e rëndësishme e cila përfaqëson unitetin e popullit dhe ruan ekuilibrat ndërmjet 3 pushteteve. Kushtetuta gjithashtu ka hedhur bazat dhe ka krijuar institucionin e Avokatit të Popullit, i cili është një institucion i pavarur nga Qeveria dhe raporton përpara Parlamentit një herë në vit.

Qeveria është krahu ekzekutiv i Parlamentit dhe drejtuesi i qeverisë përcaktohet nga Partia që ka fituar zgjedhjet dhe votohet në Parlament. Gjatë viteve të pluralizmit politik, ndonëse nuk ka qenë e nevojshme, Shqipëria ka krijuar një traditë politike të qeverisjes nëpërmjet koalicioneve të partive politike të spektrit të djathtë, të majtë apo të qendrës.

Gjatë vitit 2005 u realizuan zgjedhjet e pesta të lira parlamentare, të cilat u fituan nga Partia Demokratike, partia e parë politike në Shqipëri që pas rënies së komunizmit. Në Shtator të të njëjtit vit Sali Berisha u zgjodh Kryeministër i vendit dhe programi i tij politik konsistonte në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, i cili gjatë viteve të fundit ishte bërë një barrierë për zhvillimin e Shqipërisë.

Zgjedhjet e vitit 2005 shënojnë nivelin më të ulët të përfaqësimit të grave dhe vajzave në jetën politike të vendit. Ndonëse pati një numër të lartë të pjesëmarrjes së grave dhe vajzave si kandidatë për deputete, vetëm 10 prej tyre arritën që të fitojnë. Sipas Unionit Ndërparlamentar kjo e rendit Shqipërinë në vendin e fundit në Europë dhe vendin e 114-të në Botë për numrin e grave anëtare të Parlamentit. Megjithatë vlen për tu theksuar se niveli i përgatitjes dhe prezantimit të grave në Parlament ka ardhur duke u rritur dhe thuhet se 10 gratë deputete në Kuvendin e Shqipërisë me iniciativat që ato kanë iniciuar, kanë treguar se gratë mund të luajnë një rol më të madh në drejtimin e vendit. Këtij argumenti i shërben edhe fakti që Kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë, si dhe Kryetarja e Komisionit Parlamentar për Arsimin dhe Mjetet e Informimit Publik, janë të dyja gra.

Niveli i përfaqësimit të grave dhe vajzave në Qeveri mbetet i ulët. Qeveria shqiptare ka vetëm një grua ministre nga 16 anëtarë, ndërkohë që ka 7 zëvendësministre gra dhe 21 burra. Kjo tregon se ka një disbalancë midis përfshirjes së burrave dhe grave në procesin e vendim-marrjes politike. I njëjti problem ekziston edhe në nivelet e Drejtorëve apo nivelit të nëpunësve të institucioneve publike. Kjo është sidomos e dukshme në institucione si Policia dhe Ushtria, ku numri i grave që kanë poste drejtuese është shumë i vogël.

Gjatë më shumë se një viti Qeveria shqiptare ka marrë një sërë masash për të luftuar korrupsionin, krimin e organizuar dhe forcimin e ekonomisë, shpeshherë me sukses. Megjithatë gjatë kësaj periudhe është vërejtur edhe një mungesë e theksuar e komunikimit midis forcave politike në Parlament, që ka vënë në dyshim arritjet pozitive të Qeverisë. Lufta politike shpesh është kthyer në përleshje fizike midis anëtarëve të Kuvendit të Shqipërisë, aq sa në një periudhë të shkurtër kohe Partia Socialiste (forca kryesore e opozitës) dhe aleatët e saj bojkotuan punimet e Parlamentit, gjë që paralizoi punimet e tij për një periudhë dy javore. U desh ndërhyrja e Bashkimit Europian që partitë politike t'i ktheheshin gjuhës së konsensusit në Kuvend.

Që prej rënies së komunizmit Shqipëria ka bërë hapa të jashtëzakonshëm përpara për të ndryshuar dhe përmirësuar legjislacionin kombëtar. Që pas vitit 1992 dhe deri më sot thuhet se i gjithë legjislacioni i periudhës së komunizmit është zëvendësuar me legjislacion të ri. Megjithatë ndryshimi i shpejtë i legjislacionit, dobësia e institucioneve të zbatimit të ligjit, mungesa e kulturës së zbatimit të ligjit dhe mos-njohja e teknikës legjislative, kanë bërë që shumë ligje të miratuara nga Parlamenti të mos gjejnë zbatim në praktikë. Një nga problemet kryesore të legjislacionit në Shqipëri, nuk është mungesa, por zbatimi i tij, një problem ky që ende nuk ka gjetur zgjidhje, por që duhet adresuar si nga organet ligjvënëse ashtu edhe ato të zbatimit të tij.

Shqipëria ka pranuar një sistem të hierarkisë së ligjeve. Kushtetuta është dokumenti kryesor në sistemin e shtetit të ligjit në Shqipëri. Ajo gjithashtu shërben si një burim reference për krijimin e normave dhe akteve të tjera ligjore apo nënligjore. Ndërkohë që Konventave ndërkombëtare të pranuar dhe ratifikuara nga Shqipëria iu jepet prioritet në zbatueshmëri krahasuar me ligjet vendase, të cilat vijnë një shkallë më poshtë.

Shqipëria zbaton një sistem të drejtës kontinentale, gjë që do të thotë se legjislacioni vendas është i organizuar në Kode, Ligje dhe më pas në akte të tjera ligjore dhe nënligjore. Kjo nënkupton se sistemi i Drejtësisë ka për detyrë të zbatojë të gjitha ligjet dhe aktet e miratuara nga Parlamenti, gjë që e bën ndonjëherë gjykimin dhe marrjen e vendimeve një proces të komplikuar. Sistemi i drejtësisë nuk e njeh dhe nuk e pranon parimin e precedentit, që zbatohet gjerësisht në vendet e common-law.

Shqipëria është një vend me moshë të re, ndonëse gjatë viteve të fundit emigracioni ka ndikuar në rritjen e moshës mesatare të popullsisë. Megjithatë fëmijët dhe të rinjtë përbëjnë një nga grupet më të mëdha shoqërore dhe zenë rreth 40 përqind të popullsisë në vend. Gratë në Shqipëri përbëjnë më shumë se gjysmën e popullsisë, por roli i tyre në jetën politike të vendit mbetet ende i vogël. Gratë dhe vajzat mund të gjenden në një numër të madh në institucionet arsimore dhe ato të ndihmës sociale, por ky numër bëhet i parëndësishëm kur bëhet fjalë për Parlamentin, Qeverinë apo institucionet e qeverisjes vendore.

Familja në Shqipëri, ndonëse gjatë viteve të fundit e ka humbur vlerën e saj, ajo vazhdon të mbetet një element i rëndësishëm i organizimit të shoqërisë. Ekziston një raport i zhdrejtë ndërmjet rolit që luajnë gratë dhe vajzat në familjen rurale me atë urbane. Gratë dhe vajzat që jetojnë në qytete të mëdha kanë më tepër mundësi për punë dhe për tu shoqëruar sesa gratë dhe vajzat në zonat rurale. Familja shqiptare, si për shkak të mbylljes ashtu edhe për shkak të rezistencës së saj ndaj ndryshimeve globale, mbetet ende një familje tradicionale. Burri shihet si elementi drejtues i familjes, ndonëse në të vërtetë është gruaja ajo që menaxhon shumicën e aktiviteteve familjare, duke përfshirë edhe kujdesin ndaj fëmijëve, të ardhurave të familjes dhe mbajtjen e nderit të familjes.

Megjithatë për shkak të emigracionit të lartë të brendshëm dhe të jashtëm familja shqiptare ka hyrë në rrugën e zhvillimit të disa tendencave të reja. Kështu martesat, ndonëse mbetet një element thelbësor i krijimit të familjes, ajo ka filluar të zëvendësohet në zonat urbane me bashkëjetesën. Ndryshimet e përfshira në Kodin e Familjes pasqyrojnë këtë tendencë të zhvillimit. Megjithatë ligji iu ndalon grave dhe vajzave lesbike që të krijojnë familjen e tyre të njëjtë seks apo të adoptojnë fëmijë. Nga ana tjetër një tendencë e dytë është rrëzimi i mitit të virgjërisë së femrës, ndonëse në zonat rurale ai nuk e ka humbur peshën e tij.

Përkeqësimi i statusit të grave dhe vajzave në Shqipëri ka sjellë krijimin e dhjetra organizatave jofitim-prurëse (OJF) të grave që janë marrë me çështje të ndryshme që shqetësojnë gratë sot. Në fakt, Indeksi i OJF-ve 2004 hartuar nga USAID raporton se shumica e OJF-ve në Shqipëri përqëndrohen tek gratë dhe rinia. Pjesa më e madhe e punës për advokimin e të drejtave të grave është bërë nga këto organizata me mbështetjen financiare të donatorëve ndërkombëtarë. Kjo punë është përqëndruar kryesisht në shëndetin e gruas dhe në dhunën kundër saj. Megjithatë, asnjë përpjekje sistematike nuk është bërë për të parë se çfarë ndodh në shumë fusha të jetës private dhe publike në të cilat gratë marrin pjesë. Megjithatë ka pak koordinim të përpjekjeve në sektorin e OJF-ve, qeveri të njëpasnjëshme shqiptare dhe legjislatura parlamentare kanë hartuar legjislacion që është i ndjeshëm ndaj vënies së përkatësisë gjinore në qendër të vëmendjes.²

Në vitin 2005 tre organizata kryesore të shoqërisë civile³ iniciuan krijimin e Koalicionit për Nxitjen e Pjesëmarrjes së Grave, të Rinjve dhe Minoriteteve në Politikë. Në fillim të muajit Shkurt 2006 Koalicioni shpalli publikisht një Peticion të Hapur ku kërkohej vendosja e një kuote prej minimumi 30 përqind të përfaqësimit të gruas në Parlament dhe në Qeverinë

2 Raport për Vlerësimin e Zbatimit të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas në Shqipëri. Botim i USAID Shqipëri, përgatitur nga Chemonics International. Tiranë, Dhjetor 2005

3 Forumi i Pavarur i Gruas Shqiptare, Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe Qendra për Popullsinë dhe Zhvillimin.

qëndrore dhe lokale. Peticioni u mbështet hapur nga të gjitha grupimet e grave pranë partive politike në Shqipëri, OJF-të e grave, si dhe nga Avokati i Popullit. Që pas shpalljes së Peticionit për Kuotën, një sërë partish politike e kanë bërë vendosjen e kuotës për gratë si pjesë të statuteve të partive ose programeve të tyre politike. Në fillim të Shtatorit 2006, Koalicioni dërgoi zyrtarisht, pranë Komisionit Parlamentar të Reformës Zgjedhore, propozimet e tij për ndryshimin e Kodit Zgjedhor. Ndër të tjera aty kërkohej edhe shtimi i tre neneve të reja, të cilat do të garantonin ligjërisht pjesmarrjen dhe përfaqësimin e grave dhe vajzave nëpërmjet kuotave, si në zgjedhje ashtu edhe në qeverisje.

Feja nuk luan ndonjë rol të rëndësishëm në rregullimin e jetës së grave dhe vajzave në Shqipëri, me përjashtim të familjeve që tradicionalisht kanë treguar tendenca të forta të besimit të tyre. Ndonëse nuk ka fe zyrtare, besimet kryesore janë myslyman, katolik dhe ortodoks, ndërkohë që ka edhe fe dhe sekte të tjera, të cilat funksionojnë lirisht në vend. Shqipëria është shtet laik dhe Qeveria kujdeset që institucionet e saj të mos tregojnë tendenca të preferencës ndaj njërës fe kundrejt tjetrës. Feja, për rreth 30 vjet, gjatë periudhës së komunizmit, ka qenë e ndaluar me ligj. Ajo u rilejua të hapej dhe të ri-organizohet në fillim të viteve 1990, por njerëzit i shohin me dyshim shfaqet e preferencave fetare. Kjo ka bërë që gratë dhe vajzat që mbajnë shaminë të bëhen pre e paragjykimeve ose dëbimeve nga institucionet arsimore, sepse në parim besohet se shamia bie në kundërshtim me statusin laik të institucioneve publike. Megjithatë e drejta e fesë dhe e ushtrimit të saj respektohet në Shqipëri si një e drejtë personale. Për më tepër Shqipëria ka ngritur një bashkë-ekzistencë paqësore dhe komunikuese midis të gjitha besimeve fetare, gjë që është një shembull pozitiv i komunikimit ndër-fetar midis qytetarëve në një vend demokratik.

Në Shqipëri jetojnë disa minoritete dhe komunitete si psh: Rrome, Maqedonase, Egjiptiane, Greke, Serbo-malazeze dhe Boshnjake. Ndonëse në përgjithësi të drejtat e minoriteteve respektohen, përfaqësuesit e tyre shpesh ankohen për mundësitë e pakta që Shteti shqiptar iu krijon për të mësuar në shkollat publike gjuhën e tyre, apo përfshirjen në sektorin e punësimit publik si përfaqësues të minoriteteve. Pak dihet përsa i përket gjendjes së grave dhe vajzave të minoriteteve në Shqipëri, për shkak se çështja e respektimit të të drejtave të minoriteteve si grup, del mbi atë të respektimit të të drejtave të grave të minoriteteve. Megjithatë mund të thuhet se gjendja e të drejtave të grave dhe vajzave të minoritetit Rrom dhe Egjiptian në Shqipëri është e rëndë, për shkak të ruajtjes së familjes tradicionale patriarkale dhe rolit që luan burri në familje.

Shqipëria aspiron që të bëhet vend anëtar i Bashkimit European. Në Qershor 2006 Qeveria shqiptare nënshkroi një Marrëveshje të Stabilizim-Asocimit me Bashkimin European, një instrument ky që ndihmon vendet jo-anëtare të BE-së të arrijnë një sërë standartesh përpara se të merren në konsideratë dhe të pranohen si anëtare të saj. Integrimi europian i Shqipërisë është bërë një objektiv madhor për të gjitha partitë politike në Shqipëri. Por në realitet vërehet një diferencë e madhe midis dëshirës për t'u bërë anëtar i BE-së dhe veprimeve që partitë ndërmarrin për të arritur këtë objektiv.

3. RAPORTI ALTERNATIV CEDAW PER SHQIPËRINË

NENI 1 – PËRKUFIZIMI I DISKRIMINIMIT

A. ASPEKTET LIGJORE

Shqipëria nuk ka një legjislacion të veçantë që të ndalojë diskriminimin në Shqipëri dhe për pasojë shumë çështje që kanë të bëjnë me diskriminimin e vajzave dhe grave nuk paraqiten para sistemit të drejtësisë. Po ashtu mungojnë të dhënat që të tregojnë nëse sistemi gjyqësor në Shqipëri ka trajtuar ose jo kërkesa të individëve si pasojë e diskriminimit që mund të ketë ndodhur ndaj tyre.

Shqipëria ratifikoi Konventën e CEDAW në 11 Maj 1994. Si të gjitha konventat e ratifikuara nga shtetet palë, kjo konventë zë një vend të rëndësishëm në hierarkinë e akteve ligjore. Ratifikimi i kësaj konvente nga shtetet palë nënkupton jo vetëm marrjen përsipër të një numër detyrimesh, por nënkupton gjithashtu që shtetet palë duhet të mundësojnë që legjislacioni i brendshëm të jetë në përputhje me standartet ndërkombëtare që burojnë nga kjo konventë. Ratifikimi i kësaj konvente nënkupton gjithashtu që shteti shqiptar pranon përcaktimin e diskriminimit të përfshirë në këtë konventë.

Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave (CEDAW), e përkufizon diskriminimin si “çdo dallim, përjashtim ose kufizim në bazë gjinie, që ka për pasojë ose për qëllim të dëmtojë ose zhvlerësojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin nga gruaja, cilado qoftë gjendja e saj martesore, mbi bazën e barazisë së burrit dhe gruas, të të drejtave të Njeriut dhe lirive themelore, në fushat politike, ekonomike, shoqërore, kulturore e civile, ose në çdo fushë tjetër”.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ndonëse nuk përmban përcaktimin e diskriminimit sanksionon në Nenin 18 se të gjithë janë të barabartë përpara ligjit dhe se askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore etj.

Gjatë vitit 2006 Grupi Shqiptar për të Drejtat e Njeriut (GSHDNJ) nën asistencën e Komitetit Suedez të Helsinkit inicioi përgatitjen e një projekt-ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Pjesë e kësaj iniciative u bënë edhe CRCA dhe CLCI. Pas disa muajsh pune intensive GSHDNJ prezantoi një draft të ligjit dhe e shpërnda atë për ta konsultuar me shoqërinë civile dhe ekspertët në Shqipëri. Në këtë moment GSHDNJ përgatitet që tja kalojë Projekt-ligjin “Për Ndalimin e Diskriminimit” Kuvendit të Shqipërisë për shqyrtim dhe miratim.

Parimi i barazisë gjinore përshkon gjithë legjislacionin e brendshëm shqiptar. Kodi i Punës në nenin 19, e përkufizon diskriminimin si “dallimi, përjashtimi ose preferenca e bërë në bazë të racës, ngjyrës, seksit, moshës, besimit, opinionit politik, përkatësisë etnike ose origjinës sociale, dëmtimit fizik ose mendor, i cili ka efektin e shfuqizimit ose dobësimit të barazisë të mundësive ose trajtimit.”

Kodi Civil, në nenin 1 të tij parashikon se çdo person fizik gëzon zotësi të plotë e të barabartë për të pasur të drejta.

Kodi Penal parashikon si vepër penale të veçantë shkeljen e barazisë së shtetasve, nga ana e punonjësve me funksion shtetëror apo në shërbim publik. Kjo shkelje e barazisë së shtetasve konsiston në kryerjen e dallimeve mbi bazë origjine, seksi, gjendjes shëndetësore, bindjeve fetare, politike, të veprimtarisë sindikale ose për shkak të përkatësisë në një etni, komb, racë apo fe të caktuar.

Ligji “Për një shoqëri gjinore të barabartë” jep një përkufizim të posaçëm të barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit. Barazia dhe mosdiskriminimi është bërë një fushë rregullimi në të gjitha ligjet që kanë të bëjnë me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Pavarësisht nga veçoritë që paraqet çdo ligj për shkak të fushës që rregullon, ka disa standarte të barazisë gjinore. Barazi gjinore do të thotë *pjesëmarrje e barabartë* e femrave dhe meshkujve në të gjithat fushat e jetës, *pozitivë e barabartë* midis tyre, *mundësi të barabarta* për të gëzuar të gjithat të drejtat e tyre dhe për të vënë në shërbim potencialet individuale në zhvillimin e shoqërisë, si dhe të kenë *përfitim të barabartë* nga ky zhvillim.

Sipas Shoqatës Refleksione rezulton se pavarësisht legjislacionit të miratuar, në realitet gratë e minoriteteve Rrome apo Egjiptjane, si dhe gratë e moshës së rritur të mesme, janë të diskriminuara në fushën e punësimit, pikërisht për shkak të ngjyrës apo moshës së tyre. Ndonëse këto gra mund të jenë të trajnuara apo kualifikuara, janë shumë të rrallë punëdhënësit që pranojnë të punësojnë gra me ngjyrë apo gra të moshës së rritur të mesme, për shkak të mentalitetit paragjykses mbi aftësitë e tyre. Situatën në këtë drejtim duket se ende nuk kanë arritur ta përmirësojnë as masat e parashikuara në Strategjinë e Punësimit dhe Formimit Profesional (SPFP - hartuar nga Qeveria shqiptare në vitin 2003) apo urdhrat dhe vendimet nxjerrë në vijim të saj. Pavarësisht se në SPFP citohen masa lidhur me programe të veçanta që nxisin punësimin e grave të moshës së rritur të mesme si dhe trajnimin, kualifikimin apo punësimin e grave Rrome, integrimi veçanërisht i këtyre dy kategorive në tregun e punës, është pothuajse i pamundur.

NENI 2 – DETYRIMET PËR TË ELIMINUAR DISKRIMINIMIN

A. ASPEKTET LIGJORE

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ndalon çdo lloj diskriminimi për shkak të gjinisë⁴. Ajo nuk ka ndonjë formulim të posaçëm për barazinë e burrit ndaj gruas, sikurse ndodh në disa kushtetuta të vendeve të tjera (si psh. Kushteta gjermane), megjithatë në kuptimin e përgjithshëm nuk i mungon asgjë për të siguruar këtë barazi.

Garantimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit nuk do të thotë që s’mund të ketë dallime dhe privilegje për shkaqe të përligjura, të arsyeshme dhe objektive. Vetë Kushtetuta parashikon mbrojtje të veçantë nga shteti për gratë shtatzëna dhe nënat e reja. Kjo nënkupton se ligjvënësi me ndërhyrjen e tij dhe me ligjet që nxjerr parashikon lehtësi të posaçme për to.

Në zbatim të Nenit 18 të Kushtetutës ka përpjekje nga aktorë të ndryshëm të shoqërisë civile për vendosjen e sistemit të kuotimit, me qëllim përcaktimin e kuotave për kandidatet gra, por ende nuk është arritur ndonjë rezultat.

Kodi i ri i Familjes, i cili hyri në fuqi në fillim të vitit 2004, në nenin 7 të tij parashikon një trajtim të njëjtë të burrave dhe grave në lidhje me moshën e lidhjes së martesës duke e barazuar atë në 18 vjeç si për burrat dhe për gratë. Ndonëse në dukje ky Kod i dha fund trajtimit diskriminues të parashikuar në Kodin e mëparshëm të Familjes, i cili parashikonte moshën 16 vjeç për gratë dhe 18 vjeç për burrat si moshë të lidhjes së martesës, përsëri ai parashikon një dispozitë lejuese të martesës së vajzave edhe nën moshën 18 vjeç për shkaqe të rënda.

Kodi Penal parashikon “shkeljen e barazisë së shtetasve” si një vepër penale të veçantë dhe masa e dënimit për kryerjen e kësaj vepre nga punonjës të veshur me funksion zyrtar apo në shërbim publik është gjobë ose burgim deri në pesë vjet. Shkelje të barazisë së shtetasve përbën kryerja për shkak të detyrës dhe në ushtrim të saj, nga ana e punonjësit me funksion shtetëror apo në shërbim publik të dallimeve mbi bazë origjine, gjinie, gjendjes shëndetësore, bindjeve fetare, politike etj, që konsiston në krijimin e privilegjeve të padrejta ose në refuzimin e një të drejte ose përfitimi që buron nga ligji. Për nëpunësit e administratës shtetërore që janë në kushtet e kryerjes së shkeljes, vendoset dënimi me gjobë.

⁴ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 18 thotë: 1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia,..... 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjeje e arsyeshme dhe objektive.

Në mes të vitit 2004 Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin "Për një Shoqëri Gjinore të Barabartë". Ky ligj përcakton detyrimin dhe detyrat e punëdhënësit për të zbatuar të drejta të barabarta për burrat dhe gratë. Për shkak të një sërë mangësish të vërejtura gjatë përgatitjes së këtij ligji, Qeveria vendosi që të shikonte mundësinë e amendimeve të reja në këtë ligj. Deri në këtë moment Kuvendi i Shqipërisë nuk i ka marrë ende në shqyrtim amendimet e tij.

Ligji "Për një Shoqëri Gjinore të Barabartë" parashikon edhe sanksione për shkeljen e dispozitave të tij, për të cilat u referohet dispozitave të Kodit të Punës, Kodit Civil, Kodit Penal, si dhe ligjit "Për statusin e nënpunësit civil". Ai parashikon dënimin me gjobë kur shkelja është bërë nga nënpunësit e administratës shtetërore. Ligji afirmon edhe një herë mundësinë e ankimit në gjykatë.

Legjislacioni në fushën e punës ka përcaktuar rrethin e veprimeve diskriminuese të punëdhënësit dhe përgjegjësitë e tij për të mbrojtur punëmarrësin nga diskriminimi, veprimet diskriminuese në institucionet e arsimit dhe të shkencës si dhe njoftimet diskriminuese të punës. Ai vendos strukturat shtetërore dhe autoritetin publik përgjegjës për zbatimin e të drejtave të barabarta për gratë dhe burrat në punë.

B. DHUNA NDAJ GRAVE DHE VAJZAVE

Përgjatë 5 viteve objekt studimi, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë, Tiranë, janë regjistruar 189 procedime penale për vepra që kanë të bëjnë me dukurinë e dhunës brenda familjes. Ndërkohë, në Gjykatën e Tiranës janë gjykuar 122 çështje që lidhen me vepra të kësaj natyre.⁵

Kodi Penal i jep një vend të veçantë mbrojtjes së personit, të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Shumë dispozita të tij sigurojnë mbrojtje nga veprimet që dhunojnë integritetin fizik, mendor dhe seksual të një personi dhe drejtpërdrejt ose jo sigurojnë për gratë mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna në përgjithësi.⁶

Në përmbajtjen e Kodit Penal janë parashikuar disa vepra penale që kanë lidhje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me dhunën në familje si psh "Vrasja e kryer me dashje" (neni 76 i K.p.), "Vrasja me dashje në lidhje me një krim tjetër" (neni 77 i K.p.), "Vrasja me paramendim" (neni 78 i K.p.), përbëjnë krime kundër jetës për të cilat parashikohen masa të rënda dënimi me burgim.

Kodi Penal, mbështetur edhe në mbrojtjen e veçantë që i jepet gruas shtatzënë nga Kushtetuta, e parashikon vrasjen e kryer me dashje ndaj gruas shtatzënë, si vrasje të kryer në rrethana cilësuese. Në përputhje me shkallën e rëndë të kësaj vepre, Kodi penal parashikon dënimin me burgim, jo më pak se njëzet vjet, ose me burgim të përjetshëm.

Ndonëse në bazë të standarteve ndërkombëtare kërkohet që vrasjet në emër të nderit të ndiqen penalisht, në legjislacionin penal kombëtar nuk ka dispozita që parashikojnë diçka të tillë. Në praktikë, nuk kanë munguar rastet ku vendimi i gjykatës ka rezultuar në një masë dënimi më lehtësuese për vrasësin. Gjykata ka arsyetuar se dhunuesi nuk ka kryer më parë vepra penale, ka përgjegjësi për mirëritjen e fëmijëve, ka kryer veprën në kushtet e tronditjes psikike etj.⁷

Në Kodin Penal Tortura (neni 86 i K.p.) dhe "Tortura me pasoja të rënda" (neni 87 i K.p.) konsiderohen krime kundër shëndetit dhe dënimet e parashikuara për këto vepra janë të rënda.⁸ *Megjithëse Kodi Penal nuk e lidh torturën në mënyrë të posaçme me gratë, gjykatat mund të zbatojnë këto dispozita në rastet kur një grua dhunohet në marrëdhëniet familjare dhe kjo dhunë ka në përbërje elementet përcaktuese të torturës*⁹. Paplotësia e përcaktimit të torturës në Kodin Penal në

5 Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, "Për një zbatim sa më të mirë të ligjit në mbrojtje të viktimave të dhunës në familje nga organet e drejtësisë", Tiranë 2005, fq.30. Botim i realizuar në kuadrin e projektit "Të përmirësojmë punën e organeve të procedimit dhe të gjykatës, përsa i përket zbatimit sa më të mirë të ligjeve që ndëshkojnë dhe parandalojnë dhunën në familje", me mbështetjen e Komisionit Europian. Në kuadrin e këtij projekti u monitoruan vendimet gjyqësore të gjykuara nga gjykata e shkallës së parë Tiranë dhe aktet e organeve të procedimit të hetuara nga Prokuroria Tiranë në periudhën 2000-2004.

6 A.Mandro, "Criminal Code Report: Albania", 2002,f.1. I vlefshëm në www.seeline-project.net

7 Me vendimin penal nr.811, datë 29.9.2003, R.Q., që vrau vajzën e tij, u dënua me dy vjet burgim. Dënimi u zbrit në 1 vit e 4 muaj burg, sepse u aplikua gjykimi i shkurtuar. Gjykata e apelit nuk e la në fuqi këtë vendim.

8 Për këto vepra penale, Kodi penal parashikon përkatësisht dënimin me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet dhe nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

9 Nga monitorimi i procedimeve penale në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë në Tiranë dhe i çështjeve të gjykuara nga gjykata e shkallës së parë në Tiranë për periudhën 2000-2004 nuk rezultoi të jenë zbatuar këto dispozita për mbrojtjen e grave nga dhuna në marrëdhëniet familjare. (Ky monitorim u krye në kuadrin të projektit "Të përmirësojmë punën e organeve të procedimit dhe të gjykatës, për sa i përket zbatimit sa më të mirë të ligjeve që ndëshkojnë dhe parandalojnë dhunën në familje", zbatuar nga QNLQ-ja me mbështetjen e Komisionit Europian.

lidhje me elemente të tilla, si subjektet, qëllimi i ushtrimit të aktit, shkalla e dhunës etj., mund të ndikojë në referimin dhe zbatimin e rrallë të kësaj dispozite.

Në legjislacionin penal mungon një përkufizim për prostitucionin. Por nga ana tjetër Kodi Penal e parashikon mbrojtjen e femrës nga shfrytëzimi për prostitucion (neni 114/a). Vitet e fundit, prokuroria dhe gjykata po përballen me regjistrimin e rasteve të shfrytëzimit të pjesëtarëve të familjes, kryesisht të bashkëshortes, për prostitucion. Shfrytëzimi i lidhjeve gjinore dhe shoqërimi i kësaj veprë me dhunë fizike apo psikike përbëjnë rrethana rënduese. Nëse një grua, si rrjedhojë e rrahjeve, fyerjeve të rënda, mundimeve apo formave të tjera të dhunës të ushtruara nga bashkëshorti i saj kryen tentativë për vetëvrasje ose vetëvritet, Kodi penal (neni 99) parashikon veprën penale për këtë rast dhe jep dënime alternative me gjobë ose burgim gjer në pesë vjet.

Inçesti. Komiteti i CEDAW dhe Komiteti i Ministrave të Vendeve Anëtare për Mbrojtjen e Grave nga Dhuna kanë rekomanduar që inçesti të ndiqet penalisht¹⁰. Me ndryshimet që i janë bërë Kodit Penal¹¹, inçesti (neni 106 i K.p.) përbën një veprë penale të ndëshkueshme¹². Kodi penal përcakton kuadrin e plotë të kategorisë së personave, subjekte të kësaj veprë duke përfshirë kryerjen e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale, jo vetëm ndërmjet prindit dhe fëmijës, vëllait dhe motrës, por edhe personave të tjerë që janë në gjini në vijë të drejtë dhe personave që ndodhen në raporte kujdestarie ose të birësimit.

Nga Buletini statistikor i Ministrisë së Drejtësisë, rezulton se gjatë vitit 2004 janë gjykuar 2 çështje me objekt “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari”. Numri i çështjeve të gjykuara me këtë objekt nuk përfaqëson një tregues real të përhapjes së kësaj veprë.

Në Kodin Penal liria seksuale mbrohet në mënyrë të posaçme. Kryerja e marrëdhënieve seksuale me dhunë me një grua të rritur përbën krim (neni 102 i K.P.). Gjykata mund të zbatojë këtë dispozitë edhe kur kjo veprë penale është kryer në marrëdhënie familjare. Dënimi i parashikuar për këtë veprë është tre deri në dhjetë vjet burg. Parashikohet masë më e lartë dënimi burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet, kur kjo veprë ka sjellë vdekjen ose vetëvrasjen e së dëmtuarës. Kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale (neni 104 i K.p.) parashikohet si figurë e veçantë krimi. Në rastet e përdhunimit të gruas nga bashkëshorti konfigurohet e njëjta veprë penale, por me ndryshimin se subjekti është i posaçëm. Kundërshtimi fizik i së dëmtuarës përbën kusht për ndjekjen penale të kësaj veprë.

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (Vendimi i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut në rastin “MC kundër Bullgarisë”, nr.39272/98) ka kërkuar ndëshkimin penal të kësaj veprë edhe në rastet kur viktimat nuk ka rezistuar fizikisht. Gjykata konsideron një varg arsyesh psikologjike që mund të rezultojnë në mungesë rezistence nga ana e viktimës. Kodi ynë penal nuk mund të konsiderohet i përqsur me këtë praktikë. Ai parashikon kryerjen e kësaj veprë me përdorim të dhunës me qëllim që të mposhtë rezistencën e së dëmtuarës. Kjo dispozitë ofron mbrojtje vetëm kur elementi i rezistencës është i pranishëm.

Në raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit (2005) për situatën në lidhje me të drejtat e njeriut në Shqipëri konstatohej se “Përdhunimi është i ndëshkueshëm nga ligji, po ashtu përdhunimi bashkëshortor, megjithatë, në praktikë, përdhunimi bashkëshortor nuk raportohet ose ndiqet penalisht.”¹³ Gratë-viktima të dhunës në familje i referohen pak ose aspak për mbrojtje kësaj dispozite, sepse konceptet e përdhunimit bashkëshortor dhe të ngacmimeve seksuale nuk janë të mirëndërtuara dhe mendësia e shoqërisë shqiptare nuk i konsideron kurrsesi marrëdhëniet seksuale, qoftë edhe pa dëshirën e bashkëshortes ose me përdorim të dhunës, si krim ose një akt kundër dëshirës së grave dhe vajzave. Vështirësia e të provuarit të kësaj forme të dhunës së kryer në familje ka ndikimin e saj në numrin e kufizuar të denoncimeve të kësaj veprë penale. Gratë guxojnë të denoncojnë këtë veprë penale, sidomos kur ato ndodhen në kushtet e zgjidhjes së martesës¹⁴.

Procedurat me iniciativë private. Legjislacioni ynë penal parashikon se i dëmtuari akuzues mund të ushtrojë ndjekjen penale. Për veprat penale të një rëndësie më të vogël, të parashikuara nga neni 59 i Kodit të Procedurës Penale, i dëmtuari

10 Në vërejtjet përfundimtare të Komitetit CEDAW për raportin e Republikës Çeke (sesioni i jashtzakonshëm), 2002 dhe në rekomandimin (2002)5 të Komitetit të Ministrave për mbrojtjen e grave nga dhuna.

11 Miratuar me ligjin nr. 8733, datë 24.1.2001

12 Masa e dënimit për këtë veprë penale është burgim gjer në shtatë vjet.

13 Departamenti Amerikan i Shtetit, “Country Reports on Human Rights Practices-2004”, Tiranë, 2005.

14 P.B., e martuar me dy fëmijë, u paraqit pranë Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare dhe denoncoi dhunën seksuale të ushtruar nga bashkëshorti i saj, në prani edhe të fëmijëve, si shkak për zgjidhjen e martesës.

ka të drejtën e ngritjes së akuzës dhe merr pjesë në gjykim si palë, prandaj quhet i dëmtuari akuzues.¹⁵ Konstatohet se një numër i madh i veprave penale që kanë të bëjnë me dhunën në familje, hyjnë në kategorinë e veprave që ndiqen me ankim, drejtpërdrejt në gjykatë, nga i dëmtuari akuzues. Nëpërmjet këtyre dispozitave, ligjvënësi i jep mundësi personit të dëmtuar të fillojë procesin penal dhe ta ndjekë atë, për veprat penale që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me të dhe me të drejtat personale të tij. Kjo mundësi i jepet të dëmtuarit për vepra penale të konsideruara me rrezikshmëri shoqërore të ulët (neni 59). Disa vendime të gjykatave, për veprat penale që ndiqen me iniciativë private, vuajnë nga mungesa e provave. Kjo ndodh sepse ka raste që policia nuk depoziton kallëzimin e viktimës dhe nuk e pajis menjëherë të dëmtuarën me vendimin e ekspertimit mjeko-ligjor. Këto procedura mundësojnë tërheqjen e viktimës nga ndjekja e çështjes në gjykatë.

Kallëzimi është mjeti më i përdorur për fillimin e çështjeve penale të kësaj natyre, sepse ato ndodhin në mjediset e mbyllura dhe janë përgjithësisht vepra për të cilat procedimi penal nis vetëm mbi bazën e ankimit¹⁶ ose vepra që shqyrtohen drejtpërdrejt nga gjykata. Vullneti i të dëmtuarit, i shprehur në ankim, është domosdoshmëri për të nisur ndjekjen penale, për këto vepra. Ankimi bëhet nga i dëmtuari te prokurori ose në policinë gjyqësore. Nëse ankimi paraqitet në polici, personi që e merr ankimin, ia dërgon aktet prokurorit. Kodi i Procedurës Penale parashikon edhe të drejtën e të dëmtuarit të shprehë vullnetin e tij të lirë për të tërhequr ankimin që ka paraqitur. Ankuesi mund ta tërheqë ankimin derisa vendimi i gjykatës të mos ketë marrë formë të prerë. Përbën një kërkesë nga standardet ndërkombëtare fakti që legjislacioni i brendshëm duhet të mundësojë ndjekjen penale të një rasti edhe pa pasur një ankesë nga vetë viktimja. Për rastet e përmendura më lart, kjo e drejtë nuk mundësohet.

C. TRAJTIMI I GRAVE DHE VAJZAVE TË DËNUARA

Legjislacioni penal dhe zbatimi. Në Kodin Penal parashikohen disa vepra penale ku gruaja është viktimë ose subjekt i veprës penale. Në këtë kuadër janë disa vepra penale ku viktimë mund të jetë vetëm gruaja. Të tilla janë ndërprerja e shtatzanisë pa pëlqimin e gruas¹⁷, kryerja e marrëdhënieve seksuale me të mitura që nuk kanë arritur pjekurinë seksuale¹⁸, marrëdhëniet seksuale me dhunë me të rritura¹⁹, trafikimi i femrave²⁰. Ndërkohë që nuk mungojnë edhe veprat penale të cilat mund të kryhen vetëm nga gratë, për shkak të të qënurit grua. E tillë është vepra penale e vrasjes së foshnjës (neni 81 i Kodit Penal).

Kodi i Procedurës Penale parashikon raste përjashtimore për gratë shtatzana ose më fëmijë në gji për caktimin e masës së arrestit me burg. Në këtë kuadër ndaj kësaj kategorie nuk mund të vendoset masa e arrestit në burg përveç rasteve kur ka shkaqe të një rëndësie të veçantë për krimet që dënohen jo më pak në maksimum se dhjetë vjet burgim²¹. Gjthashtu, në rastet kur gruaja është shtatzënë ose me fëmijë nën një vjeç dhe është dënuar me vendim gjyqësor me burgim, ekzekutimi i dënimit shtyhet derisa fëmija të bëhet një vjeç²².

Trajtim i posaçëm i bëhet gruas edhe në ligjin nr. 8328, datë 1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim” ku parashikohet që gratë e vuajnë dënimin në institucione të posaçme dhe në pamundësi, në seksione të institucioneve të tjera. Gratë mund të vendosen në burgjet e sigurisë së lartë dhe në seksionet e burgjeve të sigurisë së lartë për sjellje dhe vepra veçanërisht të rënda (neni 13 i ligjit). Nënave u lejohet që të mbajnë me vete fëmijët deri në moshën 3 vjeç. Për kujdesin dhe asistencën ndaj fëmijëve funksionojnë çerdhet e posaçme²³. Përsa i përket shërbimit shëndetësor parashikohet funksionimi i shërbimeve speciale në ndihmë të grave shtatzana dhe atyre me fëmijë në gji²⁴. Trajtim i

15 H. Islami; A. Hoxha; I. Panda: “Procedura penale, komentar”, Tiranë, 2003, f. 141.

Disa nga veprat penale të parashikuara në Kodin penal, për të cilat e dëmtuara ka të drejtën e akuzës dhe që mund të ndodhin në kushtet e ushtrimit të dhunës në familje, janë: rrahja (neni 90 i K.p.), plagosja e rëndë nga pakujdesia (neni 91), plagosja e lehtë nga pakujdesia (neni 92), dhunimi i banesës (neni 112, paragrafi i parë), fyerja (neni 119), shpifja (neni 120), ndërhyrjet e padrejta në jetën private (neni 121), përhapja e sekretëve vetjake (neni 122), mosdhënia e mjeteve për jetesë (neni 125), marrja e padrejtë e fëmijës (neni 127).

16 Ankimi shpreh vullnetin e të dëmtuarit për të proceduar penalisht lidhur me një vepër penale dhe ndëshkimin e fajtorëve.

Disa nga veprat penale për të cilat parashikohet që të fillojë ndjekja penale, bazuar vetëm mbi ankimin e të dëmtuarit dhe që mund të ndodhin në kushtet e dhunës në familje, janë: plagosja e lehtë me dashje (neni 89 i Kodit penal), marrëdhënia seksuale me dhunë me të rritura (neni 102 i Kodit penal, paragrafi i parë), marrëdhënia seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari (neni 106 i Kodit penal), shtrëngimi ose pengimi për të bashkëjetuar ose për të zgjidhur martesë (neni 130 i Kodit penal), përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike (neni 275 i Kodit penal, shih shtojcën 6).

17 Neni 93 i Kodit Penal

18 Neni 100 i Kodit Penal

19 Neni 102 i Kodit Penal

20 Neni 114/b i Kodit Penal

21 Neni 230 i Kodit të Procedurës Penale

22 Neni 476 i Kodit të Procedurës Penale

23 Neni 17 i ligjit

24 Neni 29 i ligjit

veçantë u bëhet grave shtatzana ose me fëmijë në gjë në rastin e punësimit në institucion (neni 34), lidhjet e tyre me familjen (neni 40), lëvizjet e tyre brenda institucionit (neni 48), dhënien e masave disiplinore²⁵ (neni 53), etj.

Trajtimi i vajzave dhe grave të paraburgosura²⁶. Menjëherë pas ndalimit ose arrestimit të tyre, gratë mbahen në dhomat e paraburgimit të komisariateve deri në momentin e vendosjes së masës së sigurimit nga gjykata²⁷. Pasi është caktuar masa e sigurimit arrest në burg, ato dërgohen në seksionin e veçantë për gratë, në paraburgimin nr. 313, Tiranë.

Nga vëzhgimet e kryera nga KSHH në vendet e paraburgimit ka rezultuar se nuk ka ambjente të veçanta për gratë, ashtu siç e parashikon ligji. Sipas personelit, në vendet e paraburgimit, në rastet kur ndalohej një person i seksit femër, lirohet njëra nga dhomat e paraburgimit të meshkujve, gjë e cila çon në rritjen e numrit të të paraburgosurve nëpër dhomat e tjera.

Në paraburgimet e vëzhguara nga KSHH, personeli që shërben në këto vende janë meshkuj. Nuk ka personel sigurie femër dhe as personel të posaçëm për trajtimin e grave të paraburgosura. Një praktikë e tillë është evidentuar në paraburgimin e Beratit.

Gratë e paraburgosura nuk kanë informacion për njohjen e të drejtave procedurale në momentin e ndalimit ose të arrestimit. Niveli i tyre arsimor, mungesa e komunikimit me familjen në momentet e para të hetimit si edhe mospasja e një avokati në këto momente janë faktorë që kanë çuar në mosnjohjen e të drejtave të tyre. Puna edukative në vendet e paraburgimit ndryshon kur ato transferohen në institucionin e paraburgimit nr. 313, Tiranë.

Në këtë institucion janë marrë masa për të siguruar trajtim të posaçëm të grave i cili përfshin shërbimin mjekësor, ajrimin, punësimin e tyre, edukimin dhe informimin.

Trajtimi i të dënuarave²⁸. Sipas kriterëve të ligjit “Për të drejtat dhe trajtimin e personave të dënuar me burgim”, dënimi me burg vuhet në institucione të posaçme vetëm për gratë dhe, në pamundësi, në seksione të veçanta të institucioneve të tjera. Nënave u lejohet të mbajnë me vete fëmijën deri në moshën 3 vjeç. Për kujdesin dhe asistencën ndaj këtyre fëmijëve funksionojnë çerdhe të posaçme në institucionet e vuajtjes së dënimit.

Seksioni i veçantë i planifikuar për gratë e dënuara me vendim të formës së prerë të gjykatës ndodhet në institucionin nr. 325, Tiranë. Gratë e vendosura në këtë institucion kryesisht janë dënuar për krime të rënda brenda familjes.

Mjediset e qëndrimit dhe të fjetjes të burgut të grave përbëhen nga 7 dhoma. Numri i të dënuarave në dhomë arrin deri në 8. Edhe ky seksion, ashtu si edhe seksionet e tjera në institucionet e vuajtjes së dënimit, karakterizohet nga një mbipopullim i dukshëm. Veshjet dhe pajisjet sigurohen nga vetë të dënuarat dhe nga familjet e tyre.

Në institucionin nr. 325, për të dënuarat gra organizohen rregullisht veprimtari kulturore, çlodhëse e sportive si edhe veprimtari edukative mësimore. Për sa i takon arsimimit dhe edukimit të tyre, janë ngritur kurse për mësimin e grave të paarsimuara, kurse kompjuteri, rrobaqepësie. Programi dhe realizimi i trajtimit realizohet nga administrata e burgjeve në bashkëpunim edhe me organizata jofitimprurëse. Biblioteka dhe dhomat e krijuara për ushtrimin e riteve fetare më parë kanë qenë dhoma qëndrimi për të dënuarat. Fondi i bibliotekës ka nevojë për libra të rinj, sidomos për libra artistikë dhe shkencorë.

Një fushë volejboli dhe basketboli shërben si mjedis i përshtatshëm për veprimtari sportive për gratë e dënuara. Ritet e tyre fetare ato i ushtrojnë në dhoma të përshtatura, por jo në mjedise të ndërtuara për këtë qëllim. Për faltore shfrytëzohet një kuzhinë e vjetër. Kushtet higjieno-sanitare nuk janë të përshtatshme. Nga vëzhgimet që Komitetit Shqiptar i Helsinkit ka realizuar, ka rezultuar se të gjitha të dënuarat kishin probleme me higjienën e tyre.

Për sa i përket mjekimit, ai mbahet në infermieri në kushte të mira. Të gjitha mjekimet jepen me rekomandimin e mjekut. Mjekja në këtë institucion është patologe dhe nuk ka asnjë mjek tjetër neurolog ose psikiatër. Kur të dënuarat gra janë në gjendje të rëndë, ato dërgohen në spitalin e burgut për trajtim më të specializuar.

25 Ndaj grave masat disiplinore si përjashtimi nga veprimtari të veçanta, të përbashkëta deri në 10 ditë; Përjashtimi nga ajrosja në grup për jo më shumë se 20 ditë; Përjashtimi nga të gjitha veprimtaritë e përbashkëta deri në 20 ditë, mund të jepen deri në gjysmën e kohës së parashikuar; Për gratë shtatzana ose që u është lënë fëmija, mund të zbatohen vetëm masat disiplinore që kanë të bëjnë me qortimin individual dhe vërejtje në prani të të dënuarve.

26 Për më shumë shih “Respektimi i të drejtave të personave në paraburgime dhe burgje”, botim i Komitetit Shqiptar të Helsinkit, Tiranë më 2005

27 Neni 245 i Kodi i Procedurës Penale

28 Të dhënat janë marrë nga vëzhgimet që KSHH ka realizuar në Institutin e Riedukimit nr. 325, Tiranë 2006

Administrata e institucionit nr. 325 përpiket për t'u siguruar punësim në serë për kultivimin e luleve. Gjithashtu, ato bëjnë edhe punime artizanale. Të dënuara me probleme mendore, qëndrojnë në një vend me të dënuarët e tjerë. Në zbatim të nenit 29/3 Ligji nr. 8328 datë 16.04.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarëve me burgim" nuk bëhet kujdes i veçantë për sëmundjet psikike si dhe nuk funksionojnë shërbimet speciale në ndihmë të grave. Në burg nuk bëhen vizita gjinekologjike, vetëm në rastet e urgjencës dërgohen në maternitetin e Tiranës. Në farmaci është e punësuar një ndihmës mjeke gjë e cila bie në kundërshtim me ligjin, pasi ky person nuk ka arsimin përkatës.

D. GRATË DHE VAJZAT E MINORITETEVE RROME DHE EGJYPTIANE NË SHQIPËRI

Një ndër çështjet kryesore të diskriminimit është edhe ajo e grave dhe vajzave të minoriteteve. Në Shqipëri janë prezente dhe jetojnë disa minoritete, ndër të cilat mund të përmendim: Romët, Egjiptianët, Arumunët, Maqedonasit, Boshnjakët, Grekët dhe Serbo-malazezët. Të gjitha minoritetet deklarojnë se të drejtat e tyre jo gjithmonë respektohen dhe shpesh ata ndjehen të diskriminuar. Meqënëse diskriminimi apo trajtimi i padrejtë shtrihet pak a shumë mbi të gjitha minoritetet, shpesh çështja e respektimit të të drejtave të grave dhe vajzave të minoriteteve lihet në harresë.

Në këtë raport ne kemi paraqitur gjendjen e vajzave dhe grave të minoriteteve Rome dhe Egjiptiane, për shkak se situata e tyre, krahasuar me minoritetet e tjera është shumë herë më e rëndë dhe diskriminuese, kjo edhe për shkak të varfërisë që mbizotëron në këto dy grupe.

Në vitin 2003 Qeveria e Shqipërisë miratoi Strategjinë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Minoritetit Rom. Qëllimi i Strategjisë është përmirësimi i kushteve të jetesës së këtij minoriteti i cili vuan gjendjen e rëndë ekonomike e sociale në shoqërinë shqiptare. Strategjia Kombëtare i kushton një vëmendje të veçantë grave dhe vajzave rome, forcimit të pozitës së tyre në familjen rome, luftën e çdo forme diskriminimi ndaj grave dhe vajzave rome dhe programeve speciale për këtë grup synues²⁹.

Dy ndër fenomenet më shqetësues në minoritetin Rrom është niveli i ulët arsimor dhe i punësimit. Arsimi dhe punësimi përveç lidhjes së ndërsjellë që kanë, janë edhe faktorë të rëndësishëm që ndikojnë në problemet ekonomike e sociale të këtij minoriteti. Gruaja Rrome vuan jo vetëm problemet që vuan minoritetit por edhe trajtimin diskriminues që i bëhet asaj brenda familjes dhe minoritetit.

Minoriteti Rrom³⁰. Përgjithësisht, një pjesë e minoritetit Rrom vazhdon të jetojë në familje të mëdha. Ndryshimet e shumta ekonomike, sociale, shoqërore e kulturore, gjithsesi kanë ndikuar në mënyrën e jetesës dhe të organizimit të jetës së tyre. Një pjesë e tyre vazhdojnë të ruajë traditën e migrimit dhe të lëvizjes nëpër qytete duke u marrë në të njëjtën kohë edhe me tregti³¹.

Lidhur me martesat e pjesëtarëve të këtij minoriteti, sidomos të vajzave Rrome në moshë të vogël, mund të thuhet se ka një perceptim të ndryshëm të këtij kësaj çështje në zona të ndryshme gjeografike të vendit ku banon popullsia Rrome. Minoriteti Rrom i vendosur në Shqipërinë e mesme ka një mentalitet më konservator lidhur me çështje të ndryshme sociale³² duke përfshirë këtu edhe martesat në moshë të re të vajzave Rrome. Ndërkohë këto koncepte kanë ndryshuar me ndryshimin e gjendjes ekonomike dhe sociale si edhe falë shkallës së arsimimit të individëve të minoritetit Rrom siç është rasti i këtij minoriteti në qytetin e Korçës dhe atë të Fierit³³. Falë përpjekjeve kryesisht nga aktorë të ndryshëm të shoqërisë civile dhe kryesisht të OJF-ve rome në këto zona, mendësitë e minoritetit rom për këtë çështje kanë filluar të ndryshojnë. Kështu në këtë drejtim janë realizuar një sërë veprimtarish të ndryshme ndërgjegjësuese dhe trajnime lidhur me planifikimin familjar³⁴.

Për sa i përket martesave të të rinjve romë ato vazhdojnë të jenë të pranishme në moshë të vogël. Ky fenomen është më i ndjeshëm tek vajzat rome të cilat detyrohen të krijojnë familje në moshë të shumë të vogla.

²⁹ Kapitulli II, pika 2.1.2 e kësaj strategjie.

³⁰ Për përgatitjen e këtij materiali është shfrytëzuar raporti i vëzhgimit të zbatimit të Strategjisë Kombëtare "Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit Rom", realizuar nga Fondacioni SOROS.

³¹ Këtë traditë e ruan ende minoriteti Rom i vendosur në Elbasan.

³² Këto informacione janë marrë nga takimi me drejtuesen e shoqatës "Gruaja rome e së nesërme".

³³ Të dhënat janë marrë nga korrespondentët e KSHH-së në këto qytete në intervistat me përfaqësues të këtij minoriteti, me sektorin e OJF-ve etj.

³⁴ Këto informacione janë marrë nga takimi me drejtues të shoqatës "Gruaja rome e së nesërme".

Megjithë nismat e marra kryesisht nga sektori i OJF-ve dhe vetë përpjekjet e përfaqësuesve të këtij minoriteti, mbetet shumë për të bërë sidomos nga përfaqësuesit e organeve të qeverisjes vendore, në drejtim të integritit të mëtejshëm të minoritetit Rom, sidomos në fushën e ndërgjegjësimit të vajzave dhe grave rromë për rolin e tyre të rëndësishëm në këtë drejtim si edhe për problemin shqetësues të martesave të vajzave rromë në moshë të vogël.

Minoriteti Egjiptian³⁵: Përveç minoritetit Rom, një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet edhe komunitetit egjiptian. Megjithë përpjekjet e këtij komuniteti për t'u njohur si minoritet, deri më sot ai nuk është njohur si i tillë nga Parlamenti ose Qeveria shqiptare. Komuniteti egjiptian nuk ka gjuhë të vetë, por flet gjuhën zyrtare shqipe. Megjithatë ai dallon nga pjesa tjetër e popullsisë nga tiparet fizike dhe traditat e zakonet që ai ka.

Komuniteti egjiptian gjendet i përhapur kudo në Shqipëri. Në zonat rurale banon një pjesë e vogël e tij, pasi shumica është e vendosur në qytete, në lagje me emra karakteristike dhe që, historikisht, njihen nga të gjithë, si lagjet e 'jevgyje'. Në Tiranë ka disa përqendrime, po kështu ka egjiptianë të vendosur pothuajse kudo: në Kavajë, Lushnjë, Cërrik, Elbasan, Gjirokastër, Vlorë, Korçë, Delvinë, Përmet, Këlcyrë, Berat, Shkodër etj. Ata dallohen si popullsi paqësore, ndaj dhe rastet e kriminalitetit nga ky komunitet nuk janë tipike. Gruaja në komunitetin egjiptian është dyfish e diskriminuar. Diskriminimi i tyre ndjehet si brenda komunitetit, ashtu edhe nga shoqëria në përgjithësi.

Në shumicën e familjeve të komunitetit egjiptian ekziston mentaliteti i tillë që gratë dhe vajzat brenda familjes nuk trajtohen me të drejta të plota. Komuniteti Egjiptian jeton në kushte të vështira ekonomike dhe sociale. Një pjesë e tij është e integruar në shoqërinë shqiptare, ndërsa pjesa tjetër jeton në varfëri të tejskajshme. Gratë janë shtëpiake, ndërsa burrat merren me punë që mund t'u gjenden për momentin.

Përsa i përket punësimit të grave dhe vajzave egjiptiane, ai është i vështirë për disa arsye ndër të cilat është nivei i ulët profesional dhe mospranimi i tyre për shkak të përkatësisë së tyre në këtë komunitet bashkëshoqëruar me të gjitha karakteristikat e familjeve të varfra.

Mbi 95 për qind e martesave të tyre bëhen brenda komunitetit dhe kjo jo vetëm për çështje tradite dhe kompaktësie të komunitetit, por ndoshta edhe për shkak të paragjyqimeve për komunitetin. Pasojë e dhembshme e situatës së rëndë ekonomike dhe sociale, kulturore dhe arsimore në këtë komunitet është dhuna ndaj grave në familje. Brenda familjes gruaja ka diskriminim. Kjo dukuri është e theksuar tek pjesa e komunitetit e cila nuk është e integruar në shoqërinë shqiptare, por jeton në kushte të varfërisë së tejskajshme.

Ashtu si minoriteti Rom, komuniteti egjiptian ka nivel të ulët arsimor. Shqetësuese është dukuria e braktisjes së shkollës. Ndër të tjera, dukuria e braktisjes së shkollës është e lidhur edhe me mendësinë që ekziston tek familjet egjiptiane për t'i martuar vajzat në moshë shumë të vogël, 12-13 vjeçe. Ndikim mjaft të madh jopozitiv tek fëmijët kanë prindërit, të cilët i detyrojnë ata të braktisin shkollën. Ka shumë raste që vajzat megjithëse kanë ecuri të mirë në shkollë, prindërit i largojnë për shkak të mentalitetit që ky komunitet ka, duke e konsideruar shkollën jo si një mjet emancipimi dhe integrimi për komunitetin, por si faktor të prishjes së moralit të vajzave të tyre. Braktisja e shkollës është më e madhe tek vajzat³⁶.

Me këmbënguljen e mësuesve shpesh është arritur të binden prindërit që të lejojnë vazhdimin e shkollimit të fëmijës. Sigurisht, faktorët kryesorë që ndikojnë në mosfrekuentimin e shkollës dhe braktisjen e saj mbeten kushtet jo të mira ekonomike, punësimi i fëmijëve në mosha shumë të vogla si dhe mungesa në përgjithësi e predispozicionit të familjeve egjiptiane për shkollim.

E. GRATË DHE VAJZAT E PREKUARA NGA HIV / AIDS NË SHQIPËRI

Për shkak të mentalitetit që mbizotëron sot në Shqipëri gratë dhe vajzat HIV pozitive janë më të diskriminuara dhe të paragjykuara se meshkujt. Gjatë viteve të fundit është vënë re se ka një rritje të prevalencës së HIV në Shqipëri edhe pse nisur nga numri i rasteve të diagnostikuara konsiderohet ende si vend me prevalencë të ulët ndaj virusit. Tendenca e përgjithshme që vihet re në të gjithë botën, ku AIDS-i ka fytyrën e grave dhe fëmijëve, po vihet re edhe në Shqipëri.

³⁵ Për më shumë shih "Minoritetet në Shqipëri", publikim i KSHH-së, Tiranë më 2004

³⁶ Të dhënat janë marrë nga takimi që KSHH ka realizuar me Z. Fuat Mehmeti, kryetar i shoqatës "Vllazërimi i Egjiptianëve të Shqipërisë"

Numri i femrave HIV pozitive ka ardhur në rritje, në mënyrë të veçantë pas vitit 2000. Sipas Institutit të Shëndetit Publik deri në vitin 2000 gratë dhe vajzat përbënin 28.7 përqind të rasteve të diagnostikuara me HIV/AIDS në Shqipëri. Gjatë viteve të fundit kjo shifer ka ardhur në rritje dhe raporti nga 4:1 në favor të meshkujve, në fillim të shfaqjes së fenomenit, po shkon në raportin 2:1 në favor të meshkujve. Rezultatet e fundit flasin për 62 raste të grave të diagnostikuara me virusin HIV. E rëndësishme është të theksohet se shumica e tyre janë gra familjare të cilat janë infektuar si pasojë e sjelljeve me risk të bashkeshorteve të tyre, të cilët i perkasin popullsisë migruese.

Shumica e rasteve janë diagnostikuar pasi nënat kanë lindur edhe fëmijë, gjë që ka sjellë si pasojë lindjen e fëmijëve të infektuar nga virusi HIV nëpërmjet rrugës vertikale të transmetimit. Në institucionet e shëndetit parësor dhe ato të planifikimit familjar akoma nuk ekziston një personel i specializuar që të ofrojë metoda efikase në fushën e kujdesit dhe këshillimit të nënave të reja për t'u sugjeruar që krahas analizave të tjera të parashikuara në protokollin e grave shtatëzëna, të kryhet edhe testimi për HIV si një masë parandaluese për transmetimin nga nëna tek fëmija.


Në aspektin ligjor nuk ekzistojnë mekanizmat e mjaftueshëm mbrojtës për grate dhe vajzat HIV pozitiv, për të bërë të mundur sigurimin e të drejtave të tyre njerëzore, ofrimin e shërbimeve cilesore dhe të specializuara, mbrojtjen ndaj stigmës dhe diskriminimit, përfshirjen e tyre në skemat e shërbimeve sociale si kategori në nevojë, sidomos në rastet kur bashkëshorti i tyre ka vdekur si pasojë e AIDS-it dhe ato duhet të kujdesen jo vetëm për shëndetin e tyre, por edhe për të siguruar të ardhura ekonomike për familjen dhe fëmijët.

NENI 3 – NXITJA E BARAZISË³⁷

Përputhja e legjislacionit shqiptar me nenin 3 të Konventës mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit të Gruas mund të përshkruhet si e mjaftueshme. Përgjegjësia e shtetit për problemet gjinore është e shpërndarë në disa struktura qeveritare, në nivel kryeministri, ministri apo qarku. Ligji për Barazinë Gjinore krijon disa struktura të ngarkuara për të marrë masat e nevojshme dhe për të zbatuar ligjet kundër diskriminimit.

Së pari, Ligji për Barazi Gjinore krijon një këshill konsultativ: Komitetin Ndërmintor, i cili i raporton Këshillit të Ministrave. Ky komitet ka për detyrë të vërë në jetë politikat shtetërore për barazinë gjinore, të përgatisë dhe nxisë programe si dhe të kontrollojë situatën e çështjeve gjinore në vend. Përshkrimi i funksioneve dhe përbërjes së tij konkrete iu është lënë akteve nënligjore³⁸. Sipas nenit 12 të Ligjit për Barazi Gjinore, ku Komiteti Ndërmintor funksionon si organ mbikqyrës i Komitetit për Barazi Gjinore. Ky i fundit ka këto detyra: a) i propozon Komitetit Ndërmintor programe dhe plane veprimi për promovimin e barazisë gjinore; b) i raporton Komitetit Ndërmintor për situatën e balancës gjinore në shoqërinë shqiptare; c) informon Komitetin Ndërmintor për veprimtarinë e nëpunësve të barazisë gjinore në shkallë vendi; d) ofron trainime në fushën e barazisë gjinore e) organizon mbledhjen e statistikave gjinore; f) përgatit programe dhe plane veprimi për arritjen e barazisë gjinore; g) drejton dhe monitoron zbatimin e programeve të miratuara nga Komiteti Ndërmintor; h) ndërmerr fushata sensibilizimi për ndërgjegjësimin e shtetasve për një shoqëri të barabartë gjinore; i) bashkëpunon me përfaqësuesit e lëvizjes feministe si dhe me organizma ndërkombëtare.

Diagrama më poshtë përfaqëson strukturat e krijuara në nivelin qendror dhe lokal nga Ligji për Barazinë Gjinore (Grafik 1):



Deri në miratimin e Ligjit për Barazinë Gjinore, Komiteti për Mundësi të Barabarta, një strukturë që i parapriu krijimit të Komitetit për Barazi Gjinore, kishte pika fokale në çdo ministri. Ato siguronin transmetimin e të dhënave me bazë gjinore midis Komitetit dhe ministrisë përkatëse. Ligji i ri, megjithatë, kur iu referohet nëpunësve të barazisë gjinore, i përmend ata në kuadrin e nivelit lokal (të qarkut), jo në nivel ministror. Në qoftë se këto struktura (pikat fokale gjinore) kanë qenë efektive në të shkuarën, ose konsideroheshin të rëndësishme, do të kish qenë mirë që këto jo vetëm të përmendeshin në Ligjin e ri të Barazisë Gjinore, por edhe të përcaktohej statusi i tyre, detyrat dhe përgjegjësite, me qëllim që t'i konsolidonte ato.

³⁷ Të dhëna të marra nga Raporti për Vlerësimin e Zbatimit të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas në Shqipëri. Botim i USAID Shqipëri, përgatitur nga Chemonics International. Tiranë, Dhjetor 2005

³⁸ Neni 13, paragrafi 2 i Ligjit për Barazi Gjinore thotë: “Përbërja, organizimi dhe funksionimi i këtij Komiteti do të përcaktohet në urdhrin që nxjerr Kryeministri”

Është me rëndësi të vëmë në dukje se neni 17 i Ligjit për Barazi Gjinore shfuqizon aktet nënligjore që krijojnë Komitetin për Mundësi të Barabarta dhe që përshkruanin organizimin dhe funksionimin e tij. Këshilli i Ministrave duhet të kishte nxjerrë vendime të reja për krijimin e komitetit të ri pasues dhe të rregullonte organizimin dhe funksionimin e tij. Këto masa nënligjore duhet të ndërmerren sa më parë sepse Komiteti për Mundësi të Barabarta (tashmë i quajtur Komiteti për Barazi Gjinore) tani për tani nuk ka status *de jure*.

Një strukturë e dytë, Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale, është organi publik që ka përgjegjësinë për zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore në fushën e punës. Ministri drejton dhe kontrollon veprimtarinë e strukturave në varësi të tij/saj. Me qeverinë e re të krijuar nga shtatori 2005, Ministri përfshin edhe Shanset e Barabarta në titullin e tij, që do të thotë se ministria do të përqëndrohet edhe në çështjet e barazisë gjinore përveç punës dhe çështjeve sociale.³⁹

Diagrama e mëposhtme përfaqëson organet që zbatojnë dhe mbikëqyrin zbatimin e Ligjit për Barazinë Gjinore në fushën e punës dhe punësimit (Grafik 2):

Zbatimi i Ligjit për Barazinë Gjinore në Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale



Organi i tretë që siguron zbatimin e ligjeve anti-diskriminuese është sistemi gjyqësor. Një person që pretendon se ka pësuar diskriminim në çfarëdo sferë të jetës mund t'i bëjë kërkesë gjykatës dhe të invokojë ose nene të veçanta të Konventës mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit të Gruas, të Kodit të Punës apo edhe të drejtën kushtetuese për barazi dhe mosdiskriminim.

Institucioni i Avokatit të Popullit është një krijesë e re në sistemin juridik dhe shtetëror shqiptar. Avokati i Popullit mund të kryejë hetime apo të hartojë raporte në bazë të ankesave nga qytetarët për veprime të ndërmarra nga organet publike, duke përfshirë këtu edhe diskriminimin për çfarëdo shkak. Megjithatë Avokati i Popullit nuk ka ndonjë seksion të veçantë për çështjet gjinore.

Mekanizmi kryesor kombëtar për zbatimin e barazisë gjinore deri në fund të vitit 2005 ishte Komiteti për Mundësi të Barabarta (KMB). KMB-ja është organizëm qëndror që qeveriset nga QSH. KMB-ja mbështet institucionalisht promovimin e interesave të grave, *inter alia*, zbatimin e politikave të qeverisë për çështjeve të grave dhe familjes, koordinimin dhe vlerësimin e programeve, hartimin e propozimeve për legjislacionin e ri dhe/apo amendamente për legjislacionin ekzistues për të drejtat e familjes dhe grave në përputhje me standartet ndërkombëtare dhe mbështet aktivitetet e OJF-ve në lidhje me gratë dhe familjen.

Megjithë kërkesat e qarta dhe të vijueshme të organizmave ndërkombëtarë, Mekanizmi për Gruan në vendin tonë nuk është fuqizuar ndonjëherë siç duhet në këto 15 vjet, në përputhje me rekomandimet e dhëna në konferencat e ndryshme botërore për gruan, ku Shqipëria ka qenë palë, si dhe me nevojën shoqërore për progres dhe barazi të vërtetë. Padyshim që pamja do të ishte e ndryshme nga sa përjetojmë sot, nëse kërkesat për një status të ri të gruas shqiptare do të ishin vlerësuar si pjesë integrale e zhvillimit të vendit dhe e integritit në BE.

Struktura shtetërore për gruan e ka zanafillën që në fund të vitit 1991, si Sektor për Gruan pranë Komitetit të Punës e Pagave, në vitin 1994 u fuqizua si Drejtori pranë Ministrisë së Punës dhe Përkrahjes Sociale deri në vitin 1996 kur u ngrit në shkallën më të lartë si Sekretariat Shteti për Gruan dhe Rininë pranë Ministrisë së Kulturës.

³⁹ Titulli i plotë i ri për kreun e këtij institucioni të rëndësishëm është Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanset e Barabarta. Përshkrimi që i është bërë këtij institucioni më lart do të vazhdojë të ruajë emërtimin e mëparshëm : Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale, pasi ky është edhe përkufizimi që i jepet në Ligjin për Barazi Gjinore.

Në vitin 1997 u formulua përsëri pranë Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale si Drejtori “Gruaja dhe Familja” deri në korrik 1998 kur u ngrit në Institucion në varësi të Këshillit të Ministrave, i emërtuar Komiteti Gruaja dhe Familja. Në mars 2001 krijohet Komiteti për Mundësi të Barabarta me fokus të veçantë ndaj integritit gjinor në politikat qeveritare, ndërsa në vitin 2003 ulet sërish niveli i Komitetit dhe ai vendoset në varësi të Ministrit të Punës. Në vjeshtë 2004, me miratimin nga Parlamenti të “Ligjit për Barazinë Gjinore” ai kalon sërish në varësi të Zëvendës-Kryeministrit dhe në pranverë të vitit 2006, Komiteti për Barazinë Gjinore kthehet në sektor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shanseve të Barabarta, në MPÇSSHB. Siç shihet, lëkundjet me amplitudë të gjerë të mekanizmit shtetëror për gruan e të mundësive të barabarta midis grave dhe burrave, dëshmojnë jo vetëm për paqartësi në ide dhe perspektivë të ligjvënësve dhe qeverisësve, por edhe për një nënvlerësim të vijueshëm, pasi hidh e prit nga një degë në tjetrën, nuk krijohet as traditë, as kujtesë dokumentare, as autoritet institucional”.⁴⁰

NENI 4 – BARAZIA NDËRMJET BURRIT DHE GRUAS

A. MASAT POLITIKE DHE LEGJISLATIVE

Me miratimin e Kodit të ri të Familjes, i cili sjell ndryshime thelbësore, sot Shqipëria është duke përshkuar një periudhë kalimtare përsa u përket normave ligjore të së drejtës familjare. Legjislacioni shqiptar e ka sanksionuar barazinë gjinore sipas standardeve të përparuara demokratike. Ligjet kryesore përmbajnë referime mbi të drejtat e grave, si:

1 – Kushtetuta e Shqipërisë (1998) në nenin 18-të të saj, përcakton se të gjithë shtetasit janë të barabartë përpara ligjit dhe se askush nuk mund të diskriminohet për shkaqe të tilla, si: gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore e sociale.

2 – Konventa mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskrimimit ndaj Grave (CEDAW), e ratifikuar në vitin 1993 nga qeveria shqiptare. Në nenin 11 theksohet se shtetet të cilat e kanë ratifikuar këtë konventë duhet të marrin masat e nevojshme për të siguruar të drejta të barabarta mes grave dhe burrave.

3 – Kodi Civil (miratuar më 03.05.2001, Ligji Nr. 8781) u njeh grave të drejta të barabarta në të gjitha proceset ligjore, siç është e drejta për të ngritur padi ndaj dikujt apo për t'u gjykuar.

4 – Kodi Penal (miratuar më 21.03.1995, Ligji Nr. 7905) siguron barazinë mes burrit dhe gruas në të gjitha fushat e jetës, shëndetit, pronës dhe dinjitetit. Gratë marrin të njëjtat dënime si burrat për krime të njëjta.

5 – Kodi i Punës (miratuar më 29.07.2003, Ligji Nr. 9125) njeh të drejta të barabarta për punë midis burrit e gruas, për mbrojtjen e gruas në vendin e punës, për pushime të paguara dhe pagesë të barabartë. Formulimet e neneve në Kodin e Punës bazohen në standardet ndërkombëtare të punës.

6 – Kodi i Familjes (miratuar më 08.05.2003, Ligji Nr. 9062) parashikon të drejta të barabarta mes burrit dhe gruas që të zgjedhin lirisht për t'u martuar apo divorcuar, si dhe të drejtat e detyrat e ndërsjella në familje për edukimin dhe rritjen e fëmijëve.

7 – Ligji për Barazinë Gjinore në Shqipëri (miratuar më 01.07.2004) plotëson kuadrin ligjor lidhur me të drejtat e barabarta mes burrit dhe gruas. Ky ligj konsiston në vendosjen e të dyja seksëve në pozita të barabarta në fushën e punësimit, arsimit, vendimmarrjes, kundër diskriminimit dhe ngacmimeve seksuale. Përveç kësaj, ky ligj parashikon ndëshkim ligjor në rast se konstatohen shkelje të tij. Ligji për Barazinë Gjinore futi për herë të parë konceptin e masave të veçanta të përkohshme në legjislacionin shqiptar.⁴¹ Megjithatë, është e paqartë për çfarë procesesh vendimmarrjeje dhe në cilat institucione (zyrat shtetërore, institucionet publike apo private apo të gjitha së bashku) gjen zbatim kjo normë. Veç kësaj, termi “procedurë përzgjedhjeje” lë mjaft hapësirë për interpretim.

⁴⁰ Materiali është marrë nga artikulli me titull: “Përse një Mekanizëm Shtetëror për Barazinë Gjinore”, shkruar nga Lavdie Ruci dhe botuar në gazetën “Korrieri”, datë 21 gusht 2006, fq.16

⁴¹ Neni 10, paragrafi (d) parashikon: “Për të rregulluar raportet gjinore në institucione, në procesin e vendimmarrjes, gjatë procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve, me vlerësime të barabarta në testim e kualifikime dhe eksperiencë të njëjta, përparësi duhet të ketë zgjedhja e një konkurrenti grua.”

Ligji duhet të saktësojë nëse trajtimi preferencial do të gjejë zbatim në procesin e marrjes në punë të nëpunësve civile apo të punonjësve të tjerë, apo do të zbatohet edhe për ngritjet në detyrë, trainimet për vendin e punës apo edhe specializime të mëtejshme.⁴² Aktualisht për përmirësimin e këtij ligji po punon OSBE dhe UNDP. Pritet që ndryshimet t'i kalojnë Parlamentit për miratim së shpejti.

8 - Ligji mbi dhunën në familje. Më 28 tetor 2004, organizata të ndryshme Shqiptare krijuan një Aleancë ‘ad hoc’ e përbërë nga: “Zyra për Mbrojtjen e Qytetarëve”, “Qendra e Aleancës Gjinore për Zhvillim”, “Qendra Avokatore e Gruas”, “Qendra e Këshillimit për Gra dhe Vajza”, “Klinika Ligjore për të Miturit”, “Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”, “Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin”, “Në Dobi të Gruas Shqiptare”, Shoqata “Refleksione” dhe “Strehëza për Gratë e Dhunuara”. Qëllimi i kësaj Aleance ishte të nxiste një iniciativë ligjore kundër dhunës në familje në Shqipëri. Kjo iniciativë është fokusuar në këto çështje: hartimin e projekt-ligjit mbi dhunën në familje; propozimin e këtij projekt-ligji në Parlamentin Shqiptar; organizimin e debateve publike dhe lobimin e këtij projekt-ligji tek institucionet vendimmarrëse shqiptare. Aktualisht projekt-ligji pritet të miratohet nga Kuvendi. Ligji për dhunën në familje u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë në Dhjetor 2006 dhe ai do të hyjë në fuqi në Qershor 2007.

9- Ligji për Shëndetin Riprodhues (miratuar më 4 Prill 2002, nr. 8876). “Çdo grua e lire dhe e përjashtuar nga çdo formë diskriminimi, detyrimi dhe dhune, ka të drejtë për t’u kontrolluar e për të vendosur lirisht për të gjitha çështjet që lidhen me seksualitetin e saj dhe shëndetin seksual dhe riprodhues.⁴³ Neni 8-të i këtij ligji thekson “Ky ligj i garanton çdo individ vendim-marrjen për ushtrimin e të drejtave riprodhuese sipas dëshirës dhe interesit të tyre, të lirë nga diskriminimi, detyrimi dhe dhuna. Nga ana tjetër ky ligj i ofron mbështetje të posaçme dhe shërbime shëndetësore nënës dhe fëmijës.⁴⁴

10- Platforma e qeverisë shqiptare për barazinë midis gruas dhe burrit për periudhën 2002-2005⁴⁵ parashikonte këto katër drejtime: (1) barazia gjinore në pushtet dhe vendimmarrje; (2) çështjet ekonomike dhe sociale; (3) shëndeti dhe (4) arsimiti. Një nga objektivat kryesore të kësaj platforme ishte kushtimi i vëmendjes së veçantë grave të zonave rurale, të cilat janë më të diskriminuara dhe pothuajse më të shkëputurat nga jeta sociale e ajo politike e vendit, për shkak të paragjykimëve ekzistues, nivelit të ulët arsimor e kulturor. Grumbullimi i të dhënave statistikore lidhur me statusin e grave, tendencat, botimet periodike dhe shpërndarja e informacionit bazuar në çështjet e përkatësisë gjinore, është një hap i rëndësishëm në hartimin e politikave sociale me qëllim arritjen e barazisë gjinore.

Pavarësisht masave politike dhe legjislativë të ndërmarra, duhet thënë se barazia mes burrit dhe gruas në realitetin shqiptar nuk egziston dhe është shumë e cënuar në të gjitha fushat e jetës. Kjo sepse nuk egzistojnë mekanizmat e përshtatshëm për monitorimin e zbatimit në praktikë të të gjitha masave të sipërcituara. Po kështu bëhet shumë pak përsa i përket sensibilizimit të vetë kategorive përfituese dhe veçanërisht grave lidhur me mundësitë që ekzistojnë dhe janë të parashikuara ligjërisht për përmirësimin e situatës së tyre. Për shembull, mungesa e transparencës në zbatimin e masave të përkohshme të parashikuara në ligj, kontribuon në uljen në masë të konsiderueshme të besimit tek gratë, në lidhje me funksionimin e masave të tilla.

42 Të dhëna të marra nga Raporti për Vlerësimin e Zbatimit të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas në Shqipëri. Botim i USAID Shqipëri, përgatitur nga Chemonics International. Tiranë, Dhjetor 2005

43 Ligji për Shëndetin Riprodhues, nr. 8867, datë 4 prill 2002, neni 6

44 Ligji për Shëndetin Riprodhues, nr. 8867, datë 4 prill 2002, neni 13/2

45 Platforma e Qeverisë për Barazinë midis Burrit dhe Gruas. Për vitet 2002 – 2005. përgatitur nga Komiteti për Mundësi të Barabarta.

NENI 5 – STEREOTIPET E SHOQËRISË⁴⁶

A. FUSHATA KOMBËTARE INFORMIMI PËR TË ELIMINUAR STEREOTIPET GJINORE

QSH nuk ka organizuar fushata kombëtare informimi për të adresuar eliminimin e stereotipeve gjinore. Pjesa më e madhe e kësaj pune është ndërmarrë nga OJF-të që specializohen në çështjet gjinore.

Sesione trainimi janë bërë pothuajse në të gjithë Shqipërinë dhe kanë synuar grupe të ndryshme grash dhe burrash të grupmoshave, niveleve arsimore dhe profesioneve të ndryshme. Megjithatë, kjo punë është e koordinuar dobët. Pjesëmarrësit/et përmendën që mungesa e koordinimit mund të ketë rezultuar në shpërdorim të burimeve.

Media. Gazetarët dhe reporterët vijnë nga një mjedis që është i mbushur me stereotipe që diskriminojnë gratë. Ata janë të prirur të reflektojnë këtë realitet. Për shembull, një pjesëmarrëse kujtoi një kronikë në Ditën Ndërkombëtare të gruas (8 Marsin) që pasqyroi arritjet e mëdha të grave në arsimim, por nuk përmendi që në nivelin universitar, shumica e pozicioneve udhëheqëse në arsim ende mbahen nga burrat. Të tjera mënyra që media mund të ushqejë stereotipet është duke bërë raportim të pjesshëm ose duke i paraqitur gratë si objekte kënaqësie. Gratë mbivlerësohen seksualisht në reklama për linja komerciale telefonike për sjellje seksuale. Një studim që monitoroi se si media e shkruar përshkruante dhunën në familje në 2001-2002 arriti në përfundimin se media përforcon stereotipet gjinore të ndeshura në shoqërinë shqiptare duke etiketuar gratë, një përdorim jo profesional të fjalorit në përshkrimin e grave dhe të gjurmuarit e lajmit sensacional me shumë pak konsideratë për analizën e çështjeve (Gjermani & Bregu, 2003).

B. PËRGJEGJËSIA E PËRBASHKËT E TË DY PRINDËRVE NË RRITJEN E FËMIJËVE

Shqipëria ka për të bërë një rrugë të gjatë në fushën e ndarjes së barabartë të përgjegjësive të prindërimit në rritjen e fëmijëve. Në fakt, shteti shqiptar ka bërë pak në këtë drejtim. Për shembull, legjislacioni shqiptar nuk lehtëson lejen e baballarëve kur lindin fëmijë. Mjediset e mëdha të punës që punësojnë shumë gra nuk kanë shërbime për fëmijët.

Megjithatë, problemi kryesor qëndron me traditën – përgjegjësia për të rritur fëmijët nuk ndahet mes prindërve dhe gratë mbajnë ende peshën kryesore, pavarësisht nga fakti që ato mund të jenë të punësuar jashtë shtëpisë.

Stereotipet kalohen te brezi i ri nëpërmjet prindërimit, megjithëse ka ndryshime se si realizohet kjo, sidomos në grupet që kanë jetuar në Tiranë për një kohë të gjatë dhe imigrantëve që kanë lëvizur në periferitë e Tiranës së fundi. Shteti mund të hartojë legjislacionin që ndihmon në këtë drejtim. Shoqëria civile e ka bërë një gjë të tillë, d.m.th. edukimin, në 15 vjetët e fundit. Megjithatë nuk ka kërkitime se sa kjo punë ka sjellë ndryshim në sjellje.

⁴⁶ Të dhëna të marra nga Raporti për Vlerësimin e Zbatimit të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas në Shqipëri. Botim i USAID Shqipëri, përgatitur nga Chemonics International. Tiranë, Dhjetor 2005

NENI 6 – TRAFIKIMI DHE PROSTITUCIONI

A. LEGJISLACIONI DHE POLITIKAT KOMBËTARE KUNDËR TRAFIKIMIT DHE PROSTITUCIONIT TË GRAVE DHE VAJZAVE

Në frymën e Protokollit të Palermos, “Për parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe të fëmijëve”, në plotësim të Konventës së Kombeve të Bashkuara “Kundër Krimit të organizuar ndërkombëtar”, ratifikuar nga Shqipëria në vitin 2002, u bënë ndryshime të rëndësishme në Kodin Penal në lidhje me veprat që ndëshkojnë trafikimin e grave.

Trafikimi i femrave për prostitucion, parashikuar me një dispozitë të posaçme në Kodin Penal shqiptar në vitin 2001, nënkuptonte shitblerjen e këtyre femrave në mënyrë të fshehtë, me mashtrim ose me dhunë, për të siguruar fitime të paligjshme nga trafikantët. Për shkak se femrat shfrytëzohen jo vetëm për prostitucion, ligjvënësi i dha kësaj dispozite karakter më të përgjithshëm duke e titulluar “Trafikimi i femrave”.

Në nenin 114/b trafikimi i femrave përfshin rekrutimin, transportimin, transferimin, fshehjen ose pritjen e femrave nëpërmjet kërcënimit ose përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës ose përfitimit nga gjendja shoqërore, fizike a psikike ose dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve, për të marrë pëlqimin e një personi që kontrollon një person tjetër, me qëllim: a) shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual; b) të punës ose shërbimeve të detyruara; c) të skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin; d) të vënies në përdorim ose transplantimit të organeve; e) si dhe formave të tjera të shfrytëzimit.

Duket se ligjvënësi nuk kufizon format e trafikimit të femrave duke përfshirë edhe format e tjera të shfrytëzimit që çmohen si të tilla nga organet e drejtësisë. Kodi Penal parashikon si masë dënimi për këtë veprë penale dënimin me burg nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga tre milion deri në gjashtë milion lekë.

Duke pasur parasysh se trafikimi i femrave është një nga format më të ashpra të krimit të organizuar, Kodi Penal parashikon dënime të rënda edhe për subjektet që kryejnë organizimin, drejtimin dhe financimin e trafikimit të femrave. Kodi Penal parashikon masa dënimi më të rënda kur ky krim ka sjellë si pasojë vdekjen e viktimës. Konsiderohen si rrethana cilësuese kryerja e kësaj veprë në bashkëpunim ose më shumë se një herë, kur ajo shoqërohet me keqtrajtim ose kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror.

Megjithëse nuk ka një përcaktim për prostitucionin, ai konsiderohet si veprë penale. Kodi Penal, në seksionin e “Veprave Penale kundër moralit dhe dinjitetit” përcakton katër figura veprash penale që lidhen drejtpërdrejt me ushtrimin e prostitucionit: ushtrimin e prostitucionit (neni 113-masa e dënimit me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet), shfrytëzimin e prostitucionit (neni 114-masa e dënimit me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet), trafikimin e femrave për prostitucion (114/b-masa e dënimit me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga tre milion deri në gjashtë milion lekë) si dhe mbajtjen e lokaleve për prostitucion (neni 115-masa e dënimit me gjobë ose me burgim gjer në dhjetë vjet).

Ndërkohë që pas vitit 2001 shohim një rizgjim të Shtetit shqiptar në luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore, ku më të prekurat ishin vajzat dhe gratë. Për këtë qëllim gjatë viteve 2002-2006, Qeveritë në vazhdim miratuan një sërë strategjish dhe mekanizmash kombëtarë për të luftuar kundër trafikimit.

Në vitin 2002 Ministria e Rendit Publik përgatiti në bashkëpunim me shoqërinë civile Strategjinë e parë Kombëtare kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore. Kjo strategji përfaqëson dokumentin e parë politik të Shqipërisë dhe kohëzgjatja e saj shtrihej deri në vitin 2004. Ndërkohë gjatë vitit 2005 Qeveria shqiptare miraton dy strategji të reja kundër trafikimit: Strategjinë Kombëtare për Luftën Kundër Trafikut të Qënieve njerëzore (2005-2007) dhe Strategjinë Kombëtare në luftën kundër Trafikimit të Fëmijëve (2005-2007).

B. SITUATA E TRAFIKIMIT TE GRAVE DHE VAJZAVE NE SHQIPERI

1. Trafikimi ndërkombëtar i grave dhe vajzave

Trafikimi i grave dhe vajzave për një kohë të gjatë ka përbërë një nga shkeljet më të rënda të të drejtave të grave në Shqipëri. Ndonëse trafikimi i qënieve njerëzore ishte bërë një problem shqetësues dhe mjaft serioz, Qeveria shqiptare gjatë këtyre viteve nuk kishte ndërmarrë asnjë masë, për ta parandaluar dhe evituar atë.

Nga fundi i vitit 2001 e në vazhdim, Qeveria Shqiptare, nën presionin e partnerëve ndërkombëtare dhe shoqërisë civile në Shqipëri, filloi të merrte masat e para, të cilat do të ndikonin ndjeshëm në luftën kundër trafikimit të grave dhe vajzave. Përkrah përmirësimit të legjislacionit, u ngritën edhe një sërë strukturash shtetërore kundër trafikimit të grave dhe fëmijëve. Ndër këto struktura mund të përmendim: Qendra Ndërkombëtare Antitrafik në Vlorë; Zyrat e Luftës Kundër Trafikimit në çdo Drejtori Policie të Qarkut; Gjykata e Krimeve të Rënda; Prokuroria e Krimeve të Rënda dhe Qendra Kombëtare Pritëse.

Një nga organizatat kryesore që ka punuar me gratë dhe vajzat viktime të trafikimit ishte Qendra Vatra. Kështu Vatra në vitin 2001, ngriti të parën *Strehëz* në vend për gratë dhe vajzat viktime të trafikimit. Qëllimi i ngritjes së Strehëzës ishte që, gratë dhe vajzat viktime të trafikimit njerëzor, të mund të ndiheshin të qeta, të trajtoheshin me dinjitet dhe brenda dëshirës së tyre, të mund të përfitonin më tej nga shërbimet e ndryshme që ofroheshin.

TABELA 1: Grup mosha e grave dhe e vajzave të përfshira në trafikim (Të trajtuara nga Vatra)

Grup mosha	2002	2003	2004	2005	2006
13- 18 vjec	78	52	48	43	18
19- 25 vjec	131	107	109	86	57
Mbi 26 vjec	80	75	74	66	27

TABELA 2: Zonat nga vijnë gratë dhe vajzat (Të trajtuara nga Vatra)

Vitet	Zonat urbane	Zonat rurale
2002	172	104
2003	116	115
2004	112	119
2005	81	114
2006	49	57

Gjatë vitit 2005-2006 situata e zhvillimit të trafikimit të qënieve njerëzore në Shqipëri ka ndryshuar në formë dhe në përmbajtje. Edhe pse trafiku në vend po vjen në rënie, ai prezantohet tani në dy forma: a) Riciklimit të viktimave përsëri në trafik; b) Trafikimit të brendshëm që zhvillohet nëpërmjet prostitucionit ditor në vend. Nisur nga kjo situatë e krijuar mund të themi se Shqipëria vërtet nuk është më vend tranziti i fenomenit të trafikimit të qënieve njerëzore, por ajo vazhdon të mbetet vend i origjinës së tij.

Nga studimet dhe analizat e vazhdueshme që janë zhvilluar ndër vite shihet se rreth 50.2 përqind e viktimave të trafikuar vijnë nga minoritetet Egjiptiane dhe Rrome. Përveç faktorit ekonomik, i cili është evident për të gjithë komunitetet në Shqipëri, ato çka dallojnë tjetër keto dy komunitete janë: a) Mentaliteti: lidhet me qëndrimin që mbajnë ndaj fenomenit të prostitucionit në përgjithësi; b) Tradita: martesat në moshë të vogël ose të pazelebruara, martesat brenda fisit etj. c) Edukimi: nivel i ulët arsimor ose mungesë arsimimi; d) Mosregjistrimi i fëmijëve, evidente kjo te komuniteti Rrom.

2. Trafikimi i brendshëm i grave dhe fëmijëve

Trafikimi i grave dhe vajzave përbën një shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut në Shqipëri. Ndër faktorët që favorizojnë fenomenin është gjendja e paqëndrueshme ekonomike dhe politike. Varfëria e përhapur, mungesa e kontrolleve kufitare

dhe korrupsioni, janë faktorë të tjerë që favorizojnë trafikimin. Ndonëse të dhënat e fundit nga Ministria e Brendshme tregojnë se trafikimi i fëmijëve është në shifra shumë të ulëta, kjo do të thotë se fëmijët vazhdojnë të shfrytëzohen ende për qëllime seksuale apo ekonomike.⁴⁷

Fëmijët që punojnë dhe fëmijët e rrugës përfaqësojnë kategorinë më të vuajtur, më të prekshme dhe më pak të mbrojtur të fëmijëve, të cilët janë të ekspozuar më shumë se çdo grup tjetër ndaj rrezikut të trafikimit. Vetëm në Tiranë më shumë se 800 fëmijë jetojnë si lypës, shitës ambulantë, ilustraxhinj etj.⁴⁸ Rreth 50 përqind e këtyre fëmijëve janë vajza. Afro 50 mijë fëmijë nën moshën 18 vjeçare punojnë me orë të plotë ose të pjesshme në Shqipëri.⁴⁹

Në Shqipëri mungojnë të dhënat për fëmijët e trafikuar brenda vendit dhe që shfrytëzohen për punë apo lypje, ndërkohë që në vetëvete fenomeni është evident dhe përbën një nga problemet më shqetësuese për fëmijët. Shfrytëzimi ekonomik i fëmijëve përbën një fenomen kompleks. Mungesa e sistemit të mbrojtjes dhe kujdesit ndaj fëmijës bën që fëmijët që punojnë dhe fëmijët e rrugës të kthehen në viktime të veprave penale si vjedhja apo shpërndarja e drogës dhe substancave të tjera të ndaluara me ligj.⁵⁰

Mungesa e sistemit të referimit dhe të shërbimeve të kualifikuara e bën të vështirë rehabilitimin e fëmijëve që punojnë dhe fëmijëve të rrugës. Shërbimet ekzistuese, ndonëse janë të pakta, ofrohen vetëm nga sektori i OJF-ve, ndërkohë që shërbimet shtetërore pothuajse nuk ekzistojnë.

Ndërkohë Shoqata Vatra ka më shumë se 2 vjet, mbështetur në faktet dhe informacionin e grumbulluar në lidhje me funksionimin e rrjeteve të trafikimit brenda vendit, që ka ngritur shqetësimin pranë institucioneve shtetërore përgjegjëse, me qëllim marrjen e masave për ta luftuar atë. Duke qenë se trafikimi i brendshëm është një fenomen i ri dhe i patrajtuar më parë nga institucionet shtetërore, nuk ka informacion të saktë mbi shkallën e zhvillimit dhe të përhapjes së tij. Kjo ka bërë që ky fenomen të mbetet ende i pastudiuar.

Viktimat që ushqejnë trafikun e brendshëm janë veçanërisht vajzat e rritura, që janë riatdhësuar nga shtete të ndryshme të BE-së, të cilat kërkojnë përsëri të rikthehen në po ato vende nga dhe ku kanë ardhur. Kjo për faktin se për vite të tëra jo vetëm që janë mësuar me kushte të tjera të jetesës, por edhe për faktin se nuk sigurojnë të ardhura të mjaftueshme për të jetuar. Të gjitha këto kanë bërë që trafikimi i brendshëm, të zhvillohet dhe të funksionojë si një biznes fitimprurës për shumë trafikantë, të cilët e stimulojnë dhe mbajnë gjallë atë.

Gjithashtu nga të dhënat që Qendra “Vatra” ka grumbulluar gjatë intervistimit të viktimave, ka rezultuar se fenomeni i trafikimit të brendshëm funksionon si një rrjet i mirëfilltë kombëtar, i cili në bazë të tij, ka të gjithë elementët e trafikimit të qenieve njerëzore. Një numër i konsiderueshëm që rekrutohen nga zona të thella veriore, ose jugore të vendit, transportohen dhe shoqërohen nga trafikantë ose protektorë të ndryshëm, të cilët sipas zonave i vendosin viktimat e tyre, në hotele dhe motele larg vendeve të origjinës së tyre.

E.H. është një vajzë e mitur 17 vjeçe nga një fshat i Shqipërisë së Veriut, dhe ka mbi një vit, që qëndron në një qytet bregdetar. Është mashtruar nga një person që i premtoi martesë, por që prej një viti e shfrytëzon në prostitucion në një hotel të madh të këtij qyteti.

Punon në çdo kohë, varet sipas klientëve që i sjellin. Ditën punon si kamariere, por ka edhe një dhomë në hotel. Te gjitha paratë që fiton ia jep shfrytëzuesit të saj dhe kur ka ndonjë nevojë ai ia plotëson. Ai vazhdimisht e mashtron duke i thënë se paratë i kanë të përbashkëta, i ka mbyllur në bankë, por E nuk ka më besim. Ajo është e detyruar të punojë.

Shprehet se në familje nuk mund të kthehet, sepse jo vetëm që nuk e pranojnë por mund t'i marrin edhe jetën.

Në sezonin turistik, në hotelin ku ajo punon ishin 6 vajza, të cilat vinin nga zona të thella të Shqipërisë Veriore dhe VerilindoreTë gjitha kishin nga një çun.

47 Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri – CRCA. Studim i Përbashkët Lindje - Perëndim mbi trafikimin e fëmijëve për qëllime të shfrytëzimit seksual në Europë: Vendet dërguese, Raport për Shqipërinë. Tiranë 2004-2005.

48 Strategjia Kombëtare për Fëmijët, Republika e Shqipërisë, Komiteti për të Drejta të Barabarta.

49 Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri – CRCA. Studim “Puna e Fëmijëve dhe Fëmijët e Rrugës në Shqipëri”. Tiranë 2005-2006.

50 Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri – CRCA. Studim “Puna e Fëmijëve dhe Fëmijët e Rrugës në Shqipëri”. Tiranë 2005-2006.

3. Ri-trafikimi i viktimave

Vatra deklaroi se nga të dhënat e mbledhura mbi 57.5 përqind e numrit total të vajzave janë ritrafikuar përsëri. Nëse do të analizonim nga afër se cili është profili i vajzave dhe grave që ritrafikohen, shohim se ato vijnë nga grupe që kanë probleme të mprehta sociale, varfëri ekonomike, dhe shpesh janë vetë ato, të cilat kërkojnë një tutor të ri, me qëllim rikthimin përsëri në po ato vende nga dhe ku janë riatdhesuar. Janë pikërisht këto gra dhe vajza, që përbëjnë burimin kryesor jo vetëm të trafikimit të qenieve njerëzore, por edhe të fenomenit të ri që po zhvillohet sot në vend, trafikimit të brendshëm.

Gjatë intervistave të kryera nga Qendra “Vatra”, vajzat kanë pohuar faktin që riciklimi i tyre në trafik, ndihmohet dhe nga kalimi i ligjshëm me lehtësi i kufirit në pikat kufitare që lidhin Shqipërinë me Maqedoninë, Kosovën dhe Greqinë.

A. nga një fshat i Fierit ishte trafikuar në moshën 9-vjeçare nga një djalë i po asaj zone. Për tre vjet ishte shfrytëzuar në tregun e lypsave në Greqi. Në moshën 12 vjeçare shitet te një tjetër trafikant, i cili e shfrytëzoi atë në prostitucion, po në këtë shtet. Mbas 3 vjetësh kapet nga Policia e këtij shteti dhe riatdhesohet. Kishte 6 vjet që ishte larguar, kishte harruar gjuhën dhe familjen e saj.

4. Mbrojtja e grave dhe vajzave viktime të trafikimit

Lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore nuk mund të zhvillohet dhe nuk mund të kuptohet pa denoncimin, gjykimin dhe dënimin e trafikantëve. Në vitin 2004, Parlamenti Shqiptar miratoi ligjin për mbrojtjen e dëshmitarit, ligj ky që ende nuk ka gjetur zbatim për asnjë viktimë të trafikimit dhe prostitucionit. Vatra mendon se për vetë kushtet aktuale të Shqipërisë, ligji nuk mund të jetë i zbatueshëm për këto shkaqe:

Së pari, Shqipëria është vend i vogël me një territor gjeografik prej 28 000 km². Kudo që të mund ta strehosh viktimën, kurrë nuk mund t’i japësh asaj siguri për jetën, sepse ajo kurrë nuk mund të bëjë një jetë të qetë dhe normale në cilindo qytet jugor apo verior qoftë. Grupet kriminale të interesuara për të, do ta gjejnë kudo që të jetë strehuar, sepse këto grupe kriminale veprojnë në të gjithë Shqipërinë.

Së dyti, mbrojtja e dëshmitarit ka një kosto të lartë financiare që mund të jetë e papërbalueshme për shtetin Shqiptar;

Së treti, zbatimi i ligjit kërkon zbatimin e shumë procedurave të cilat për t’i plotësuar dhe përgatitur kërkojnë kohë të gjatë. Mangësitë e treguara në zbatim të ligjit si dhe zvarritjet burokratike bëjnë që gratë dhe vajzat të ndjehen të frikësuara dhe për këtë qëllim ato kërkojnë që të largohen përgjithnjë nga Shqipëria.

5. Shfrytëzimi i prostitucionit⁵¹

Prostitucioni mbahet i fshehur në Shqipëri dhe shpesh është shumë i vështirë për t’u dalluar. Gratë dhe vajzat zakonisht përbuzen nëse praktikojnë prostitucionin. Nëpërmjet përpjekjeve të OJF-ve dhe ndërgjegjësimit të gjykatësve/eve dhe juristëve/eve, rastet e viktimave të trafikut të trajtuara si prostituta ka rënë ndjeshëm.

Midis përfaqësuesve të forcave policore, u shpreh shqetësimi se policia duhet të identifikojë njerëzit që e mbajnë prostitucionin, jo vetëm të arrestojë viktimat. Dhuna kundër grave që praktikojnë prostitucionin nuk raportohet në polici ose në institucione të përshtatshme. Besohet se meqenëse prostitucioni kriminalizohet, gratë janë të frikësuara për të raportuar probleme të tilla. Një përfaqësues i policisë komentoi që ligji i mbrojtjes së dëshmitarëve është shumë i ri dhe ka një numër problemesh juridike dhe financiare. Mbrojtja e dëshmitarëve kërkon bashkëpunimin nga vende të tjera. Që ky ligj të interpretohet në mënyrë korrekte është i nevojshëm bashkëpunimi për aprovimin e akteve të tjera ligjore.

⁵¹ Të dhëna të marra nga Raporti për Vlerësimin e Zbatimit të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas në Shqipëri. Botim i USAID Shqipëri, përgatitur nga Chemonics International. Tiranë, Dhjetor 2005

6. Vetëvrasja tek gratë dhe vajzat

Dukuria e vetëvrasjeve në përgjithësi dhe e vetëvrasjeve të femrave në veçanti, përbën shqetësim për komunitetin dhe shoqërinë shqiptare. Nga evidentimi i ngjarjeve të raportuara nga strukturat e luftës ndaj krimit të Policisë së Shtetit gjatë dhjetë mujorit të vitit 2006, rezultojnë 180 raste të vetëvrasjeve, nga të cilat 71 raste ose 40 përqind e tyre janë bërë nga femrat. Në të njëjtën periudhë të vitit 2005 janë evidentuar 195 raste të vetëvrasjeve, nga të cilat 81 raste ose 42 përqind e tyre janë bërë nga femrat.⁵²

Raportet gjinore, nxjerrin në dukje se në vetëvrasje dominojnë ato të bëra nga burrat. Është interesant fakti se, këto tregues nuk sinkronizojnë me raportin e përmbysur të dhunës familjare, ku viktimat janë në rastin më të madh vajzat dhe gratë. Konstatohet se, pjesa më e madhe e akteve vetëvrasëse të grave dhe vajzave, janë kryer në zonat fshatare: 45 nga 71 raste, ndërsa në qytete është më e ulët, në 26 raste. Shumica e personave të vetëvrasurë janë me arsim tetëvjeçar.

Sipas grupmoshave, vetëvrasjet e grave dhe vajzave, paraqiten si më poshtë:

- Dominojnë në vetëvrasje vajzat dhe gratë me moshë 16-25 vjeç.
- Vetëvrasjet në moshat e vogla, kryesisht i përkasin nxënësve të shkollave 9 vjeçare. Nga të dhënat operative rezulton se ato në të shumtën e rasteve janë shkaktuar si rezultat i grindjeve në familje.
- Numri më i ulët i vetëvrasjeve tek gratë është në moshat 56-65 vjeç.

Vetëvrasjet e femrave, sipas muajve, paraqiten: mesatarisht kanë kryer aktin e vetëvrasjes 18 vetë në muaj, nga këto femra, 7 në muaj. Intesiteti më i madh i akteve të vetëvrasjeve të grave dhe vajzave gjatë vitit 2006, shënohet në muajt qershor, gusht, janar dhe tetor. Ndërsa, numri më i vogël i vetëvrasjeve të femrave është shënuar në muajin korrik vetëm me një rast. Duke gjykuar mbi mesataren botërore për 100.000 banorë, në vendin tonë ka një tendencë në rritje drejt nivelit të mesëm.

Ky fenomen krahas faktorëve të zakonshëm, (si vetmia tek moshat e vjetra, sëmundjet psikike etj), gjykojmë se ka ndodhur për shkak të kthimit të emigrantëve nga jashtë për pushime ose të kthyer pa dëshirën e tyre, të dhunuarve psikologjikisht, ballafaqimi me problemet ekonomike, të cilat shërbejnë për krijimin apo rindezjen e konflikteve kryesisht në familjet e reja, si dhe për motive të dobëta apo dhe për shkak të afrimit të sezonit të provimeve për nxënësit e shkollave, ankthi që pushton fëmijët me dobësi në mësim për shkak të presionit të familjes në kërkim të rezultateve të larta prej tyre, etj.

Ndonëse vetëvrasjet e femrave rezultojnë në ulje, 71 raste në vitin 2006, nga 81 në të njëjtën periudhë të vitit 2005, vihet re se numri më i lartë i tyre, është kryer nëpërmjet helmimit, kryesisht me fostoksinë. Aktualisht fostoksina gjendet shumë lehtë në treg dhe në një farë mënyre, lehtëson marrjen e vendimit për aktin e vetëvrasjes. Krahasuar me 10 mujorin e vitit 2005, në periudhën 10 mujore të vitit 2006, janë rritur vetëvrasjet e femrave me fostoksinë, me 27 raste, ose 14 më shumë.

Po kështu prezenca e armëve të zjarrit ka një ndikim të dukshëm në kryerjen e aktit të vetëvrasjes nga femrat. Pjesa tjetër i përket realizimit të aktit nëpërmjet mbytyjes në ujë, hedhjes nga lartësitë si taraca banesash, spitalesh apo dhe nga muret e kalasë. Po ashtu janë evidentuar raste të prerjes së damarëve, vetëgoditjes me sopatë, me thikë etj.

Duke konstatuar se në mjaft raste shkak i vetëvrasjeve është dhuna e ushtruar ndaj femrave, merr një rëndësi të veçantë puna për të parandaluar dhunën ndaj femrave, si dhe për të ndjekur me prioritet dhe vënë para përgjegjësisë ligjore cilindo që ushtron dhunë ndaj femrave.

Në këtë situatë faktike në lidhje me vetëvrasjet e kryera nga femrat ka ndikuar edhe mos zbatimi sa dhe si duhet i nenit 99 të Kodit Penal “Shkaktimi i vetëvrasjes”, i cili parashikon se kur kjo vepër ose tentativa e vetëvrasjes është kryer si rrjedhojë e trajtimit të keq sistematik ose nga sjellje që prekin rëndë dinjitetin e personit është kryer nga personi që e ka në vartësi materiale apo në varësi tjetër, ajo dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

⁵² Të dhëna nga Ministria e Brendshme, Tiranë 2006.

NENI 7 dhe 8: DISKRIMINIMI NË JETËN POLITIKE E PUBLIKE

A. ASPEKTET LIGJORE TË DISKRIMINIMIT

Neni 45 i Kushtetutës afirmon të drejtën zgjedhore si të drejtë dhe liri themelore me karakter politik. Të drejtat politike në këtë kuadër të gjerë përfshijnë lirinë e shprehjes, lirinë e asociimit dhe asamblesë, e drejta për të marrë pjesë në qeverinë e një vendi, e drejta e votës dhe pjesëmarrjes në zgjedhje periodike, nëpërmjet votës së fshehtë.

E drejta e votës është një nga të drejtat më të rëndësishme. Burrat dhe gratë pa asnjë kufizim për shkak të seksit e gëzojnë këtë të drejtë, pra janë titullarë të së drejtës zgjedhore. Vota është e barabartë për çdo zgjedhës, pra ajo ka vlerë të njëjtë pavarësisht seksit. Janë dy cilësi të votës mjaft të rëndësishme me të cilat jo rrallë abuzohet. Vota është e lirë dhe vetjake.

Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë⁵³ përshkohet nga parimi se çdo shtetas ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet pa dallim race, etnie, gjinie, gjuhe, bindjeje politike, besimi ose gjendjeje ekonomike.

Sipas shume institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare, që monitorojnë zgjedhjet në Shqipëri, nuk mungojnë rastet e imponimeve familjare ndaj gruas për të votuar ose edhe votimi familjar, që vazhdon të përbëjë një shqetësim për zgjedhjet në Shqipëri.

Një e drejtë tjetër është e drejta për tu organizuar. *Kjo e drejtë garantohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë për të gjithë qytetarët pa dallime gjinore.* Neni 46 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë sanksionon se kushdo ka të drejtë të organizohet kolektivisht për çfarëdo qëllimi të ligjshëm. Në Shqipëri, gratë janë organizuar në parti politike, në forumet e partive përkatëse si Forumi i Gruas i Partisë Socialiste, Forumi i Gruas i Partisë Demokratike, Forumi i Gruas Lëvizja Socialiste për Integrim, etj. Ka arritje pozitive në lidhje me organizimin e grave në organizata të ndryshme, jofitimprurëse, veprimtaria e të cilave ka një qëllim të ligjshëm.

Vlen të përmenden edhe të ashtuquajturat “të drejtat e pjesëmarrjes”. Rritja e numrit të grave në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë mbetet një sfidë. Të drejtat e pjesëmarrjes në përgjithësi konsiderohen se i përkasin kategorisë së të drejtave themelore, duke qenë kusht paraprak për mbrojtjen e të gjitha llojeve të të drejtave themelore.

Ligji “Për Barazinë Gjinore në Shoqëri” merr përsipër të përcaktojë rrugët e realizimit të pjesëmarrjes së barabartë të burrit dhe gruas në procesin e vendimmarrjes, nëpërmjet: sigurimit të mundësive të barabarta në hartimin dhe zbatimin e politikave shtetërore në nivel qendror e vendor dhe politikave të institucioneve private; përkrahjes së balancuar të burrave dhe grave në procesin e menaxhimit dhe marrjes së vendimeve nga partitë politike dhe organizatat jofitimprurëse; krijimit të mundësive të barabarta gjinore nga drejtuesit e lartë të organeve shtetërore që propozojnë kandidatura të rëndësishme; kriteret e njëjta rekrutimi, vlerësimi e seleksionimi nga DAP dhe departamentet e personelit në institucionet e pavarura; rregullimit të raporteve gjinore në institucione duke përzgjedhur një konkurente grua në raport me një konkurent burrë kur vlerësimi për kualifikimin e tyre është i njëjtë. Sigurimi në praktikë i realizimit të këtyre të drejtave paraqet vështirësi.

Krahasuar me vende të tjera, përfaqësimi i grave në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë është në nivele të ulëta. Po bëhen përpjekje nga aktorë të ndryshëm të shoqërisë civile për të rritur pjesëmarrjen e grave në organet politike. Sistemet zgjedhore që praktikohen nuk janë në gjendje të na ofrojnë një ekuilibër gjinor të përfaqësuesëve të zgjedhur. Vendosija e sistemit të kuotave po konsiderohet si një mekanizëm mjaft i rëndësishëm. Kuotat për gratë nuk përbëjnë një diskriminim kundrejt burrave por një kompensim për pengesat strukturore me të cilat gratë ndeshen gjatë proceseve zgjedhore. Kështu po bëhen përpjekje për të përcaktuar një sistem kuotash së bashku me sanksionet për moszbatimin e tyre. Ndërtimi i një platforme për të harmonizuar legjisllacionin shqiptar në lidhje me barazinë gjinore (Kodi Zgjedhor dhe Ligji “Për një shoqëri gjinore të barabartë”), do të sillte nevojën e parashikimit nga këto akte të masave të veçanta dhe të përkohshme për të arritur balancën gjinore.⁵⁴

⁵³ Ligji Nr.9087,dt.19.06.2003,neni 3

⁵⁴ Aurela Anastasi, Gazeta “Ndryshe”, “Pjesëmarrja e grave në politikë vendimtare”, Tiranë,16 Gusht 2006.

B. LËVIZJA E GRUAS DHE PjesmARRJA NË JETËN POLITIKE DHE PUBLIKE

1. Pjesmarrja e grave dhe vajzave në jetën politike.⁵⁵

Edhe pse Zgjedhjet Parlamentare 2005 shënuan një numër të madh të pjesëmarrjes së grave në zgjedhje si kandidatë për deputete, në fund të zgjedhjeve, Shqipëria nxori numrin më të vogël të grave deputete. Nga 101 kandidatë për deputete nga lista maxhoritare, u zgjodhën vetëm 8 prej tyre. 2 gra tjera u zgjodhën si deputete nga listat proporcionale, duke bërë që numri i përgjithshëm i grave deputete të jetë 10 nga 140 deputetë që ka Kuvendi i Shqipërisë. Krahasuar me zgjedhjet e mëparshme, Kuvendi i dalë nga Zgjedhjet e vitit 2005 ka vetëm një deputete më shumë. Gratë në kuvend përbëjnë vetëm 7 përqind krahasuar me 93 përqind të deputetëve burra.

Shqipëria konsiderohet si vendi me numrin më të vogël të grave që marrin pjesë në politikë dhe që kanë poste në zyrat publike. Në një hulumtim të Bashkimit Ndërparlamentar, Shqipëria renditet e 114-ta nga 187 vende dhe e fundit krahasuar me vendet e tjera të Europës Jugore.

Partia me numrin më të madh të grave deputete është Partia Socialiste (4 gra), e shoqëruar nga Partia Demokratike (3), Partia Social-Demokrate (2) dhe Partia Republikane (1). Partitë e tjera prezente në Kuvendin e Shqipërisë nuk kanë deputete gra.

Është e vështirë për një grua në Shqipëri të marrë pjesë aktivisht në politikë. Edhe pse ka modele pozitive të grave nga të gjitha partitë politike, shumica e tyre ballafaqohen me një mjedis të vrazhdë politik. Dominimi i Kuvendit të Shqipërisë dhe i politikës nga ana e burrave bën që gjuha politike shpesh të jetë e ashpër dhe e dhunshme, një model i vështirë për t'u pranuar nga gratë. Shpesh gratë në politikë renditin dhunën dhe fjalorin e vrazhdë si njërin nga shqetësimet kryesore për të hyrë në jetën politike.⁵⁶

E dyta, organizimi i grave brenda partive politike është shumë i dobët. Shumica e partive kanë forume politike të grave, por ato shfaqen më shumë si sfond i bukur i partisë, sesa një mjet për të rritur pjesëmarrjen e grave në politikë. Asnjëri nga forumet e grave brenda partive politike nuk ka buxhet të vetin. Ato kryesisht varen nga donacionet e biznesmenëve, apo nga kryetari i partisë. Proçesi i bërjes së politikave në këto forume është shumë i kufizuar dhe shpesh nuk merret në konsideratë nga ekzekutivi i partisë.

E treta, imponimi i kuotës për pjesëmarrjen e grave në politikë përfaqëson një debat të ri publik në Shqipëri. Kodi Zgjedhor i 2005-ës nuk vuri ndonjë kuotë për gratë. Kjo ishte një çështje që kurrë nuk u bë pjesë e diskutimeve të mbajtura mes partive politike për Kodin. Disa parti para dhe pas zgjedhjeve iniciuan një proçes për vendosjen e kuotës për pjesëmarrjen e grave, por ajo nuk pati sukses. Në disa raste gratë ishin kundër kuotës për pjesëmarrjen e grave, pasi sipas tyre ajo krijon idenë se gratë nuk janë të suksesshme, prandaj ato kanë nevojë për një kuotë në mënyrë që t'u garantohet një vend në politikë.

Gratë kandidatë për deputete u ballafaquan me një garë të ashpër gjatë fushatës zgjedhore të vitit 2005. Shumë gra vendosën kandidaturën për deputete në zona të vështira ose u përballën me një kandidat-burrë të ashpër. Kur kandidatët burra ishin më të dobët, ata shpesh u panë të përdornin fjalor negativ kundër kandidatëve gra ose vunë në pyetje vlerat morale të tyre.⁵⁷

⁵⁵ "Zgjedhjet Parlamentare 2005 dhe të Drejtat e Njeriut në Shqipëri" – Raport Kombëtar për Zgjedhjet Parlamentare 2005 dhe promovimin e të drejtave të njeriut nga Partitë politike në Shqipëri. Pwrgatitur nga Altin Hazizaj. Botim i Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri. Botuar ne Tiranë, Dhjetor 2005

⁵⁶ "Zgjedhjet Parlamentare 2005 dhe të Drejtat e Njeriut në Shqipëri" – Raport Kombëtar për Zgjedhjet Parlamentare 2005 dhe promovimin e të drejtave të njeriut nga Partitë politike në Shqipëri. Pwrgatitur nga Altin Hazizaj. Botim i Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri. Botuar ne Tiranë, Dhjetor 2005

⁵⁷ "Zgjedhjet Parlamentare 2005 dhe të Drejtat e Njeriut në Shqipëri" – Raport Kombëtar për Zgjedhjet Parlamentare 2005 dhe promovimin e të drejtave të njeriut nga Partitë politike në Shqipëri. Pwrgatitur nga Altin Hazizaj. Botim i Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri. Botuar ne Tiranë, Dhjetor 2005

2. Organizimi i lëvizjes së shoqërisë civile për gratë dhe vajzat

Periodha 1994-1996 ishte një periudhë dinamike edhe për evoluimin e lëvizjes së grave në Shqipëri dhe pasqyronte klimën politikisht të favorshme për vetë kushtet nëpër të cilat po kalonte vendi. Megjithatë, ndërmjet grupeve të OJF-ve të grave të krijuara në mes të viteve 1990, kishte pak ose shumë pak komunikim.⁵⁸ Gjatë viteve 1995-1999 vihet re një proces gradual drejt *pjekurisë dhe krijimit të rrjetit të bashkëpunimit* të organizatave të grave. Si pasojë e rritjes së pjekurisë së tyre nisën të institucionalizohen disa rrjete të këtyre organizatave si grupime rreth synimeve të mëposhtme: a) Ndërmarrja e veprimtarive të përbashkëta (Federata e Gruas Shqiptare, Millenium); b) Bashkëpunimi në përpunimin e strategjive të përbashkëta (Këshilli Kombëtar i Gruas Shqiptare).

Një karakteristikë e veçantë e këtyre organizatave është ofrimi i shërbimeve sociale për kategoritë më të prekshme të shoqërisë. Nga banka e të dhënave që ekziston në Qendrën e Aleancës Gjimore për Zhvillim rezulton se nga 110 OJF të regjistruara të grave, 23 përqind prej tyre punojnë në fushën e avokatisë; 18 përqind kryejnë misionin Gruaja dhe Familja (fëmijët); 11 përqind punojnë në fushën e ekonomisë; 10 përqind në të kulturës; 9 përqind në informim; 6 përqind në këshillim dhe shërbime të drejtpërdrejta; 6 përqind kanë në qendër gruan në zonat rurale; 4 përqind e këtyre OJF-ve u përkasin Forumeve Politike të grave; 2 përqind kanë si drejtim punën në fushat e vendimmarrjes, shëndetit, fesë, edukimit, medias, punësimit dhe trafikimit.

Me gjithë arritjet e lëvizjes së gruas në Shqipëri, ajo ende përballet me sfida e vështirësi, si e gjithë shoqëria shqiptare. Ajo çka vihet re është nevoja për bashkëpunim dhe koordinim të aktiviteteve, programeve dhe projekteve, me qëllim që të shtohet impakti i kësaj lëvizjeje në zhvillimet sociale dhe politike të vendit. Një vështirësi me të cilën po përballet të gjitha organizatat jofitimprurëse në këto vitet e fundit, është largimi i donatorëve të huaj nga Shqipëria. Në këto kushte, mundësitë për të mbijetuar janë kufizuar dhe konkurrenca është rritur. Vazhdimësia e shërbimeve sociale të ofruara prej tyre do të bëhet e mundur vetëm nëse shteti – në nivel qendror apo vendor – ose biznesi do të mbështetin financiarisht veprimtaritë e tyre.

3. Pjesëmarrja e grave në vendim-marrje

Pjesëmarrja e gruas në proceset vendim-marrëse dhe në politikë në veçanti, mbetet në nivele shumë të ulëta, krahasuar kjo edhe me vende të tjera të Europës Lindore e Qendrore. Niveli i pjesëmarrjes së gruas në politikë është i kushtëzuar nga cilësia e zhvillimit demokratik të shoqërisë; nga zhvillimi ekonomik, social dhe kulturor i vendit; nga trashëgimia dhe mentalitetet ekzistuese; mënyra e edukimit dhe pritshmëritë që ka shoqëria për vajzat dhe djemtë; veçoritë që ka periudha e tranzicionit në Shqipëri, etj.

Tabela 3: Përbërja e Parlamentit, Qershor 2005⁵⁹

Posti	Meshkuj	Femra	% Femra
Kryetar parlamenti	0	1	
Nënkryetar Parlamenti	2	0	
Kryetarë të Komisioneve Parlamentare	7	1	13
Deputetë Parl.	140	10	7
Kryetarë të Grupeve Parlamentare	9	0	0

58 Fondacioni "Shoqëria e Hapur për Shqipërinë - SOROS, 90+10 Gruaja në tranzicionin post komunist, konferencë kombëtare, Tiranë 12 mars 2001, f. 23-24.

59 INSTAT, Femra dhe Meshkuj në Shqipëri, Tiranë 2005

Tabela 4: Pjesëmarrja e Gruas në Qeveri, Qershor 2005⁶⁰

Pozicioni	Numri		%	
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra
Kryeministër	1	0		
Zv/Kryeministër	1	0		
Ministra	17	1	94	6
Zv/Ministra	23	6	79	21
Sekretar i Përgjithshëm	15	2	88	12

Ndërsa përsa i përket pozicioneve të pushtetit vendor, sërish niveli i pjesëmarrjes së grave është tepër i ulët. Në zgjedhjet e fundit vendore (Tetor 2003) nga 76 kandidatë (gra dhe burra) për kryetarë bashkie kanë fituar vetëm 3 gra, si kryetare të 3 njësive bashkiake të Tiranës, pra rreth 4 përqind e kandidatëve.⁶¹ Ndërsa për pozicionin kryetar komune, nga 308 kandidatë femra dhe meshkuj, kanë fituar vetëm 6 gra, pra vetëm 2 përqind e kandidatëve.

C. ASPEKTE PRAKTIKE TË ZBATIMIT TË LIGJIT

Shqipëria vazhdon të mbetet një vend me popullsi të re dhe me një shtim mesatar vjetor të popullsisë. Në vitin 2004 ajo numëronte një popullsi mesatare vjetore 3, 127, 263 banorë, nga e cila 50, 2 për qind janë femra.⁶²

Shëndeti. Shqipëria është një nga 183 vendet që aprovuan Planin e Veprimit të Konferencës së Kajros për Zhvillimin Ndërkombëtar të Popullsisë në vitin 1994, i cili e vendos gruan në qendër të shërbimeve shëndetësore riprodhuese me kujdesin shëndetësor parësor.⁶³ Përsa i përket vdekshmërisë amëtare, megjithëse në vitin 2000 ishte 50% më e vogël se në vitin 1990, krahasuar me vendet e tjera evropiane, ajo mbetet përsëri e lartë.⁶⁴

Përsa i përket abortit, ai vazhdon të konsiderohet si një metodë e zakonshme e planifikimit familjar. Egzistojnë një sërë shkaqesh që i detyrojnë gratë të abortojnë, ndër të cilat mund të përmendim faktorët ekonomikë si më kryesorët, të tillë si: varfëria, papunësia; numri i madh i fëmijëve; problemet e strehimit; faktorët shëndetësorë, etj. Një tjetër faktor që duhet përmendur, është rritja e numrit të aborteve në rastet kur pritet që fëmija që do të vijë në jetë të jetë vajzë. Tradicionalisht familja shqiptare ka vlerësuar ardhjen në jetë të djemve për dy arsye kryesore: trashëgiminë e emrit të familjes, si dhe faktin që djemtë do të bëheshin burra e do t'i bënin ballë armiqve. Megjithatë, fakti i aborteve për arsye të gjinisë, tregon mentalitetin patriarkal dhe paragjykes të shoqërisë shqiptare që, megjithë ndryshimet e ndodhura, ka mbetur në përgjithësi shoqëri maskiliste.

Vdekshmëria foshnjore. Vdekshmëria foshnjore, ashtu si ajo amësore, ka shënuar ulje si pasojë e një vargu faktorësh. Politikat dhe shërbimet shëndetësore që janë ofruar nga institucionet shtetërore dhe organizatat jofitimprurëse kanë çuar në uljen e ritmeve të vdekshmërisë foshnjore. Sipas të dhënave nga INSTAT-i, në rrethin e Fierit dhe të Lushnjës vdekshmëria foshnjore kohët e fundit ka pësuar rënie.⁶⁵ Në zonat rurale niveli i vdekshmërisë foshnjore pritet të jetë më i lartë, për shkak të pamundësisë për të marrë shërbimin shëndetësor, si dhe të nivelit të ulët të informacionit lidhur me problemet e shëndetit. Ngritja e qendrave të përkujdesit të nënës e foshnjës, e materniteteve, sidomos në zonat rurale, ku dhe përpjesa e vdekjeve foshnjore është më e lartë, përbën një nga mënyrat për të përmirësuar situatën në këto zona.

60 INSTAT, Femra dhe Meshkuj në Shqipëri, Tiranë 2005

61 Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, nr 8, datë 27 shkurt 2004.

62 Femrat dhe Meshkujt në Shqipëri. INSTAT, Tiranë 2005, fq. 6.

63 Qendra për Nxitjen e Zhvillimit Njerëzor (HDPC), "Përmirësimi i Shëndetit të Nënës." Në: Shqipëria dhe Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit, Përgatitur për Sistemin e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri nga Qendra për Nxitjen e Zhvillimit Njerëzor, Tiranë, Maj 2002 (34)

64 Po aty, fq. 34

65 Strategjia rajonale e zhvillimit të qarkut të Fierit – Në përputhje me Zhvillimin Kombëtar dhe Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit, Bashkimi i njerëzve për të një të ardhme më të mirë të përbashkët, shtator 2003.

Leja e lindjes. Leja e lindjes luan rol shumë të rëndësishëm në lehtësimin e rolit dhe përgjegjësi të grave në familje. Kjo periudhë e paslindjes u krijon grave mundësinë të paguhen, ndërkohë që i përkushtohen rritjes së fëmijës. Në Shqipëri, leja e lindjes është 365 ditë dhe pagesa është 50-80% e pagës. Sigurisht, kjo zbatohet në institucionet shtetërore, ndërsa përsa u përket bizneseve apo ndërmarrjeve private, kjo praktikë në përgjithësi nuk zbatohet. Shpeshherë gratë e vajzat janë të punësuara pa kontrata të rregullta dhe e humbasin vendin e punës qoftë për shkak të lejes së lindjes, qoftë të ndërprerjeve të punës kur kujdesen për shëndetin e fëmijëve. Ndonëse legjislacioni shqiptar pranon mundësinë që leja e lindjes të merret nga të dy prindërit, ai përcakton që babai mund të kërkojë leje të qëndrojë me fëmijën vetëm në rast se fëmija është i sëmurë dhe për një periudhë të shkurtër kohe. Kjo pasqyron stereotipin gjinor, sipas të cilit vetëm nënat mund dhe duhet të kujdesen për fëmijët.

Punësimi. Sipas publikimit të fundit “Femra dhe meshkuj 2005” të INSTAT, të punësuarit zinin 50.3 % të popullsisë në moshë pune. Gjatë vitit 2004 ishin të punësuar rreth 931 mijë persona nga të cilët 578 mijë meshkuj dhe 353 mijë femra.⁶⁶ Në rast se analizohet punësimi sipas gjinisë, vihet re një pjesëmarrje më e ulët e grave dhe vajzave në tregun e punës në krahasim me meshkujt, të cilat përbëjnë 38.9% për qind të të punësuarve gjithsej. Analiza e nivelit të punësimit sipas gjinisë në vite, tregon se gjatë periudhës 1994-2004 niveli i punësimit të femrave ka qënë dukshëm më i ulët se ai i meshkujve. Diferencat midis nivelit të punësimit femra meshkuj janë më të theksuara në sektorin privat jo-bujqësor, ku numri i femrave të punësuara zë vetëm 25%, pjesëmarrja e tyre rritet në sektorin shtetëror ku femrat përbëjnë 43.4 % të të punësuarve, ndërsa në sektorin privat bujqësor nivelet e punësimit janë pak a shumë të njëjta. Këta tregues lidhen me situatën e sotme të tregut të punës ku punësimi i femrave bie për shkaqe si:

- Mbyllja e mjaft aktiviteteve të mëparshme industriale të zhvilluara para viteve 90-të;
- Zhvillimi i aktiviteteve ekonomike të orientuara më shumë nga punësimi i meshkujve si tregtia apo ndërtimi;
- Lëvizja rurale-urbane, e cila nuk u jep shumë mundësi femrave në tregun urban të punës, kjo për shkak të nivelit të ulët të arsimit, nivelit aktual të teknologjive, etj.
- Rikthimit të një sërë paragjykimesh apo stereotipesh gjinore lidhur me punësimin e grave.

Shumica e femrave të punësuara vazhdojnë të punojnë në sektorë në të cilët femrat tradicionalisht kanë qënë më të përqendruara. Kështu në arsim ato përfaqësojnë 67.5 përqind, në shëndetësi rreth 74.7 përqind. Megjithatë dhe në këta sektorë, vihet re që gratë janë të punësuara kryesisht në nivelin e specialisteve dhe kur vjen fjala për postet drejtuese, sërish vendin kryesor e zenë burrat. Pjesëmarrja e tyre bie në grupin industri, hotele e restorante, tregëti, ku meshkujt zënë një përqindje më të lartë. Sektorët ndërtim dhe transport/komunikacion dominohen nga meshkujt.

Papunësia. Sipas INSTAT, në “Femra dhe Meshkuj në Shqipëri, 2005”, në fund të vitit 2004 numëroheshin rreth 157 mijë të papunë të regjistruar, nga të cilët rreth 11 mijë merrnin pagesë papunësie. Pjesa më e madhe e të papunëve, 92.3 për qind e tyre, ishin të papunë afatgjatë (të papunë prej më shumë se 12 muajsh).⁶⁷ Shkalla e papunësisë, në nivel vendi, në fund të vitit 2004, ishte rreth 14.4 për qind. Ky tregues kishte një diferencë gjinore, e cila shprehej me 17.5 për qind për gratë dhe vajzat, kundrejt 12.4 për qind për burrat dhe djemtë. Ky tregues ishte më i lartë në grupmoshat e reja, dhe diferenca femra-meshkuj ishte e pranishme në të gjitha grupmoshat.

Sipas INSTAT gjatë të gjithë periudhës 1994-2004 vihet re një nivel më i lartë i papunësisë tek femrat se sa tek meshkujt. Në grupin e të papunëve të regjistruar, analiza sipas gjinisë tregon se femrat përbëjnë 47.7 % , kjo nuk ka të bëjë me nivelin e papunësisë tek femrat, por me faktin që femrat janë më pak të interesuara të regjistrohen për të kërkuar punë duke parë mundësitë e pakta që ato kanë në tregun e punës. Gjithashtu niveli më i ulët i punësimit tek femrat patjetër që nxjerr më pak femra të regjistruara si të papuna se meshkuj.

Pagat dhe dallimet gjinore. Informacioni për raportet e pagave ndërmjet meshkujve e femrave (INSTAT) tregon se pagat e femrave në sektorin jobujqësor ishin rreth 27 përqind më të ulëta se të meshkujve dhe kjo diferencë ishte më e theksuar për të punësuarit në sektorin privat jobujqësor, në krahasim me të punësuarit në sektorin shtetëror. Ky dallim vihet re në të gjitha moshat dhe pothuaj në të gjitha degët e ekonomisë. Dallimi gjinor në pagë është paksa më i vogël në degët e arsimit dhe të administratës publike, rrjedhojë e faktit që në këto degë mbizotëron sektori shtetëror.⁶⁸ Paga mesatare për një të punësuar në sektorin shtetëror në vitin 2004 është 24,393 lekë.

⁶⁶ INSTAT, Femrat dhe meshkujt në Shqipëri. Fq. 7 Tiranë 2005.

⁶⁷ Po aty (8)

⁶⁸ Femra dhe meshkujt në Shqipëri, INSTAT 2003, fq. 8.

Ndryshimi i çmimeve të konsumit në lidhje me vitin paraardhës prej 2.9 përqind influenoi në një rritje reale të pagës mesatare në sektorin shtetëror prej 11.2 përqind. Ndërkohë që të dhënat, grumbulluar sipas programit statistikor, sigurojnë informacion për pagën mesatare vetëm në sektorin shtetëror, anketa pranë familjeve LSMS 2002, ndjekur nga anketa panel 2003, 2004, mundëson dhënien e informacionit statistikor për pagën mesatare edhe në sektorin privat, si dhe pasqyron raportet e pagave ndërmjet femrave e meshkujve. Të dhënat tregojnë se paga mesatare për meshkuj është rreth 50 përqind më e lartë se ajo e femrave. Analiza më e detajuar sipas degëve të ekonomisë tregon se në buqësi, industri apo shërbime pagat mesatare janë dukshëm më të larta për meshkuj se sa për femra dhe diferenca më e theksuar për të punësuarit me pagë në sektorin privat jobuqësor. Kështu në Industri paga mesatare mujore për vitin 2004 është 19,738 lekë por paga për femrat është më e ulët se ky nivel 14 771 lekë në muaj ndërkohë që për meshkuj është 22,642 lekë në muaj. Diferenca të njëjta vihen re dhe në buqësi e shërbime ku niveli i pagave tek femrat është mjaft më i ulët se paga e meshkujve. Gjithashtu diferencat femra meshkuj në paga vihen re në të gjitha grup moshat.

Të ardhurat sipas gjinisë së kryefamiljarit. Në vitin 2002 të ardhurat mesatare mujore në familjet shqiptare me kryefamiljar mashkull arrin në 35 935 lekë ndërsa në ato me kryefamiljar femër 25 671 lekë. Një analizë e nivelit të të ardhurave sipas gjinisë së kryefamiljarit tregon se ai ndryshon mesatarisht me 29% në nivel vendi gjë që tregon se të ardhurat në familjet me kryefamiljar femra janë ende më të ulta se ato në familjet me kryefamiljar mashkull. Kjo diferencë është e theksuar në Tiranë, rreth 40%, ndërsa është më e vogël në zonat rurale të rajonit Qëndror dhe Malor. Diferenca më e madhe në të ardhurat e familjeve me kryefamiljar mashkull – femër tregon për një pabarazi më të madhe pikërisht në zonat ku niveli i përgjithshëm i të ardhurave është më i lartë, edhe anasjelltas, ky fakt tregon se polarizimi i shoqërisë sjell dizavantazh për këto të fundit.

Diskriminimi në marrjen në punë. Përveç diskriminimit gjinor, diskriminimi moshor është një dukuri tjetër që ndikon në mundësitë e grave dhe vajzave për t'u punësuar. Mundësia e mbetjes shtatzënë bën që disa gra të grupmoshës riprodhuese të mos parapëlqehen për t'u punësuar. Po kështu, nuk parapëlqehen për t'u punësuar edhe gratë mbi moshën 35 vjeç. Me gjithë rregullimet ligjore ekzistuese dhe të drejtat e barabarta që Kushtetuta u jep grave dhe burrave, sërish në njoftimet për punë në shtypin e përditshëm vihen re shenja të diskriminimit gjinor dhe moshor.

Situata e Arsimit në Shqipëri nën Perspektivën Gjinore. Niveli arsimor është një tregues mjaft i rëndësishëm që flet për statusin e grave dhe vajzave në shoqërinë shqiptare. Të dhënat statistikore sipas publikimit të INSTAT “Femrat dhe Meshkujt në Shqipëri 2005” tregojnë se në të gjitha nivelet e arsimit vajzat janë më të suksesshme se djemtë. Sipas statistikave të arsimit në përfundim të çdo viti shkollor nxënës dhe studente vajza janë më shumë se meshkuj pavarësisht se në fillim të çdo viti shkollor ka më shumë meshkuj të regjistruar në krahasim me femrat.

Vajzat në arsimin e lartë zënë 62 përqind të numrit të përgjithshëm të studentëve në 4 vitet e fundit. Për vitin 2004 kjo përqindje është më e lartë në fakultete të ndryshme. Kështu studjojnë 78 përqind femra në fushën e arsimit, 71 përqind në fushën e shëndetësisë dhe 68 përqind në shkencat humanitare dhe artet.

Në zonat rurale të vendit pjesëmarrja e vajzave në shkollë është më e ulët. Shpesh vajzat e reja në zonën rurale pasi përfundojnë arsimin 8-vjeçar, braktisin shkollat dhe merren me punë të ndryshme shtëpiake. Po ashtu mësueset përfaqësojnë 67 përqind të të gjithë stafit të mësuesve në arsimin 8-vjeçar dhe 57 përqind në arsimin e mesëm. Në arsimin e lartë universitar vajzat dhe gratë përbëjnë 50 përqind të stafit të mësimdhënies.

Norma e braktisjes së shkollës. Një fenomen mjaft shqetësues i viteve të fundit është braktisja e shkollës dhe sipas statistikave të fundit kjo normë ka arritur në 2.7 përqind. Kjo rritje e papritur është edhe si rezultat i mendimit që arsimit nuk është rruga e vetme për të siguruar një jetë më të mire. Braktisja e shkollës është në veçanti e dukshme në zonat rurale, ku kushtet e vështira ekonomike detyrojnë fëmijët të braktisin shkollën për të ndihmuar familjet e tyre në punët e bujqësisë. Përveç kësaj, migrimi në shkallë të gjërë nga zonat rurale në qytete krijoi probleme në sigurimin e stafit pedagogjik (veçanërisht në zonat e largëta), si dhe në mbingarkimin e shkollave në qytete me nxënës dhe mbylljen e shkollave në zonat rurale. Përsa u takon vajzave, ato përballesh me vështirësi të tjera për të frekuentuar shkollën, si kushtet jo të pështatshme higjeno-sanitare, infrastruktura dhe largësia nga shkolla (shkollat janë shumë larg dhe transporti i tyre nuk është i siguruar), etj. Fenomeni ka marrë përmasa dramatike në disa qytete, e cila lë të kuptojë se është një shpërndarje gjeografike që përfshin jo vetëm zonat e largëta malore, por gjithashtu edhe qytetet.

Duke iu referuar të dhënave lidhur me braktisjen e shkollës⁶⁹ gjatë vitit shkollor (2003-2004), vihet re se në nivel kombëtar braktisja është e njëjtë si për meshkujt ashtu edhe për femrat. Shifrat ndryshojnë për rrethe të ndryshme. Në këtë kuadër, në disa rrethe braktisja është më e lartë tek vajzat dhe në disa rrethe të tjera është më e lartë tek meshkujt. Në rrethe si Dibra, Kavaja dhe Tirana ka një përqindje të lartë braktisje të vajzave, ndërsa në rrethe si Kukësi dhe Dibra vihen re përqindje të larta braktisjeje nga meshkujt.

Gruaja në zonat rurale. Sipas raportit të përgatitur nga Qendra e Gruas “Përkatësia gjinore dhe bujqësia” në vitin 2003,⁷⁰ është vënë re mungesa e të dhënave nën këndvështrimin gjinor në fushën e bujqësisë. Përveç kësaj, për shkak të roleve të trefishta që gratë kanë në familje dhe komunitet, u vu re ngarkesa e madhe me të cilën përballen gratë dhe vajzat e zonave rurale, duke dhënë një kontribut të madh në fushën e bujqësisë.

Vihten re tendenca e përfshirjes gjithnjë e më të madhe të grave, të cilat mbajnë një peshë të rëndësishme në aktivitetet bujqësore. Është vënë re edhe përfshirja e grave edhe në ato aktivitete bujqësore që për një kohë të gjatë janë konsideruar ‘monopole të meshkujve’. Varfëria, tradita, përvojat e mëparshme, lëvizjet migruese si dhe edukimi, janë faktorët që ndikojnë më tepër në përfshirjen e grave në bujqësi.

Situata e zhvillimit gjinor⁷¹. Gjatë dekadës së fundit, në Shqipëri nuk i është kushtuar ndonjë vëmendje e veçantë rolit të gruas në shoqëri, megjithëse femrat përfaqësojnë më shumë se gjysmën e popullsisë. Matja e nivelit të zhvillimit gjinor nëpërmjet llogaritjes së Indeksit të Zhvillimit Gjinor (GDI) dhe Indeksit të Fuqisë Gjinore (GEM) është bërë për herë të parë në Raportin e Zhvillimit Njerëzor – Shqipëria 2002. GDI dhe GEM trajtojnë vetëm aspekte të matshme dhe ende nuk përfshijnë përmasa të tjera të pabarazisë gjinore, të tilla si shkalla e pjesëmarrjes së gruas në jetën komunitare dhe vendimmarrje, konsumi i burimeve brenda familjes, dinjiteti dhe siguria personale e gruas, etj. Këto përmasa janë gjithashtu përcaktuese të statusit të gruas në shoqëri dhe të cilësisë së jetës së saj.

Indeksi i Zhvillimit Gjinor (GDI) mat pabarazinë midis grave dhe burrave nga këndvështrimi i aftësive bazë dhe të kushteve të jetesës, duke u mbështetur në të njëjtat variabla si dhe HDI (Human Development Report): jetëgjatësia, arsimimi dhe të ardhurat. Sipas llogaritjeve, Indeksi i Zhvillimit Gjinor për Shqipërinë, i bazuar në të dhënat e vitit 2001, është 0,758 dhe Shqipëria renditet e 61-ta në klasifikimin e Kombeve të Bashkuara për 173 vende që e llogarisin këtë indeks. Me këtë vlerë të GDI, Shqipëria përfshihet në grupin e vendeve me nivel të mesëm të zhvillimit gjinor.

Indeksi i fuqisë Gjinore (GEM) fokusohet në mundësitë që u janë krijuar grave për të treguar aftësitë e tyre dhe për të marrë pjesë gjallërisht në jetën politike, ekonomike dhe në vendimmarrje, duke shqyrtuar, veçanërisht, pjesëmarrjen e tyre në jetën politike, ekonomike dhe profesionale. Ky tregues përqendrohet në tre variabla që pasqyrojnë pjesëmarrjen e gruas në vendimmarrjen politike; mundësinë për të ushtruar aftësitë profesionale; dhe të ardhurat që ato kanë.

Sipas llogaritjeve, Indeksi i Fuqisë Gjinore për Shqipërinë, i bazuar në të dhënat e vitit 2001, është 0,422 dhe Shqipëria renditet e 58-a në klasifikimin e Kombeve të Bashkuara për 173 vende që e llogarisin këtë indeks. Me këtë vlerë të GEM, Shqipëria përfshihet në grupin e vendeve me nivel të mesëm të zhvillimit gjinor.

NENI 9 – KOMBËSIA DHE SHTETËSIA

Shtetësia është një lidhje e qëndrueshme juridike, që shprehet në të drejtat dhe detyrat e ndërsjellta të personit fizik dhe të shtetit shqiptar. Ajo është një e drejtë e cila i garantohet në mënyrë të barabartë si burrit dhe gruas në Shqipëri. Legjislacioni që e garanton është në koherencë të plotë me Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit të Gruas.

69 Analiza Gjinore e Politikave në Sektorin e Arsimit në Shqipëri. Fq.34. UNDP.2005.-Burimi: Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Tiranë. 2004

70 Qendra e Gruas, “Përkatësia gjinore dhe bujqësia.” Përgatitur nga Eglantina Gjermani, Agron Hetoja, Daniela Kalaja & Marsela Dauti, Tiranë 2003.

71 Marrë nga: Raporti i Zhvillimit Njerëzor – Shqipëria 2002. Sfidat e qeverisjes vendore dhe zhvillimit rajonal. Përgatitur për Programin e Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDP) nga Qendra për Nxitjen e Zhvillimit Njerëzor (HDPC) (34 -36).

Baza kryesore për rregullimin e shtetësisë është Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Ligji Për Shtetësinë Shqiptare. Si në Kushtetutë ashtu edhe në ligjin e posaçëm nuk ka asnjë lloj dallimi lidhur me mënyrat e fitimit dhe ndryshimit të shtetësisë shqiptare ndërmjet burrit dhe gruas. Dhe për këtë arsye legjislatori ka përdorur termin “shtetas” duke barazuar pozitën e burrit dhe të gruas në ndryshimin dhe mbajtjen e shtetësisë së tyre.

Në Kushtetutë, në nenin 19 paragrafi i 2 sanksionohet që “Shtetasi shqiptar nuk mund të humbas shtetësinë përveç kur ai heq dorë prej saj”. Ky formulim i nenit garanton një mbrojtje të shtetësisë shqiptare, duke e lidhur që humbja e saj nga shtetasi shqiptar rezulton të bëhet vetëm me vullnetin e tij të lirë, pra nëse ai heq dorë vullnetarisht prej saj.

Në vazhdim edhe ligji “Për shtetësinë shqiptare” në nenin 4 të tij e garanton më tej këtë mbrojtje, duke specifikuar që shtetësia shqiptare nuk mund t’i hiqet arbitrarisht askujt. Çdo shtetas shqiptar ka të drejtë të heqë dorë nga shtetësia shqiptare me kusht që të ketë një shtetësi tjetër, apo t’i jetë garantuar nga organet kompetente të shtetit të huaj dhënia e një shtetësie tjetër.

Ligji në vazhdimësi të Kushtetutës në nenin 6 përcakton se format e fitimit të shtetësisë shqiptare janë:

- a) lindja;
- b) natyralizim;
- c) birësim.

Të gjithë këto dispozita parashikojnë që ndryshimi i shtetësisë shqiptare nuk mund të vijë si pasojë e një martese me një shtetas të huaj, por ai mund të ndryshojë vetëm me heqjen dorë në mënyrë vullnetare të shtetësisë duke e bërë përmes një kërkesë si dhe duke plotësuar kushtet që parashikon neni 15 i Ligjit.

Përsa i përket fëmijëve dhe fitimit të shtetësisë nga ana e tyre, legjislacioni shqiptar është në përputhje me Konventën. Si në Kushtetutë ashtu edhe në ligj, legjislatori ka përdorur termin “prind” duke i barazuar si nënën ashtu edhe babain. Në këtë mënyrë ai iu jep të drejta të barabarta prindërve në lidhje me shtetësinë që duhet të ketë femija i lindur prej nje prindi me shtetësi shqiptare. Lidhur me këtë, neni 19 i Kushtetutës, përcaktohet se: “Kushdo që lind duke pasur qoftë edhe njërin prej prindërve me shtetësi shqiptare e fiton vetiu shtetësinë shqiptare”. Ndërkohë ligji parashikon në mënyrë më të detajuar rastet e fitimit të shtetësisë shqiptare të një femije nga lindja (neni 7). Ashtu sikurse Kushtetuta edhe ligji vazhdon në frymën që nuk ka dallim lidhur se nga cili prind femija mund të përfitojë shtetësinë e tij. Mjafton që njëri prej prindërve të gëzojë shtetësinë shqiptare, në mënyrë që femija të bëhet shtetas shqiptar.

Në rastet e mbarimit të shtetësisë shqiptare për të miturin ligji parashikon se nëse të dy prindërit kanë hequr dorë nga shtetësia shqiptare dhe, nëse ata merren vesh që edhe femija e tyre të lerë shtetësinë shqiptare. Rasti tjetër është kur njëri prej prindërve nuk është dakord që femija të humbasë shtetësinë shqiptare, femijës mund t’i hiqet shtetësia, nëse çmohet se një gjë e tillë është në dobi të femijës dhe nëse femija ka apo do të marrë një shtetësi tjetër. Por edhe në këto raste nuk ka asnjë dallim midis nënës dhe babait të femijës.

NENI 10 – BARAZIA E TË DREJTAVE KULTURORE DHE E DREJTA PËR ARSIMIM DHE TRAINIM

A. KONTEKSTI LOKAL DHE GLOBAL NË MBËSHTETJE TË INTEGRIMIT GJINOR NË ARSIM⁷²

Sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë çdo njeri ka të drejtën për t'u arsimuar. Arsimi tetëvjeçar dhe arsimi i mesëm i përgjithshëm në shkollat publike është falas (neni 57 i Kushtetutës). Në nenin 18 të Kushtetutës përcaktohet se të gjithë shtetasit janë të barabartë përpara ligjit dhe se askush nuk mund të diskriminohet për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare e filozofike, gjendja ekonomike, arsimore e sociale.

Ligji “Për një Shoqëri Gjinore të Barabartë” miratuar në Korrik 2004 nga Parlamenti Shqiptar, synon të plotësojë kuadrin ligjor lidhur me të drejtat e barabarta për burrin dhe gruan. Ky ligj konsiston në vendosjen e të dyja gjinive në pozita të barabarta në fushën e arsimit, punësimit, dhe vendimarrjes. Ligji gjithashtu adreson çështjen e diferencave gjinore në fushën e arsimit. Në nenin 8 të këtij ligji theksohet:

Veprimet e institucioneve arsimore dhe shkencore do të konsiderohen diskriminuese nëse, duke u mbështetur në seksin:

- *zbatohen kërkesa të ndryshme përkatëse ndaj burrit dhe gruas për pranimin në shkollë ose për programet e studimit, për hartimin e kurrikulumeve ose për vlerësimin e njohurive;*
- *krijohen mundësi të ndryshme për zgjedhjen e një fushe të veçantë studimi, trajnimi, diplomimi dhe për kohëzgjatjen e mësimin.*

Këshilli i Ministrave miratoi me vendimin Nr. 538 datë 12.08.2004, Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar (SKZHAP). Strategjia kombëtare e arsimit është një dokument politik. Ajo “synon të trajtojë aspekte të gjendjes aktuale dhe të propozojë masat dhe ndërhyrjet e nevojshme për secilën prej fushave kryesore respektive të sektorit të arsimit duke u përpjekur njëkohësisht të mënjanojë përshkrimet e panevojshme” (faqe 11). Në strategji nuk gjenden të mirëartikuluara angazhime të edukimit gjinor, apo ndjeshmëri ndaj çështjeve gjinore, por në të ka hapësira për t'u interpretuar si të mundshme për t'u shfrytëzuar për edukimin gjinor të nxënësve.⁷³

Strategjia e Zhvillimit në Sektorin e Arsimit në kuadrin e SKZHES ka si objektiv kryesor sektorin e Arsimit dhe Shkencës. Ky sektor në kuadrin e SKZHES është përmbledhur në “përfshirjen e të gjithë fëmijëve në arsimin bazë, rritja e numrit të regjistrimeve dhe pjesëmarrjes në arsimin bazë dhe të mesëm, sidomos në atë profesional dhe në zonat e thella e të varfëra të vendit, përshtatja më e mirë e arsimit profesional ndaj nevojave të tregut, rritja e cilësisë së mësimdhënies (në harmoni me kualifikimin e vazhdueshëm të stafit mësimor), rritja e efektivitetit të administrimit dhe e efijencës së sistemit arsimor në bashkëpunim dhe mirëkuptim me grupet e interesuara”

Në ligjin “Për arsimin parauniversitar” Nr.7952 datë 21.06.1995, shprehimisht në nenin 1 thuhet: “Arsimi në Republikën e Shqipërisë është përparësi kombëtare.”

Kjo do të thotë se arsimi, në të gjithë përbërësit e vet, pra dhe në "tekstin e nxënësve", duhet të përmbushë detyra të emancipimit shpirtëror dhe zhvillimit social të individit. Përkthyer në gjuhën e thjeshtë, tre nenet e para të ligjit krijojnë mjaftueshëm mundësi dhe hapësira për t'u fokusuar tek çështjet e përkatësisë gjinore. Për më tepër, ligji për arsimin parauniversitar nuk mbart mëkatën e ndalimit të iniciativave dhe i krijon hapësirë kujdesit për çështjet e përkatësisë gjinore⁷⁴.

Në disa raste legjislacioni shqiptar tregon kujdes të veçantë për arsimimin e grave. Për shembull, Kushtetuta shpall arsimimin e grave në vëshirësi ekonomike dhe sociale si një nga objektivat sociale të Shqipërisë. Kategoritë e personave

⁷² Integrimi Gjinor në Politika dhe Strategji. Qendra e Aleancës Gjinore për Zhvillim, Tiranë, Tetor 2006.

⁷³ Qendra e Aleancës Gjinore për Zhvillim. Analiza gjinore e Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2004-2015. Gusht 2005.

⁷⁴ Analiza Gjinore e Teksteve të Shkollore Fillore. QAGJZH, 2005

që përfitojnë nga Ligji për Arsimin dhe Formimin Profesional përfshijnë vajzat-nëna të papuna, vajzat dhe gratë e trafikuar dhe gratë e divorcuara me probleme sociale⁷⁵.

B. ARSIMIMI I GRAVE / VAJZAVE DHE MEKANIZMAT SHTETËRORE PËR BARAZINË GJINORE NË SHQIPËRI

Platforma e Qeverisë Shqiptare për Barazinë midis Burrit dhe Gruas 2002-2005, ishte vazhdimësi e Platformës së Qeverisë 1999-2000. Kjo Platformë e miratuar me VKM Nr. 267, datë 03.06.1999 ka në bazë të saj 12 Pikat e Platformës për Veprim të Pekinit, të përshtatura sipas kushteve dhe rrethanave të vendit tonë. Gjithashtu ajo është në përputhje me të gjitha ligjet e vendit dhe dokumentat ndërkombëtarë për të drejtat e njeriut në përgjithësi dhe ato të gruas në veçanti.

Platforma e Qeverisë Shqiptare për Barazinë midis Burrit dhe Gruas 2002-2005 kishte këto drejtime kryesore: a) Barazia midis burrit e gruas në pushtet dhe vendim marrje; b) Ekonomia; c) Çështjet sociale; d) Shëndeti; e) Arsimi.

Siç shihet, arsimi është një nga prioritetet e kësaj platforme të qeverisë shqiptare, e cila përputhet edhe me objektivat e mijëvjeçarit. Përsa i përket çështjes së arsimit, kjo platformë synonte të hidhte hapa përpara në përfshirjen e perspektivës gjinore në të. Por që kjo të mund të arrihet është e rëndësishme që të gjithë në rradhë të parë të kenë të qarta konceptet bazë të barazisë gjinore, dhe kjo mund të realizohet vetëm duke filluar dhënien e këtyre koncepteve që në bankat e shkollës.

Arsimimi është instrumenti kryesor i shoqërisë, përmes të cilit mund të arrihet ndryshimi social. Edukimi ka një rëndësi të jashtëzakonshme, ai nuk lidhet vetëm me sigurimin e shkollave të mjaftueshme, teksteve dhe mësuesve të kualifikuar. Ai lidhet me një kontekst të caktuar social, i cili duhet të shihet si një e drejtë e të gjithëve, ku individët kanë mundësi të përmirësojnë mirëqenien e tyre sociale dhe ekonomike dhe të marrin pjesë në jetën publike.⁷⁶

Disa sfida që shtrihen përballë arsimit në Shqipëri:

- Krijimi i një panorame të qartë sasiore të roleve dhe shkallëve të përfshirjes gjinore në nivele dhe fusha të ndryshme të sistemit të edukimit, duke përdorur të dhëna të veçanta për të dy seksin;
- Pabarazi gjinore që ekzistojnë në të gjitha nivelet e edukimit; (regjistrimet, diplomimet, pabarazi strukturale në profesionin e mësimdhënies dhe në institucionet arsimore);
- Vlerësimi i nevojave specifike arsimore, si imediate ashtu dhe praktike dhe në terma afatgjatë dhe strategjike, për djemtë dhe vajzat, gratë dhe burrat dhe planifikimin në mënyrë specifike për të trajtuar këto nevoja;
- Stereotipe të forta gjinore në programet, dhe tekstet shkollore të të gjitha niveleve;
- Orientim i ndryshëm i karrierës për djemtë dhe për vajzat;
- Trajnimet profesionale nuk janë të lidhura me mundësitë ekzistuese të tregut të punës;
- Sigurimi i një ndarje të barabartë të grave dhe burrave në hartimin, planifikimin, vendimarrjen, menaxhimin, administrimin dhe shpërndarjen e edukimit dhe sigurimin e përfitimeve të njëjta për burrat dhe gratë në terma të aksesit, pjesëmarrjes dhe shpërndarjes së burimeve.

C. ARSIMIMI I GRAVE DHE VAJZAVE TË MINORITETEVE

Arsimimi i fëmijëve Rromë⁷⁷ - Një nga problemet që vuan minoriteti Rrom, është ai i nivelit të ulët arsimor, megjithatë gjendja arsimore e këtij minoriteti është përmirësuar krahasuar me gjendjen e disa viteve më parë. Një fakt i tillë shihet në rritjen e numrit të fëmijëve romë në frekuentimin e procesit mësimor. Kjo ka ardhur si pasojë e angazhimit të vetë minoritetit, nëpërmjet organizatave të tij, ashtu edhe nëpërmjet angazhimit të shoqërisë civile dhe strukturave shtetërore. Një fakt i tillë pohohet nga vetë përfaqësuesit e organizatave romë si edhe nga përfaqësuesit e organeve vendore arsimore. Nga informacioni që KSHH-ja ka marrë rezulton se:

⁷⁵ VKM nr. 616, 4 dhjetor 2002. Marrë nga raporti për Vlerësimin e Zbatimit të Konventës CEDAW në Shqipëri.

⁷⁶ Raporti Kombëtar i Zhvillimit Njerëzor-UNDP Mars 2005.

⁷⁷ Për më shumë shih Raportin e KSHH-së bazuar në monitorimin e Strategjisë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Minoritetit Rom, gjendja arsimore e tij në rrethet Tiranë dhe Fier, Tiranë më 2005.

- niveli i analfabetizimit në vitet 1994-1996 në minoritetin rrom ka qënë 83- 86 përqind⁷⁸
- në vitet 2002-2003 niveli i analfabetizimit ka qënë rreth 62.2 përqind (në qytetin e Tiranës 61.9 përqind, ndërsa për qytetin e Fierit 66.2 përqind)⁷⁹
- në vitin shkollor 2004-2005 ky nivel ka qënë 40 - 46 përqind⁸⁰

Në këtë drejtim, krahas rolit shumë të rëndësishëm të organizatave rrome në ndërgjegjësimin e minoritetit, roli i organeve përgjegjëse shtetërore në marrjen e masave konkrete për arsimimin e këtij minoriteti është shumë i rëndësishëm. Megjithatë, mbetet ende shumë për të bërë.

Megjithë përmirësimet e bëra në fushën e arsimit të minoritetit rrom, braktisja e shkollave nga fëmijët romë mbetet në nivele të larta. Karakteristikë e këtij minoriteti për fëmijët që fillojnë arsimin është zvogëlimi gjithnjë e më i madh i numrit të tyre duke kaluar nga një cikël arsimit tek një më i lartë. Braktisja e shkollës sjell pasoja negative për këtë minoritet si: lindja e analfabetizimit, vështirësia për t'u përfshirë në tregun e punës, pamundësia për t'u zhvilluar dhe integruar në shoqëri dhe për të marrë pjesë në jetën publike të vendit, por gjithashtu rrit mundësinë e përfshirjes në veprime të ndryshme kriminale.

Nisur nga vlerësimi i figurës së femrës në familjet Rrome rezulton se niveli i analfabetizimit të femrës është më i lartë se ai meshkujve. Ky fakt është pohuar nga të gjithë përfaqësuesit me të cilët KSHH ka realizuar takime. Duke qënë se vajzat Rrome sipas mentalitetit të minoritetit Rrom janë të detyruara të martohen që në moshën të mitura, pa përfunduar ende arsimin 8-vjeçar, numri i vajzave që braktisin shkollën është më i lartë se ai i djemve.

Faktorët që ndikojnë në mungesën e arsimimit të këtij komuniteti kanë të bëjnë me ekzistencën e mentaliteteve të tilla (faktorë subjektivë) të disa prej të cilave i përmendim si më poshtë:

- Mentaliteti dhe kultura e varfër që pasqyrohet në mungesën e vizionit të këtij minoriteti i cili e vlerëson arsimin një cikël mjaft të gjatë. Në këtë mënyrë ata zgjedhin alternativa më të shpejta si punësimi në punë të papërshtatshme në moshën të vogla. Gjithashtu, në mentalitetin dhe kulturën e këtij minoriteti ndikon niveli i ulët kulturor e arsimor i prindërve, traditat nomade të këtij minoriteti si dhe roli tradicional gjinor në familjet rrome (martesa në moshën të vogla brenda minoritetit rrom, marrja përsipër e detyrimeve familjare nga vajzat e familjes që në moshën të vogla).
- Jeta në lëvizje e një pjese të këtij komuniteti, mospasja e një vendbanimi të përhershëm. Lidhur me këtë, KSHH edhe më parë ka vënë në dukje se po bëhen përpjekje për ta zgjidhur këtë problem, por ka ende shumë për të bërë. Çështje ende të mbetura pa zgjidhje janë mungesa e regjistrimit në zyrat e gjendjes civile të një numri të madh të këtij minoriteti, mundësive më të mëdha për strehim dhe për punësim.
- Migrimi i brendshëm dhe i jashtëm⁸¹.

78 Ky informacion është marrë nga takimi që KSHH ka realizuar me Z. Skënder Veliu, President i Unionit "Amaro-Drom"

79 Ky informacion është marrë nga Raporti i Bankës Botërore "Roma and Egyptians in Albania – from social exclusion to social inclusion" publikuar në mars të vitit 2005.

80 Ky informacion është marrë nga takimi që KSHH ka realizuar me Z. Skënder Veliu, President i Unionit "Amaro-Drom"

81 Ky faktor është përmendur nga vetë Z. Skënder Veliu, Presidenti i Unionit "Amaro-Drom" në takimet e marra me KSHH-në.

NENI 11 – PUNËSIMI I GRAVE DHE VAJZAVE

1. ASPEKTET LIGJORE

Në Shqipëri, kuadri ligjor në lidhje me punësimin madje dhe formimin profesional, parashikon një sërë masash me qëllim ndalimin e diskriminimit në fushën e punësimit, veprimtarisë profesionale si dhe përfitimeve nga sigurimet shoqërore. Kështu, nëse do të bënim një analizë për të parë se sa përputhen parashikimet dhe kuadri ligjor mbi punësimin me kërkesat e nenit 11 të Konventës së CEDAW, si dhe se sa zbatohet ky legjislacion në realitet, situata rezulton si më poshtë:

“Të gjitha qëniet njerëzore, pavarësisht nga raca, besimi apo seksi, kanë të drejtë të kërkojnë si mirëqenien e tyre materiale ashtu edhe zhvillimin e tyre shpirtëror në kushtet e lirisë dhe dinjitetit, të sigurimit ekonomik dhe mundësive të barabarta. Njohja e të drejtës për punë përfshin të drejtën për të ndërmarrë hapat e nevojshme për arritjen në mënyrë progresive të realizimit të plotë dhe të mbrojtjes së kësaj të drejte. Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme, që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të tij profesional. Të punësuarit kanë të drejtën e mbrojtjes shoqërore të punës”.

Kjo e drejtë është e njohur dhe e garantuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë⁸² dhe, së bashku me të drejtat e tjera, qëndron në themel të rendit juridik. Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë, i miratuar me ligjin nr.7961, datë 12.07.1995, parashikon: të drejtat themelore (ndalimi i punës së detyruar, liria sindikale, bisedimet kolektive)⁸³, krijimin e raporteve individuale të punës (lindja e marrdhënieve të punës)⁸⁴, apo dhe përfundimin e marrëdhënies së punës⁸⁵. Ky Kod u konceptua si institucion me fizionomi bashkëkohore, i cili ka pësuar ndryshime dhe plotësime me ligjin Nr. 8085, datë 13.03.1996 dhe me ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003.

- Kodi i Punës bazohet në Dispozitat Kryesore Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.
- Kodi i Punës respekton Konventat Ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.
- Kodi i Punës bazohet në normat përgjithësisht të pranura të së drejtës ndërkombëtare.⁸⁶

Në Kodin e Punës të ndryshuar janë parashikuar të drejtat themelore:

- Ndalimi i punës së detyruar në të gjitha format e saj;
- Ndalimi i diskriminimit;
- Liria sindikale dhe bisedimet kolektive;⁸⁷
- Lindja e marrdhënieve të punës;
- Mbrojtja e veçantë për të miturit dhe gratë.⁸⁸

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në mënyrë të veçantë, në dispozitat e Kodit të Punës, gjejmë reflektim në masë të kënaqshme, standartet e “Konventës dhe Rekomandimit mbi Punësimin” 1964⁸⁹, “Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”⁹⁰, për sigurimin e punësimit të plotë, fitimprurës dhe të zgjedhur lirisht, si një mjet për arritjen e realizimit praktik të të drejtës për punë.

Republika e Shqipërisë në mbështetje të Ligjit Nr. 8086, datë 13.03.1996 ka aderuar në Konventat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ONP):

- Konventa nr. 105 "Për Zhdukjen e Punës së Detyruar",
- Konventa nr. 111 "Për Diskriminimin në Punë dhe Profesion"

82 Neni 49 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

83 Kreu III i Kodit të Punës.

84 Kreu V i Kodit të Punës.

85 Kreu XIV i Kodit të Punës.

86 Neni 5, Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë.

87 Ndryshuar me ligjin Nr. 8085, datë 13.03.1996 K.Punës RSH.

88 Ndryshuar me ligjin Nr. 9125, datë 29.07.2003. K.Punës RSH

89 Neni 1. Parime të përgjithëshme. Rekomandimi mbi Politikën e Punësimit (Dispozita suplementare)1984

90 Neni 4, që bën fjalë për punën e detyruar ose me shtrëngim, Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, ratifikuar nga Shqipëria 1996.

- Konventa nr. 138 "Për Moshën Minimale për t'u Pranuar në Punë".

Kodi i Punës, përmend shprehimisht në një dispozitë parimin “pagë e barabartë për punë me të njëjtën vlerë.”⁹¹ Megjithatë një numër ligjesh të tjera që mbulojnë disa marrëdhënie të veçanta pune dhe kategori punonjësish, si p.sh.: Ligji për Statusin e Nëpunësit Civil, Ligji për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë dhe Ligji për Organizimin dhe Funksonimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë, nuk e përmendin shprehimisht këtë parim. Sidoqoftë këto ligje përdorin një gjuhë neutrale përsa i përket gjinisë. Ligji për Barazinë Gjimore vendos si detyrim për punëdhënësit përdorimin e kriterëve të njëjta për vlerësimin e punës së punonjësve meshkuj dhe femra si dhe detyrimin për t’u dhënë atyre të njëjtën pagesë për një punë me të njëjtën vlerë.

Duhet thënë se parimisht, grave në Shqipëri iu garantohen mundësi të barabarta punësimi. Kjo reflektohet në konkurrencën e hapur për pozicione të ndryshme pune në sektorin shtetëror apo privat. Megjithatë, është fakt që në sektorin privat, punësimi varet shumë më tepër nga preferencat e punëdhënësit, sesa nga respektimi i legjislacionit në fuqi. Megjithatë u përmend që Kodi i rishikuar i Punës e ndalon diferencimin për zgjedhjen e punonjësve/eve në bazë të racës, moshës apo seksit, në realitet ndeshen një sërë praktikash diskriminuese.

Ligji për Shërbimin Civil rregullon punësimin në administratën civile dhe shtetërore duke shmangur punësimin nëpërmjet emërimit të drejtpërdrejtë. Konkursi, testimi, intervistimi, dhe kriteret e zgjedhura me kujdes kanë rezultuar në marrjen në punë të një personeli të kualifikuar intelektualisht dhe profesionalisht pa diskriminim gjinor. Megjithatë, kërkimet tregojnë se femrat që arsimohen jashtë shtetit mund të diskriminohen për marrjen në punë. Një studim i femrave emigrante shqiptare në Shtetet e Bashkuara tregoi që gratë që kthehen në Shqipëri pas një periudhe studimesh jashtë vendit zhgënjehen shumë. Jo vetëm që ato mendohet të jenë shumë të kualifikuara për mjedisin e punës në Shqipëri, por punësimi i tyre lidhej me dhënien e favoreve seksuale për punëdhënësit (Orgocka, 2005)⁹².

Vëmendja e shtetit duhet përqëndruar shumë dhe në mundësitë e integritit të grave nga zonat rurale që kanë emigruar së fundmi në zonat urbane, apo dhe grave romë. Pjesa më e madhe e këtyre grave kanë vetëm arsim fillor dhe punojnë në kushte të vështira, kanë familje të mëdha me pesë ose gjashtë fëmijë të vegjël që kanë nevojë për kujdesin e prindërve, si dhe kanë shumë mungesa aftësish profesionale. Në kushtet e lulëzimit të ekonomisë joformale, shumë gra shqiptare kanë filluar të punojnë në shtëpi, por nuk dihet realisht në çfarë kushtesh gratë ushtrojnë aftësitë e tyre. Pavarësisht përpjekjeve dhe rezultateve pozitive të arritura nga një sërë OJF-sh që veprojnë në fushën e punësimit dhe formimit profesional, me qëllim trajnimin dhe lehtësimin e integritit të këtyre grave në tregun e punës, nevojiten politika konkrete shtetërore në këtë drejtim.

Përsa i përket zgjedhjes së lirë të punësimit, si dhe kriterëve të njëjta për promovimin dhe përfitimet, përfshirë ritrajnimin, kuadri ligjor është sërish jo diskriminues madje dhe favorizues për gratë. Strategjia e Punësimit dhe Formimit Profesional është miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 67 datë 10.01.2003. Në Strategjinë e Punësimit dhe Formimit Profesional bëhet një prezantim i situatës aktuale në tregun e punës, evidentohen prirjet afatshkurtra e afatmesme për ndryshime në këtë treg, si dhe përcaktohen objektiva konkrete në lidhje me problematikën e punësimit në shkallë vendi. Kjo strategji përmban një numër të caktuar masash për tu ndërmarrë, vendos drejtimet kryesore përsa i përket përmirësimit të punës për të ardhmen, programe të reja në kuadrin e nxitjes së punësimit, formimit profesional si dhe mbështetjes së bizneseve të reja apo atyre ekzistuese, me qëllim nxitjen e punësimit dhe hapjen e vendeve të reja të punës.

Strategjia i kushton një vëmendje të veçantë formimit profesional të atyre grupeve të popullsisë me probleme ekonomiko-sociale, ku do të përfshihen personat me aftësi të kufizuar, *nënat me shumë fëmijë*, personat nën 18 vjeç, të papunët afatgjatë, personat nga familje nën nivelin e varfërisë, *vajzat nëna të papuna, vajza dhe gra të trafikuar, gra të divorcuara me probleme sociale*, emigrantë që kthehen me probleme ekonomike, të sapodiplomuar, të paorientuar në tregun e punës etj. Në këtë kuadër mendohet të aplikohen tarifa të reduktuara për formimin e tyre profesional si dhe përfshirja me përparësi e tyre në programet e reja të tregut të punës në mënyrë që të realizohet punësimi i tyre dhe integrimi në jetën shoqërore dhe ekonomike të vendit⁹³. Megjithatë, duhet thënë se pavarësisht këtyre masave, avancimi në karrierë është më i vështirë për gratë. Pavarësisht ndjekjes së procedurave të rekrutimit bazuar në konkurimin dhe vlerësimin e aftësive individuale profesionale, ndjehet dukshëm shmangia e procedurave të tilla, nëse bëhet fjalë për pozicionet drejtuese apo vendim marrëse. Në shumë sektorë ku numri i grave të punësuar është në nivel të konsiderueshëm (arsim,shëndetsi,etj), pozicionet e tyre të punës janë kryesisht në nivelin e specialisteve dhe shumë të

91 Kodi i Punës,ligji nr 7961,dt 12 Korrik 1995,neni 115

92 Nisma për të Drejtat e Grave, Raporti i Vlerësimit të CEDAW për Shqipërinë, Dhjetor 2005, fq.43

93 Shtrirja gjeografike e rrjetit të formimit profesional - Strategjia e Punësimit dhe Formimit Profesional 2003, fq.28

pakta janë gratë në pozicione drejtuese dhe vendimmarrëse. Në praktikë, zbatimi i parashikimeve dhe arritja e objektivave të cituara në Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Formimit Profesional (SPFP), sikurse dhe realizimi me efektivitet i detyrave të institucioneve përkatëse në fushën e punësimit, pengohet dukshëm dhe nga mosnjohja në një masë shumë të madhe të vetë këtyre dokumentave dhe politikave të hartuara për këtë qëllim.

Kështu, nga monitorimi i shkallës së njohjes dhe zbatimit të SPFP, rezulton se një nga problemet kryesore është pikërisht mungesa e njohjes së ekzistencës apo përmbajtjes së saj, në një shkallë të konsiderueshme, veçanërisht mes grupeve përgjegjëse për zbatimin e saj, por edhe nga grupet përfituese. Rreth 71.5 përqind e të intervistuarve, nuk kanë dëgjuar asnjëherë të flitet për një strategji të tillë. Ndërkohë që 33.7 përqind e të intervistuarve nuk kanë fare informacion mbi adresën apo personat e kontaktit në Zyrat Lokale të Punësimit dhe kjo shifër shkon në 40.1 përqind për Zyrat Rajonale të Punësimit⁹⁴.

SPFP është shumë pak e njohur, edhe pse ka tashmë tre vjet që është miratuar dhe pretendohet që të zbatohet me përparësi, me qëllim zbutjen e problemit të papunësisë në vend. Mungesa e informacionit mbi SPFP fillon që në ekzistencën dhe përmbajtjen e këtij dokumenti për të vazhduar më pas dhe me transparencën dhe vënien në dispozicion të të dhënave dhe treguesve realë që të mund të provohet zbatimi i saj në praktikë. Marrja e një informacioni të shpejtë dhe të saktë mbi zbatimin e SPFP në Zyrat Rajonale apo Lokale të punësimit, është pothuajse i pamundur. Vështirësitë që ndeshen në këtë drejtim janë nga më të ndryshmet, duke filluar që nga burokracia, e deri tek mungesa e informacionit, si pasojë e mungesës së rrjeteve të kompjuterizuara, mungesës së burimeve njerëzore të specializuara apo në dispozicion, etj. Mungesa e informacionit mbi SPFP dhe zbatimin e saj ndjehet në të treja grupet kryesore që trajtohen në strategji. Nga procesi i monitorimit rezulton se vetë punonjësit e Zyrave Rajonale të Punësimit apo Zyrave Lokale të Punësimit, janë pothuajse shumë pak të familjarizuar me këtë dokument. Pjesa më e madhe e tyre janë të përfshirë në rutinën ditore të punës dhe jo gjithmonë janë të informuar nëse ndryshimet që iu kërkohen të zbatojnë dhe reflektohen në punë, lidhen apo jo me këtë strategji apo dokumenta të tjera⁹⁵.

Në lidhje me sigurimet shoqërore dhe përfitimet prej tyre, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë i garanton kujt do të drejtën e përfitimeve nga sigurimet shoqërore me mbushjen e moshës së pensionit ose në rast paaftësie për punë, ashtu siç garanton përfitimet në rast papunësie. Ligji për Sigurimet Shoqërore⁹⁶ ndjek të njëjtën linjë, ndonëse bën një dallim përsa i përket pagesës së kompensimit dhe përfitimeve nga sigurimet shoqërore për barrë lindje, ku përfshihen shtatzënia dhe perioda pas lindjes së fëmijës: *këto gjejnë aplikim vetëm për gratë*. Një tjetër dallim mes punonjëseve femra dhe meshkujve është leja e lindjes. Legjislacioni shqiptar nuk jep leje lindje për babanë, ndonëse njeh të drejtën e pushimit 3 - ditor për baballarët e rinj. Ndërkohë pushimet e tjera dhe pushimet vjetore zbatohen njëjloj si për burrat dhe për gratë. Shembull tjetër i trajtimit të ndryshëm të burrave dhe grave është edhe neni 31 i Ligjit për Sigurimet Shoqërore, i cili përcakton se personat e siguruar kanë të drejtë të marrin pensionin e plotë të pleqërisë me mbushjen e moshës 65-vjeçare për burrat dhe 60-vjeçare për gratë. Që të gëzojë pension të plotë, individit duhet të ketë paguar të paktën për 35 vjet kontribute në skemën e sigurimeve shoqërore.

Jo vetëm që legjislacioni i punës nuk i diskriminon gratë, por disa kategorive të grave, si p.sh. nënave me shumë fëmijë, u jepet prioritet në sferën e punësimit. Kushtetuta parashikon mbrojtjen e veçantë nga ana e shtetit për nënat e reja dhe gratë shtatzëna. Sipas Kodit të Punës shtatzënia nuk duhet të përbëjë shkak për diskriminim në fushën e punës. Kështu, për shembull, neni 105/a ndalon testet e shtatzanisë përpara marrjes së gruas në punë. Për më tepër, kur gruaja pushohet nga puna gjatë periudhës së shtatzanisë ose pas kthimit nga leja e lindjes, barra e provës i mbetet punëdhënësit, për të bindur gjykatën se prishja e kontratës nuk ka ardhur si rezultat i shtatzënisë apo lindjes së fëmijëve.

Legjislacioni shqiptar ofron mbrojtje të posaçme për funksionin riprodhues të grave. Puna 35 ditë përpara dhe 42 ditë pas lindjes së fëmijës është absolutisht e ndaluar dhe kur gruaja ka në barrë më shumë se një fëmijë kjo periudhë është edhe më e gjatë. Pas kalimit të këtyre ditëve, punonjësja ka të drejtë të zgjedhë nëse dëshiron të kthehet në punë apo të vazhdojë të kujdeset për fëmijën e saj. Nëse ajo zgjedh të dytën, punëdhënësi është i detyruar t'ia ruajë vendin e punës për një periudhë 12-mujore. Leja i garantohet edhe nënave adoptive.

Gjithashtu, Kodi i Punës i ndalon punëdhënësit për vendosjen e punonjësës në kushte të vështira dhe të rrezikshme për shtatzaninë apo fëmijën e saj. Po kështu, turni i natës është i ndaluar për gratë shtatzana. VKM nr. 207, datë 9 maj 2002 përcakton listën e punëve të vështira dhe të rrezikshme, ku vetëm punonjësit që paraqesin çertifikatë mjekësore se janë

94 Shoqata Refleksione, Raport mbi Monitorimin e shkallës së njohjes dhe Zbatimit të SPFPnën këndvështrimin e përkatësisë gjinore, Gusht 2006, fq.5

95 Po aty.

96 Ligji për Sigurimet Shoqërore, nr 7703, dt 11 maj 1993

klinikisht shëndoshë mund të punësohen. Leja e lindjes llogaritet si vit pune për gruan dhe ajo nuk e humbet vjetërsinë në punë për shkak të shtatzënisë apo lindjes së fëmijës. Megjithatë, në realitet zbatimi i këtyre ligjeve vështirësohet, sidomos kur flitet për gratë e punësuar në sektorin privat. Gratë shtatzana iu nënshtrohen kushteve të këqija të punës, sikurse dhe më pas, presionit të kryerjes së punëve shtesë në familjet e tyre (punë e papaguar kjo, vlerësimi i të cilës asnjëherë nuk është bërë objekt studimi për shtetin tonë). Po kështu, shpesh ato ndeshen me vështirësinë e përfitimit të lejes së barrëlindjes për një kohë më të gjatë sesa 42 ditë pas lindjes, pasi rrezikojnë të humbasin vendin e punës.

Një fenomen tjetër që ndeshet, por në sektorin shtetëror, është dhe detyrimi indirekt për të marrë të plotë 12 muaj lejën e barrëlindjes, për shkak të një numri të madh të personave të rregjistruar në listën e pritjes për vende pune. Më i dukshëm ky lloj detyrimi vihet re të jetë në sektorin e arsimit, ku marrja e lejes së lindjes nga një mësuese, nënkupton krijimin e mundësisë për të punuar për një periudhë 12 mujore për një mësuese tjetër. Pra pavarësisht të drejtës së gruas për të zgjedhur kohën se sa dëshiron të qëndrojë në shtëpi për t'u kujdesur për fëmijën e saj, në realitet, një pjesë e mirë e grave nuk e njohin si të drejtë zgjedhjeje këtë përfitim “deri në 12 muaj”, por si një detyrim ligjor që duhet zbatuar, deri në fund të periudhës prej 12 muajsh.

Diskriminimi për shkak të martesës nuk përmendet posaçërisht në legjislacionin shqiptar të punës. Sidoqoftë, neni 9 i Kodit të Punës e ndalon diskriminimin për shkak të lidhjeve familjare. Interpretimi i gjerë i këtij termi mund të përfshinte edhe gjendjen civile të punonjësit. Veç kësaj, punëdhënësi nuk mund të mbledhë informacione personale për punëmarrësin, përveçse kur këto lidhen me aftësinë profesionale ose janë të rëndësishme për ekzekutimin e kontratës. Për më tepër, neni 146 i Kodit të Punës, e konsideron të pa justifikueshme prishjen e kontratës së punës për motive që lidhen me shtatzaninë, gjendjen civile, detyrimet familjare, etj. Prishja e kontratës së punës pa shkaqe të paarsyeshme është e pavlefshme dhe punëdhënësi i paguan punëmarrësit një dëmshpërblim të barabartë me pagën vjetore. Përsa i përket shpeshësisë së rishikimit të legjislacionit mbrojtës për të pasqyruar kërkimet dhe konkluzionet më të fundit shkencore, mund të thuhet se legjislacioni shqiptar përputhet pak ose aspak me kërkesat e Konventës së CEDAW. Rishikimi i kategorive të vendeve të punës që konsiderohen të rrezikshme për gratë, ndodh shumë rrallë, ose me iniciativën e ministrisë përkatëse, ose për shkak të trysnisë nga OJF-të apo organizatat ndërkombëtare⁹⁷.

Legjislacioni shqiptar e trajton çështjen e ngacmimit seksual në mënyrë sporadike. Kodi i Punës ndalon shprehimisht çdo veprim nga ana e punëdhënësit që mund të konsiderohet ngacmim seksual i punonjësit dhe vendos mbi të parin detyrimin që punonjësi të jetë i mbrojtur edhe nga ngacmimi seksual nga ana e punonjësve të tjerë⁹⁸. Ligji për Barazinë Gjinore detyron punëdhënësit të ndërmarrin masa disiplinore dhe masa të tjera organizative për të luftuar ngacmimin seksual ndaj punonjësve të tij⁹⁹. Mirëpo për t'i bërë këto të drejta efektive, nevojitet krijimi i mekanizmave proceduriale që i krijojnë mundësi viktimës së ngacmimit seksual të kërkojë mbrojtje gjyqësore, përfshirja në legjislacion e përkufizimit të ngacmimit seksual dhe ndoshta edhe transferimi i barrës së provës mbi punëdhënësin.

2. PUNËSIMI I GRAVE DHE VAJZAVE TË MINORITETEVE

Punësimi i grave Rome¹⁰⁰ - Ministria e Punëve e Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta ka ndërmarrë disa masa konkrete për integrimin e minoritetit Rrom në shoqëri në përputhje me objektivat e vendosura në Strategjinë Kombëtare “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit Rom”. Ministria ka organizuar tre programe për nxitjen e punësimit të grave dhe vajzave nga të cilat është siguruar punësimi i 500 grave dhe vajzave me probleme sociale. Nga ky numër, vetëm 86 janë vajza dhe gra Rome, pjesa tjetër i përket pjesës maxhoritare të popullsisë¹⁰¹.

Përfshirja e vogël e grave dhe vajzave Rome në programet e punësimit lidhet ndërmjet të tjerave, me mungesën e ndërgjegjësisimit dhe informacionit nga ana e tyre.

Megjithëse Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabartë është kujdesur të realizojë trajnime dhe kurse profesionale në tetë rrethe të vendit, përfshirja e vajzave Rome ka qenë e ulët. Kështu, në këto kurse të formimit

97 Nisma për të Drejtat e Grave, Raporti Vlerësimi të CEDAW për Shqipërinë, Dhejtor 2005, fq 42

98 Neni 32, Kodi i Punës, ligji nr 7961, dt 12 korrik 1995

99 Ligji Për një Shoqëri Gjinore të Barabartë, nr 9198, datë 1 korrik 2004, neni 6

100 Për përgatitjen e këtij materiali është shfrytëzuar raporti i vëzhgimit të zbatimit të Strategjisë Kombëtare “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit Rom”, realizuar nga Fondacioni SOROS, ku KSHH ka ofruar ekspertizën e vet në përgatitjen e tij.

101 Këto informacione janë marrë nga pjesëmarrja në tryezën e rrumbullakët me temë “Zhvillimi dhe integrimi i komunitetit rom, prioritet i qeverisë” të organizuar nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Mundësive të Barabarta, datë 9.02.2006 në Hotel Mondial.

profesional përgjithësisht për kozmetikë, rrobaqepësi, parukeri, janë përfshirë 67 gra dhe vajza. Përfshirja e vogël e tyre lidhet me mungesën e promovimit të kurseve të tilla, mungesën e informacionit dhe menaxhimin jo të mirë të zyrave lokale të punës për sigurimin e një përfshirjeje më të gjerë të këtij minoriteti. Ndërkohë vetë organizatat Rrome janë kujdesur të zhvillojnë kurse profesionale për rrobaqepësi, parukeri në rrethet Korçë, Kuçovë dhe Berat¹⁰².

Punësimi është një çështje thelbësore për minoritetin Rrom, pasi pjesa më e madhe e tij është e papunë dhe vetëm një pjesë e vogël është e vet-punësuar në tregëtinë e rrobave të përdorura. Vetëpunësimi i tyre vlerësohet si faktor i rëndësishëm për integrimin e gruas rrome. Sipas të dhënave të Unionit Amaro-Drom, 70-80 përqind e grave janë të përfshira në biznesin e rrobave të përdorura dhe 20-30 përqind e tyre merren me bujqësi dhe kjo është më shumë karakteristike për zonën e Myzeqesë.

Përsa i përket diskriminimit të këtij minoriteti, përfaqësues të tij kanë pohuar se nuk ka pasur forma të shprehura të diskriminimit në këtë drejtim. Më shumë ndihet diskriminimi në forma të fshehura i cili ndikon negativisht në integrimin e këtij minoriteti në shoqërinë shqiptare.

Në zonat rurale janë organizuar kurse kualifikimi për vajzat dhe gratë Rrome edhe nga shoqata të ndryshme të huaja. Vetë shoqatat dhe organizatat përfaqësuese të këtij minoriteti kanë organizuar aktivitete të ndryshme me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e anëtarëve të këtij minoriteti lidhur me të drejtat e tyre në përgjithësi dhe format e diskriminimit në veçanti¹⁰³. Disa organizata Rrome i kanë kushtuar vëmendje balancës gjinore në organet drejtuese, p.sh 30-50 përqind e bordeve lokale të Unionit Amaro-Drom përbëhen nga gratë Rrome.

Tradicionalisht burri në familjen Rrome luan një rol kryesor. Vihen re përpjekje pozitive të disa organizatave Rrome për ndërgjegjësimin e grave në lidhje me garantimin e të drejtave të tyre në shoqëri dhe familje. Gjithashtu, vlen të përmenden dhe përpjekjet e organeve të qeverisjes vendore të cilat në bashkëpunim me Zyrat e Punës si dhe OJF-të lokale, po punojnë për një integrim të gruas rrome dhe formimin profesional të saj¹⁰⁴. Nga vetë organizatat rrome në këtë rreth po bëhen përpjekje për ndërgjegjësimin e burrave në lidhje me rolin e tyre në familje si edhe për të njohur më mirë të drejtat dhe liritë themelore të grave. Qëllimi i këtyre fushatave ndërgjegjësuere është për të punuar gjithnjë e më afër me vetë komunitetin rrom për integrimin e tyre në shoqëri dhe për të ndryshuar mendësitë e tyre¹⁰⁵.

Për sa i përket punësimit dhe zhvillimit profesional të minoritetit rrom në Korçë sipas përfaqësuesve të shoqatave rrome nuk ka asnjë program për realizimin e tyre. Nga organet e qeverisjes vendore në këtë rreth nuk është organizuar asnjë program specifik për punësimin dhe formimin profesional të tyre. Në këtë drejtim kanë kontribuar disa organizata vendase në bashkëpunim me shoqatat rrome të cilat kanë realizuar disa seminare trajnuese për ndërgjegjësimin e vajzave dhe grave rrome lidhur me të drejtat e tyre në familje dhe në shoqëri¹⁰⁶.

102 Kurse të tilla profesionale janë organizuar nga Unioni Amaro-Drom.

103 Këto informacione janë marrë nga takimi me drejtues të shoqatës "Gruaja rrome e së nesërme".

104 Bëhet fjalë për komunitetin rom në Elbasan.

105 Të dhënat lidhur me minoritetin rom në rrethet e tjera me përjashtim të qytetit të Tiranës janë marrë nga korrespondentët e KSHH-së përkatësisht në rrethet Korçë, Elbasan, Shkodër dhe Fier.

106 Një nga këto organizata që ka punuar në rrethin e Korçës është CSDS.

NENI 12 – KUJDESI SHËNDETËSOR DHE PLANIFIKIMI FAMILJAR¹⁰⁷

A. ASPEKTET LIGJORE

Legjislacioni shqiptar përputhet shumë pak me nenin 12 të CEDAW-t. Neni 55 i Kushtetutës shqiptare i garanton cilitdo të drejta të barabarta për kujdesin shëndetësor që ofrohet nga shteti. Gjithsesi, kjo dispozitë mbetet deklarative, ndërsa mungojnë edhe formulime të posaçme që ndalojnë diskriminimin në fushën e kujdesit shëndetësor.

Ligji për Kujdesin Shëndetësor është mjaft i vjetër (1963) dhe reflekton një tjetër kulturë juridike. Ndryshime të tij apo edhe një ligj i ri për kujdesin shëndetësor është i domosdoshëm për të reflektuar standartet dhe angazhimet e mëvonshme ndërkombëtare ku ka aderuar Shqipëria. Megjithatë, ka një dispozitë që përdor termin “diskriminim”: “Çdo grua, e lirë dhe e përjashtuar nga çdo formë diskriminimi, detyrimi dhe dhune, ka të drejtë për t’u kontrolluar e për të vendosur lirisht për të gjitha çështjet që lidhen me seksualitetin e saj dhe shëndetin seksual e riprodhues.”¹⁰⁸

Neni 8 i Ligjit për Shëndetin Riprodhues e përgjithëson më tej këtë parim duke përfshirë të dy seksat: “Ky ligj i garanton çdo individ vendimmarrjen për ushtrimin e të drejtave riprodhuese sipas dëshirës dhe interesit të tyre, të lirë nga diskriminimi, detyrimi dhe dhuna.”

Legjislacioni shqiptar i ofron mbështetje të posaçme dhe shërbime shëndetësore nënës dhe fëmijës.¹⁰⁹ “Të gjitha gratë shtatzëna përfitojnë falas ndjekjen periodike mjekësore të shtatzënisë, të lindjes dhe të paslindjes, veçanërisht ekzaminimet e paralindjes dhe të paslindjes, të detyrueshme, që caktohen me akt të Ministrit të Shëndetësisë.”¹¹⁰ Megjithë formulimin e tyre, zbatimi i këtyre dispozitave, ashtu si edhe cilësia e shërbimit shëndetësor është e papërshtatshme.

Ndonëse Kuvendi rishtazi miratoi një ligj për mbrojtjen e ushqyerjes me gji,¹¹¹ ky ligj është hartuar vetëm për të çinkurajuar zëvendësimin e qumështit të gjirit me atë artificial, për të rregulluar tregtimin e ushqimeve për fëmijë dhe përhapjen e informacionit për përparësitë që ka ushqyerja me gji. Mbrojtja që i siguron legjislacioni shqiptar ushqyerjes me gji është e kufizuar dhe dispozita apo programe që të sigurojnë ushqimin e përshtatshëm për nënat e reja përgjithësisht mungojnë. Disa nga këto aspekte trajtohen nga Konventa e ILO-së nr. 183 për Mbrojtjen e Mëmësisë, ratifikuar nga RSH me 2001 (shih tabelën me poshtë) dhe në VKM nr. 397, datë 20 maj 1996, me ndryshimet e mëvonshme, i cili ndalon nënat me fëmijë në gji të ngrenë pesha të rënda dhe u garanton atyre të drejtën për shkëputje periodike gjatë orarit të punës për të ushqyer fëmijën.

Deri më 1992 ndërprerja e shtatzënisë ishte e paligjshme në Shqipëri, ndërsa tashmë aborti lejohet deri në javën e 12-të të shtatzënisë dhe pas kësaj periudhe nevojitet leje e veçantë nga një komision mjekësor, në varësi të shëndetit të nënës dhe fetusit.

B. ASPEKTE PRAKTIKE TE ZBATIMIT TE LIGJIT¹¹²

Aksesi në kujdesin shëndetësor. Aksesi në shërbimet e kujdesit shëndetësor është i njëjtë për burrat dhe gratë. Në fakt, në disa raste, legjislacioni është më bujar ndaj grave për arsye të specifikave të shëndetit të grave, duke përfshirë sëmundjet e organeve riprodhuese, ose ekzaminimet si mamografia që ndihmojnë me diagnostikimin e sëmundjeve serioze. Udhëzuar nga parimet e Shëndeti 21 nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH), pjesa më e madhe e instrumenteve janë të njëjta për burrat dhe gratë. Megjithatë nevojiten fushata për ngritjen e ndërgjegjësimit për

107 Të dhëna të marra nga Raporti për Vlerësimin e Zbatimit të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas në Shqipëri. Botim i USAID Shqipëri, përgatitur nga Chemonics International. Tiranë, Dhjetor 2005

108 Ligji për Shëndetin Riprodhues, nr. 8876, datë 4 prill 2002, neni 6

109 Ligji për Shëndetin Riprodhues, nr. 8876, datë 4 prill 2002, neni 13/2

110 Ligji për Shëndetin Riprodhues, nr. 8876, datë 4 prill 2002, neni 24/1

111 Ligj nr. 8528, datë 23.9.1999, “Për mbrojtjen dhe nxitjen e të ushqyerit me gji”

112 Të dhëna të marra nga Raporti për Vlerësimin e Zbatimit të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas në Shqipëri. Botim i USAID Shqipëri, përgatitur nga Chemonics International. Tiranë, Dhjetor 2005

mirëmbajtjen e shëndetit. Gratë zakonisht kërkojnë ndihmë kur ato sëmuren. Në zonat rurale, gratë ende nuk shkojnë për ekzaminime periodike gjatë shtatëzarisë si një mënyrë për të shmangur shumë komplikime gjatë dhe pas lindjes. Ekzaminimet e rregullta mjekësore nuk janë pjesë e mirëmbajtjes së shëndetit edhe për gratë e moshuara dhe ato me paaftësi. Gjithashtu, pacientët mund të zgjedhin shërbimet, dhe ata mund të favorizojnë doktoresha për ekzaminimet dhe doktorët për kirurgjitë. Në përgjithësi, shtëpitë e lindjes shihen si vendet e grave, kur, sipas profesionistëve të shëndetit, problemet e lidhura me shëndetin duhet të përballohen nga çifti.

Gjithashtu më shumë vëmendje i duhet dhënë grave më të moshuara gjatë kohës së menopauzës. Sipas mendimit të pjesëmarrësve/eve, aksesit i pamjaftueshëm për kujdesin shëndetësor zakonisht justifikohet me faktin që sistemi i kujdesit shëndetësor është në krizë. Duke qenë se mjekët/et dhe kirurgët/et kanë emigruar në qytetet kryesore të vendit, mungesa e personelit të kualifikuar mjekësor në zonat më të vogla dhe të largëta ka sjellë kaos në shërbime. Shumica e pacientëve ende shkojnë në Tiranë për të marrë kujdesin shëndetësor. Gratë dhe burrat përballen njësoj me probleme në aksesimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor. Intervistuesit/et përmendën se gratë ende lindin në shtëpi. Në disa raste, personeli mjekësor paguhet nën dorë, ç'ka do të thotë që jo të gjithë pacientët kanë të njëjtën vëmendje për kujdes shëndetësor.

Dhënia e shërbimeve falas dhe ushqyerje e duhur gjatë shtatëzarisë. Gratë ndiqen gjatë gjithë kohës së shtatëzarisë dhe u jepet tre sesione sonogramesh falas në qendrat spitalore. Stafit i specializuar adreson shqetësimet e tyre. Megjithatë, Anketa *Shqipëria - Dije, Qëndrim, Besim dhe Praktika 2000* tregohet se kujdesi prenatal është shumë i kufizuar. Vetëm 18 përqind e grave që qenë shtatëzënë rreth kohës së anketimit thanë që ishin ekzaminuar në trimestrin e parë të shtatëzarisë së tyre të fundit; 45 përqind nuk ishin ekzaminuar deri në trimesterin e dytë, dhe 37 përqind nuk shkuan te doktori/resha deri në tre muajt e fundit të shtatëzarisë.

Kjo mund të shpjgohet me nivelin arsimor dhe statusin social-ekonomik – grupet me status më të ulët social – ekonomik kanë më pak akses në shërbimet e kujdesit para lindjes, dhe gratë me arsim më të lartë e kuptojnë më mirë nevojën për të kërkuar kujdesin para lindjes.

Pas lindjes së fëmijës, shëndeti i fëmijës dhe gruas ndiqen nga një mjek/e në *Konsultore* (qendra të specializuara për nënën dhe fëmijën). Vaksinimet për nënën dhe beben janë falas dhe nënat janë të pajisura me një fletore të dhënash për të shënuar të gjitha vaksinimet. Një shqetësim kryesor, për mendimin e pjesëmarrësve/eve, ishte se nënave të reja nuk u jepet trainim në kujdesin e bebeve. Gratë inkurajohen të lënë maternitetin brenda 24 orëve të lindjes.

Një numër masash janë marrë për të përmirësuar ushqyerjen gjatë shtatëzarisë. Sipas Protokollit të Ministrisë së Shëndetit, janë marrë masa për të shpërndarë suplemente hekuri dhe acidi folik gjatë shtatëzarisë. Ligji që inkurajon ushqyerjen me gji hartuar në bazë të rekomandimeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe në Kodin Ndërkombëtar të Marketingut të Zëvendësuesve të Qumështit të Gjirit thotë që gratë duhet të ushqejnë me gji bebet e tyre gjatë gjashtë muajve të parë. Ligji nuk ndalon marketimin e zëvendësuesve, por rregullon se si këto produkte shiten dhe ndalon dhënësit e shërbimeve të kujdesit shëndetësor që të lëshojnë receta për to pa rekomandimin e mjekut/es.

Spitali nuk merr masa në lidhje me ushqyerjen e grave shtatëzëna, por promovon ushqyerjen me gji. Nëse një nënë nuk ka mundësi të ushqejë me gji, bebjat ushqehen nga gra të tjera të shëndetshme që janë në gjendje të ushqejnë me gji. Më shumë ndihmë ekonomike për gratë gjatë shtatëzarisë dhe periudhës së qumështit është e nevojshme – megjithëse gratë marrin informacion se si duhet të ushqejnë veten dhe beben, asnjëherë nuk sigurohet që gratë do të kenë mjetet që ta bëjnë këtë si duhet.

Pjesëmarrëset raportuan praktika të mira të sesioneve të trainimit të ndërmarra për kontrollin e gjirit. Gratë që morën pjesë në këto sesione trainimi konsultoheshin me doktorët më shumë se ato që nuk kishin marrë pjesë në to. Pjesa më e madhe e shërbimeve të planifikimit familjar, duke përfshirë informacionin për planifikimin familjar, ofrohen falas, por jo të gjitha gratë përfitojnë nga këto pasi ato nuk janë të sigurta që fshehtësia e tyre do të ruhet nga personeli shëndetësor. Gratë mund të shkojnë në vende të ndryshme nga vendi i banimit, atje ku ato nuk njihen për të marrë kontraceptive falas. Planifikimi familjar si një masë e lënies së hapësirave kohore midis fëmijëve nuk pranohet ende, sidomos nga burrat, dhe më shumë fushata për ngritjen e ndërgjegjësimit duhet të bëhen mbi këtë temë.

Aborti është shfaqur gjerësisht si metodë kontraceptive. Një raport i vitit 2004 nga klinika Mary Stopes/Nesmark gjeti që 17,000 aborte bëhen çdo vit nga femrat e moshës 25 - 35 vjeç, megjithëse femrat që nga moshë 14 ose 15 vjeç abortojnë. Aborti i bazuar në seksin e fetusit është evidentuar si një dukuri serioze. Ndërsa shërbimet e abortit ofrohen, fushatat që përqëndrohen në pasojat e abortit për shëndetin e femrave janë të nevojshme.

Ligje diskriminuuese për HIV/AIDS. Shqipëria është një vend me prevalencë të ulët përsa i përket HIV / SIDA-s. Në vend nuk ka ligje diskriminuuese për personat e infektuar. Garantohej konfidencialiteti i trajtimit, megjithatë në praktikë shpesh janë vënë re raste të hapura të diskriminimit të femrave të prekura nga HIV/AIDS. Ka një shoqatë¹¹³ të personave të prekur nga HIV/AIDS, e cila mbron interesat e grave dhe vajzave. Megjithatë shoqata nuk merr ndonjë ndihmë nga shteti për zhvillimin e programeve të parandalimit dhe ndërgjegjesimit. Personat që janë të prekur nga HIV/AIDS i marrin mjekimet falas. Megjithatë është vënë re se mjekimet jo gjithmonë vijnë në kohë ose në sasinë e përshtatshme. Qeveria shqiptare nuk ka programe të posaçme për ndërgjegjësimin e grave dhe vajzave lidhur me HIV / AIDS.

Dhuna me bazë gjinore. Gratë dhe vajzat i nënshtrohen dhunës, sidomos në mjedisin familjar. Të paktën tetë përqind e grave shqiptare janë abuzuar fizikisht nga partneri intim, sipas një anketimi mbarëkombëtar të kryer në 2003. Ndërkohë që rreth 25 përqind gra rezultojnë se abuzohen psikologjikisht nga partnerët e tyre.

Një tjetër studim i kryer me një kampion përfaqësues të 1,039 grave të martuara në grupmoshën 25-65 vjeç që jetonin në Tiranë u përqëndrua në dhunën nga një partner intim dhe në karakteristikat shoqërore dhe demografike të grave dhe bashkëshortëve të tyre. Ai gjeti që më shumë se një të tretat e grave kishin provuar dhunë në familje. Rreziku më i madh ishte për grate në grupmoshën 25-34 vjeç, gratë me arsim universitar, gratë nëpunëse, gratë me bashkëshortë më pak të arsimuar dhe gratë e martuara me burra të rritur në zonat rurale.

Gratë ishin në rrezik më të madh nëse ishin më të arsimuara se bashkëshortët e tyre (Burazeri, Roshi, Jewkes, Jordan, Bjegovic & Laaser, 2005). Megjithatë pjesëmarrësit/et në intervista konfirmuan ekzistencën e dhunës në familje, ato gjithashtu përmendën se mbajtja e të dhënave për gratë e abuzuara është problematike përderisa gratë vetë e kanë të vështirë të raportojnë që ato janë abuzuar. Kjo është sidomos e vërtetë kur gratë kërkojnë ndihmë në qendrat shëndetsore. Trainimi për personelin mjekësor që trajton gratë e dhunuara nuk është sistematik. Mjekët e përgjithshëm janë trainuar dhe vazhdojnë të trainohen për të diagnostikuar dhe trajtuar rastet e dhunës në familje, por në mënyrë sporadike.

ENI 13 – EKONOMIA DHE JETA SPORTIVE-KULTURORE

Në regjimin pasuror martesor të bashkësisë ligjore, pasuria e bashkëshortëve prezumohet si e përbashkët, me përjashtim të rastit kur bashkëshorti provon karakterin e saj vetjak.¹¹⁴

Kodi i Familjes parashikon se secili bashkëshort ka të drejtën e administrimit të zakonshëm të pasurisë në bashkësi. Kryerja e veprimeve që kapërcejnë administrimin e zakonshëm u takon bashkërisht të dy bashkëshortëve. Ky Kod parashikon gjithashtu se nëse njëri nga bashkëshortët tejkalon të drejtat e tij mbi pasurinë në bashkësi, bashkëshorti tjetër ka të drejtë të kërkojë anulimin e veprimit.

Edhe në rastet e zgjidhjes së martesës gjykata mund të vendosë që njëri prej bashkëshortëve t'i paguajë bashkëshortit tjetër një kontribut kompensues, me qëllim që të kompensohet pabarazia që mund të shkaktohet nga ndarja e pasurisë pas zgjidhjes së martesës. Gjykata mund të lejojë përdorimin e banesës nga bashkëshorti jo pronar në rastet kur 1. I janë lënë fëmijët për rritje dhe edukim bashkëshortit jo pronar, derisa fëmijët të arrijnë moshën madhore; 2. Kur zgjidhja e martesës është bërë nga bashkëshorti pronar për ndërprerje prej tij të jetës së përbashkët. Këtë të drejtë e gëzon për shtatë vjet nëse ish bashkëshorti jo pronar nuk rimartohet gjatë kësaj periudhe; 3. Kur ish bashkëshorti jo pronar ka instaluar në këtë banesë një kabinet profesional me vlerë të madhe, lëvizja e të cilit do të kërkonte shpenzime të mëdha. Në këtë rast ai e gëzon të drejtën e përdorimit për tre vjet.

Legjislacioni shqiptar nuk e përmend shprehimisht barazinë apo mosdiskriminimin e grave në fushën e së drejtës civile. Megjithatë Kodi Civil, legjislacioni bankar dhe ligje të tjera përdorin gjuhë neutrale nga pikëpamja gjinore, të tilla si “çdo person”, “palët”, “personat fizikë”. Kështu Kodi Civil përcakton se të gjithë personat fitojnë zotësinë për të vepruar kur mbushin moshën 18 vjeç dhe që nga ai moment mund të kryejnë lirisht çdo lloj veprimi juridik. Ka raste kur Kodi Civil

¹¹³ Shoqata e Personave që Jetojnë me HIV/AIDS në Shqipëri - (PLWHA)

¹¹⁴ Ligji Nr.9062, datë 08.05.2003, neni 76.

përdor terma të tilla si “kreditor” apo “pronar” në gjininë mashkullore. Por kjo ndodh kudo në tekstet e ligjeve në Shqipëri.¹¹⁵

Ndonëse të gjithë, përfshi edhe juristët, me këto terma nënkuptojnë të dy gjinitë, të paktën për ligjet e ardhshme duhet të fillojë të përdoret një gjuhë e veçantë për të dy gjinitë dhe hartuesit duhet të ndërjegjësohen më shumë për problemet gjinore dhe lidhjen e tyre me legjislacionin. Kushtetuta shqiptare i garanton kujt do lirinë artistike dhe krijuese si dhe pjesëmarrjen në kërkimet shkencore (neni 58) ndërsa neni 59 parashikon lirinë e pjesëmarrjes në sporte dhe veprimtari zbavitëse. Sërish gjuha e përdorur është neutrale nga pikëpamja gjinore, por mungojnë dispozitat e posaçme për barazinë dhe mosdiskriminimin e grave në këto fusha të jetës ekonomike e sociale.

Huatë bankare dhe forma të tjera të kreditit financiar. Gratë rrallë aplikojnë për kredi, sepse ato perceptohen zakonisht sikur kanë një rol mbështetës në aktivitetet e biznesit. Gjithashtu, për shumë banka, politika e huasë kërkon që aplikuesi/sja të ketë kapital, ndërsa në të vërtetë pak gra e kanë një gjë të tillë. E drejta e gruas ndaj pronës zakonisht humbet kur prona rregjistrohet në emrin e burrit. Intervistat treguan për shumë raste kur banesa martesore e çiftit regjistrohet (ilegalisht) nën emrin e bashkëshortit, megjithëse të dy bashkëshortët kanë të drejta pronësie mbi pasurinë. Zakonisht gratë nuk kanë mbështetjen e burrave në marrjen e nismave të biznesit, ose në disa raste ato nuk kanë kurajo që të ndërmarrin një nismë të tillë. Mungesa e informacionit kontribuon gjithashtu në paaftësinë për të përdorur efektivisht bankat.

Pjesëmarrja në sporte, aktivitete çlodhëse, dhe të gjitha aspektet e jetës kulturore. Femrat mund të angazhohen me çdo sport dhe aktivitet çlodhës që ato zgjedhin. Burimet ekonomike mund të influencojnë pjesëmarrjen e njëjtë të femrave dhe meshkujve në aktivitete çlodhëse, megjithatë femrat janë aktive në disa prej këtyre fushave. Të financuara nga qeveria dhe donatorë të tjerë, shoqëri që përqëndrohen në organizimin e ngjarjeve kulturore të udhëhequra nga gra organizojnë aktivitete të ndryshme (piktura, ekspozita, festivale muzikore, shfaqje televizive, etj.) Është e vështirë të përcaktohet pjesëmarrja e vajzave dhe grave në sporte. Instituti i Statistikës nuk i ndan të dhënat për pjesëmarrjen në sport sipas përkatësisë gjinore. Megjithatë, pjesëmarrësit/et treguan se mungesa e fondeve dhe stereotipet për pjesëmarrjen e grave në sporte të caktuara i dekurajojnë femrat nga pjesëmarrja në sporte.

NENI 14 – GRUAJA RURALE

A. ASPEKTET LIGJORE

Së pari duhet të theksojmë që në asnjë prej ligjeve dhe akteve nënligjore në Republikën e Shqipërisë nuk bëhet ndonjë diferencim midis gruas në zonat rurale dhe asaj në zonat urbane. Si rrjedhojë gruaja në zonat rurale gëzon të njëjtat mundësi dhe të drejta si edhe gruaja në zonat urbane.

Megjithatë realiteti dëshmon ndryshe. Nisur nga kushtet ekonomike dhe sociale të drejtat që gëzon gruaja në zonat rurale janë shumë herë më të limituara se ajo në zonat urbane. Kjo gjë nuk ka lidhje me faktin se çfarë parashikon ligji, por me mundësitë për ta aksesuar vetë ligjin dhe zbatimin e tij. Kuptohet që për gratë në zonat rurale mundësitë janë shumë herë më të kufizuara, për shkak të kushteve të sipërpërmndura që lidhen edhe me zakonet dhe traditat në zonat rurale.

Legjislacioni shqiptar nuk bën ndonjë dallim mes grave të zonave bujqësore apo jobujqësore, ndonëse në praktikë jeta e grave fshatare mund të jetë më e vështirë. Po kështu nuk bëhet dallim në zbatimin e CEDAW-t për gratë fshatare dhe jofshatare. Pra, duke patur parasysh mungesën e legjislacionit të veçantë për gratë fshatare, këto gra, ose organizmat e shoqërisë civile që i përfaqësojnë mund të invokojnë në gjykatë dhe t’i kërkojnë shtetit të zbatojë drejtperdrejt Konventën mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit të Gruas.

Ligji për Barazinë Gjinore në fakt përmend një rrjet nëpunësish të barazisë gjinore në nivel lokal (qarku), por pa përcaktuar më tej se çfarë do të përfshijnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, si do të organizohen dhe funksionojnë ata, etj.

¹¹⁵ Raporti për Vlerësimin e Zbatimit të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas në Shqipëri. Botim i USAID Shqipëri, përgatitur nga Chemonics International. Tiranë, Dhjetor 2005

Legjislacioni bankar i ofron mundësinë e marrjes së huave kujtdo, pa dallim në lidhje me seksin apo vendbanimin. Shteti ofron kushte më të leverdisshme për pagesën e huave bujqësore, por sërish asnjë dallim nuk bëhet në varësi të gjinisë.¹¹⁶ Disa nene në Kodin Civil iu referohen familjeve bujqësore. Pronësia e kësaj familjeje iu përket të gjithë anëtarëve, të cilët përmes punës apo të drejtave të tjera, kanë kontribuar në krijimin dhe mbajtjen e kësaj veprimtarie të përbashkët ekonomike. Sipas nenit 224, familja bujqësore përfaqësohet nga kryetari i saj në marrëdhëniet tregtare apo pasurore me të tretët. Anëtarët e familjes bujqësore zgjedhin kryetarin e tyre, i cili ndonëse ligjërisht mund të jetë si femër ashtu edhe mashkull, në praktikë dhe me marrëveshje të heshtur është thuar se gjithmonë burrë. Edhe rastet e regjistrimit të pasurisë në emër të burrit nuk janë të rralla. Po të kemi parasysh vështirësitë që hasin gratë fshatare, është e rekomandueshme të ndërmerren masa legjislative dhe të tjera që t'u ofrojnë atyre më shumë mundësi.

B. ASPEKTET PRAKTIKE TË ZBATIMIT TË LIGJIT¹¹⁷

Njohja e situatës së grave në zonat rurale. Diskriminimi i grave në zonat rurale është veçanërisht i dukshëm. Zonat rurale ushqejnë më shumë praktika kulturore që pengojnë gratë në arritjet e tyre. Sipas mendimeve të disa pjesëmarrësve, gratë në zonat rurale nuk trajtohen me respekt, pasi këto zona nuk ecin me të njëjtin hap të zhvillimit si në zonat urbane. Shumë norma dhe zakone të vjetra janë rrënjësor në mënyrën e të menduarit dhe të vepruarit dhe këto pranohen nga të gjithë.

Pjesëmarrja në hartimin dhe zbatimin e planifikimit të zhvillimit në të gjithë nivelet. Gratë në zonat rurale në Shqipëri mund të jenë të interesuara që të marrin pjesë aktive në planifikimin e zhvillimit në të gjithë nivelet, por ndryshimet strukturore dhe në teknologji kanë sjellë përgjegjësi të reja në familjen rurale, sidomos për gratë. Shumë lehtësira komunitare dhe sociale si kopështet nuk ekzistojnë më; këto më parë ishin falas ose shërbimet ishin lehtësisht të përballueshme. Bujqësia nuk është më e mekanizuar. Kështu që ngarkesa e dyfishtë e punës prodhuese dhe riprodhuese sot i lë grave pak kohë dhe energji për të marrë pjesë aktivisht në çështjet komunitare.

Marrja e kujdesit shëndetësor në zonat rurale. Ekzistojnë mundësitë për të marrë informacion specifik mbi kujdesin shëndetësor. Kur kujdesi mjekësor profesionist nuk është i disponueshëm, gratë i referohen qendrave mjekësore në qytet, por këto janë rrallë të përballueshme financiarisht për to. OJF-të në bashkëpunim me qeverinë vendore, punojnë për të mbushur hendekun informativ në kujdesin e përgjithshëm shëndetësor dhe në veçanti atë për shëndetin riprodhues. Në zonat e largëta është vënë re një mërgim i gjerë ose largim nga detyra prej stafëve mjekësore. Një sërë qendrash shëndetësore janë mbyllur ose punojnë me orar të reduktuar. Qendrat shëndetësore po ndërtohen në komunitete të mëdha prej 2,000-3,000 banorësh. Jepet pagë shtesë për të inkurajuar mjekët e përgjithshëm për të shërbyer në zonat e largëta me pak ose aspak kujdes shëndetësor. Megjithatë stafet mjekësore në zonat rurale marrin pjesë në trainime të shpeshta, individët mund të marrin kujdes të specializuar shëndetësor vetëm në zonat urbane. Zgjedhja e bazuar në informacion nuk është ende e zakonshme për gratë në zonat rurale. Ato veçanërisht nuk kanë informacion mbi shëndetin mendor.

Përfitimi i drejtpërdrejtë nga programet e sigurimeve shoqërore. Sipas INSTAT, pagesa e pensionit për individët në zonat rurale është një e treta e pagesës shtetërore të pensionit. Gjithashtu, gratë në zonat rurale e kanë të vështirë të përfitojnë nga skema shtetërore si sigurimet shoqërore, përfitimet e papunësisë, lejet për sëmundje, kompensimi për pension dhe moshën e thyer. Vetëm gratë që punonin në kooperativat shtetërore që u shpërbënë pas fillimit të viteve 1990 përfitojnë nga këto skema. Shumica e grave në zonat rurale janë tani të vetë-punësuarat dhe nuk kanë dëshirë ose janë të keqinformuara për të paguar sigurimet shoqërore vetë që të mund të përfitojnë në moshë të thyer.

Arsimi. Vajza në zonat rurale e kanë të vështirë të vazhdojnë arsimin në shkollë të mesme. Në fakt, numri i vajzave në zonat fshatare që ndjekin shkollat e mesme është zvogëluar. Kërkimet tregojnë se në zonat rurale brezi i ri i grave në fshat do të vuajë dënimin shtesë të analfabetizimit.

Sipas statistikave të Drejtorisë Arsimore Rajonale të Tiranës rezulton se gjatë vitit shkollor 2006-2007 kanë braktisur shkollën 793 nxënës nga zonat rurale të Tiranës, prej të cilëve 490 janë vajza. Nga vëzhgimet e vazhdueshme të bëra nga Qendra për Zhvillimin e Grave Rurale rezulton se ndërprerja e arsimimit të vajzave pas mbarimit të klasës së katërt, vjen

¹¹⁶ Kodi Civil, ligj nr. 7850, datë 29 korrik 1994, neni 222

¹¹⁷ Raporti për Vlerësimin e Zbatimit të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas në Shqipëri. Botim i USAID Shqipëri, përgatitur nga Chemonics International. Tiranë, Dhjetor 2005

kryesisht nga mentaliteti konservator, patriakal dhe “kanunor“. Vajzat mbyllen në shtëpi sepse janë rritur fizikisht dhe kështu nuk bëhen objekt thashethemesh për të tjerë, duke ndenjur në pritje të fejesës apo martesës së mundshme.

Një vëshrim etnografik i një fshati në veri të Shqipërisë në fund të viteve 1990-të, tregon se në kohën e studimit pothuaj asnjë nga vajzat e fshatit nuk ishte shkolluar përtej moshës 14 ose 15 vjeç. Shkolla më e afërt e mesme ishte në qytet, dhe frikërat reale të sulmimit dhe rrëmbimit e bënë frekuentimin shumë të rrezikshëm në sytë e shumë prindërve (Lawson, Mcgregor & Saltmarshe, 2000).

Në kuadrin e Ligjit për Qeverinë Vendore dhe decentralizimit të qeverisë vendore, problemet që lidhen me shkuarjen në shkollë të vajzave si djemtë janë zgjidhur individualisht nga komunat. Për shembull, megjithëse nuk parashikohet si detyrim ligjor, në shumë zona si në komunat e Fushë Arrëz, Malësisë së Madhe dhe Delvinës, ka funksionuar një shërbim me autobus që mbledh nxënësit dhe i dërgon në shkollë çdo ditë. Ky shërbim nuk është kombëtarizuar, por pjesëmarrësit/et debatuan se nisma të tilla ndodhin vetëm në zona ku qeveria vendore është e ndërgjegjësuar për çështjet e barazisë gjinore.

E drejta për mundësi ekonomike nëpërmjet punësimit ose vetë-punësimit. Përderisa nuk ekzistojnë ndërmarrje të mëdha, gratë kanë pak mundësi për punësim. Kjo nuk është e njëjtë për burrat që mund të emigrojnë për punë sezonale që të punësohen në qytet ose jashtë shtetit. Megjithëse disa agjensi zhvillimi i kanë ndihmuar gratë të fillojnë biznesin e tyre, në përgjithësi, ekzistojnë pak mundësi për të zhvilluar një biznes nëpërmjet kredisë si për burrat dhe gratë.

E drejta për të marrë pjesë në të gjithë aktivitetet e komunitetit. Gratë dëshirojnë të marrin pjesë në aktivitetet shoqërore dhe kulturore. Ndërsa gratë mbajnë peshën kryesore të kujdesit për fëmijët, pjesëmarrja në aktivitetet e komunitetit influencohet shumë nga ekzistenca e shërbimit të kujdesit për fëmijët. Ka shumë pak shërbime cilësore në zonat rurale. Në shumë zona nuk ka çerdhe dhe kopështe dhe gratë dhe anëtare të tjera të familjes kujdesen për fëmijët. Për më tepër, emigracioni i burrave jashtë shtetit apo aktiviteti tregtar i burrave i lë gratë të përballojnë pjesën më të madhe të punës bujqësore.

I vetmi argëtim për gratë mbeten dasmat ose festimet fetare. Parja e programeve televizive mund të jetë një mundësi tjetër argëtuese, por shpesh kjo nuk është e mundur pasi energjia elektrike mungon shpesh. Si shteti dhe OJF-të bëjnë pak për të adresuar pjesëmarrjen e grave në jetën komunitare.

Marrja e kreditit dhe borxhit bujqësor, reforma e tokës. Raporti Kombëtar i Zhvillimit Njerëzor (2005) raporton se mungojnë të dhënat zyrtare si hyrja në programet e kreditit dhe institucionet financiare si dhe numri i grave të vetëpunësuar në zonat rurale. Në intervista, gratë raportuan se në fillim të viteve 1990 kur ndodhi privatizimi i pronave, të gjitha pronat që i takonin kooperativave bujqësore u shpërdanë njësoj femrave dhe meshkujve sipas rregullave. Megjithatë, problem kryesor mbetet se nëse toka rishpërndahet sipas numrit të anëtarëve të familjes, ajo u rregjistrua në emër të kryetarit të familjes që është në të njëjtën kohë dhe pronari i ligjshëm i pronës. Kështu, zakonisht, respekti i të drejtës së grave ndaj tokës dhe pronave është në dorë të burrave.

Gratë zakonisht e trashëgojnë tokën nga baballarët. Sipas zakonisht dhe traditës, nëse një grua ka të drejtën e tokës në familjen e origjinës, ajo duhet t'ia dorëzojë familjes këtë pronë kur martohet. Ajo nuk ka të drejtë të ketë në pronësi tokë apo të tjera gjëra në familjen e bashkëshortit. Megjithatë, edhe kur toka i takon gruas, ajo konsiderohet pronë e të gjithë familjes, dhe gratë zakonisht nuk lejohen të administrojnë tokën sipas dëshirës së tyre. Kur lindin konflikte për tokën, femrat dhe meshkujt kanë të drejtë të mbrojnë pronën e tyre. Zakonisht këto raste zgjidhen në gjyq. Nuk është raportuar asnjë rast diskriminimi ndaj grave deri tani në këtë fushë.

Strehimi, higjena, elektriciteti dhe furnizimi me ujë, transporti dhe komunikimi. Ndërsa kushtet e jetesës janë përmirësuar deri në një shkallë, standartet e jetesës janë më të ulta se në zonat urbane. Sipas INSTAT, shtëpitë në fshat janë me kushte jetese më të dobta se ato në zonat urbane. Po ashtu kushtet e punës për gratë janë më të vështira në zonat rurale. Megjithëse shumica e familjeve fshatare në zonat e pjesëmarrësve/eve kanë ujë në shtëpitë e tyre, të dhënat nga INSTAT tregojnë se rreth 43 përqind e familjeve në vend e bëjnë furnizimin me ujë jashtë ndërtesës dhe rreth 41 përqind përdorin pus ose depo.

Ashtu si në zonat urbane, shtëpitë në zonat rurale i plotësojnë nevojat e tyre për ngrohje në mënyrë individuale. Nuk ekziston sistemi i ngrohjes qendrore. Furnizimi me elektricitet është njësoj problematik në zonat urbane dhe rurale, nëse jo më i keq në këto të fundit. Ekziston mundësia për transport në zonat urbane, por ky është një shërbim i privatizuar dhe burime financiare nevojiten për të përballuar shpenzimet.

Dhuna me bazë gjinore në zonat rurale. Ndërsa media raporton për praninë e dhunës me bazë gjinore, dhe sidomos rastet e vrasjeve, pjesëmarrësit/et vetë nuk raportuan asnjë rast dhune. Megjithatë, një nga sfidat e luftës kundër dhunës me bazë gjinore në këto zona është njohja e dhunës si problem dhe të besuarit dhe përdorimit të institucioneve përkatëse të ndihmojnë në adresimin e kësaj dhune.

NENI 15 – BARAZIA PËRPARA LIGJIT

Një grup tjetër të drejtash civile është dhe ai i njohur nën termin “e drejta për një proces të rregullt ligjor”. Këtu, përveç të tjerash përfshihen e drejta për një proces publik nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, “presumimi i pafajësisë”, parimi i mosgjyqimit dy herë për të njëjtën vepër dhe ndihma ligjore.

E drejta për një proces të rregullt ligjor është një e drejtë që garantohet nga Kushtetuta. E drejta për trajtim të barabartë dhe mbrojtje nga ligji natyrisht që klasifikohet si e drejtë civile, në të njëjtën kohë kjo e drejtë luan një rol esencial për realizimin e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore.

Gratë në mënyrë të barabartë si dhe burrat kanë të drejtë që për të mbrojtur interesat e tyre të ligjshme t’i drejtohen gjykatës apo organeve kompetente shtetërore.

Neni 42 i Kushtetutës shprehet për njohjen e kësaj të drejte për të gjithë qytetarët dhe nuk privon asnjë person për asnjë arsye nga kjo e drejtë. Pra nuk privohen vajzat dhe gratë nga kjo e drejtë për arsye seksi, etj. Nëse grave dhe vajzave u cënohet kjo e drejtë kjo nuk duhet kuptuar thjesht në kuptimin e procedurës, pra procesi ligjor nuk ka qenë i rregullt por edhe që i janë cënuar liria, e drejta e pronës, dhe të drejta të tjera të njohura me kushtetutë pa një proces të rregullt ligjor. Procesi i rregullt ligjor sipas nenit 42 të Kushtetutës përfshin këto elementë :

- a. gjykim i drejtë dhe publik
- b. gjykim brenda një afati të arësyeshem
- c. gjykim nga një gjykatë e caktuar me ligj
- d. gjykim nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme

Një nga elementët më të rëndësishëm që ka lidhje me çështjen është gjykata e paanshme. Paanshmëria përfshin disa elementë por elementi më themelor mbetet ai i barazisë midis palëve. Në praktikën tonë ligjore gratë dhe burrat kanë mundësi të barabarta për ta paraqitur çështjen pranë gjykatës kompetente. De jure burrat nuk mund të gëzojnë privilegje në krahasim me gratë për shkak të seksit dhe asnjë palë nuk mund të diskriminohet për këtë arsye.

Për çdo shkelje të kësaj të drejte gratë mund ti drejtohen Gjykatës Kushtetuese. E drejta për një proces të rregullt ligjor kërkon për shembull gjyqtarë të trainuar mirë, prokurorë, avokatë dhe policë, si dhe burgje të përshtatshme e të tjera lehtësira. Pavarësisht se kjo e drejtë garantohet me ligj, zbatimi në praktikë i legjislacionit ekzistues i cënon gratë nga gëzimi i kësaj të drejte.

Kodi Civil parashikon moshën tetëmbëdhjetë vjeç, si moshë kur personit i lind zotësia e plotë që me veprimet e tij të fitojë të drejta dhe të marrë përsipër detyrime civile. Gruaja që nuk e ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç e fiton zotësinë e plotë për të vepruar me anë të martesës.

Ligjet e shtetit u sigurojnë grave të drejta të barabarta në të gjitha fazat dhe procedurat e gjykatës dhe organeve të tjera dhe në të gjitha funksionet. Nuk bëhet asnjë dallim në këto të drejta mbi bazën e seksit.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë garanton të drejtën e pronës private. Kushtetuta nuk përfshin etiketime gjinore. Etiketimet e përdorura në kushtetutë si “secili”, “kushdo” dallohen për neutralitetin e tyre. Nuk ka asnjë dispozitë diskriminuese në legjislacionin shqiptar që të kufizojë gruan nga gëzimi i të drejtës së pronësisë. Gruaja mund të disponojë dhe të gëzojë pasuri të tundshme dhe të patundshme dhe ka të drejtën e shitblerjes dhe të trashëgimisë njësoj si dhe burri.

Kodi i Familjes përcakton përbërjen e bashkëpronësisë familjare, në nenin 74 të tij. Kodi i Ri i Familjes parashikon se pasuria e bashkëshortëve merret e mirëqenë si e përbashkët dhe të drejtat për të administruar pasurinë nuk kufizohen për shkak të seksit ose gjendjes civile.

Neni 11 i Kodit Civil parashikon se veprimi juridik që kufizon zotësinë për të vepruar është i pavlefshëm. Duke kuptuar me veprim juridik çdo kontratë apo instrument tjetër privat, Kodi Civil parashikon pavlefshmërinë e tyre kur ato synojnë kufizimin e zotësisë juridike të grave.

Kodi Civil, parashikon se çdo person madhor ka të drejtë të caktojë lirisht vendbanimin e tij.¹¹⁸

Kodi i Familjes, në nenin 55 të tij parashikon të drejtën e bashkëshortëve për të zgjedhur banesën ose vendbanimin e tyre, me marrëveshje të përbashkët. Në rast mosmarrëveshje Kodi i Familjes parashikon të drejtën e secilit prej bashkëshortëve, pra pa dallim gjinie t'i drejtohen gjykatës, e cila pasi dëgjon mendimet e secilit bashkëshort si dhe mendimin e fëmijëve që kanë mbushur moshën katërbëdhjetë vjeç, merr vendimin më të përshtatshëm për kërkesat e familjes.

NENI 16 – JETA PRIVATE DHE FAMILJARE

Neni 16 i Konventës CEDAW vendos detyrimin e shteteve palë që të marrin të gjitha masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin e gruas në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me martesën dhe mardhëniet familjare.

Fejesat dhe martesat e fëmijëve të mitur nuk kanë efekt juridik, prandaj nga shtetet merren të gjitha masat e nevojshme, përfshirë dispozitat ligjore, me qëllim që të caktohet një moshë minimale për martesë dhe të bëhet i detyrueshëm regjistrimi i martesës në një regjistër zyrtar.

E sanksionuar shprehimisht në nenin 53 të Kushtetutës sonë, e drejta për një jetë familjare normale paraqitet më komplekse sesa duket në pamje të parë dhe përbëhet nga tre përbërës të rëndësishëm: e drejta për të krijuar familje; e drejta për të jetuar në të, si dhe e drejta për të respektuar barazinë bashkëshortore dhe intimitetin e jetës familjare.

E drejta për t'u martuar dhe për të gëzuar një jetë të qetë private dhe familjare, i është nënshtruar një procesi konsolidimi të vazhdueshëm me aktet ligjore ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar. Legjislacioni i brendshëm civil dhe penal, në mbrojtje të kësaj të drejte është në një proces përqasjeje të vazhdueshme me instrumentat ndërkombëtarë.

Kodi i Ri i Familjes solli transformime të mëdha në të drejtën familjare, me qëllim eliminimin e diskriminimit të gruas në çështje që kanë të bëjnë me martesën dhe marrëdhëniet familjare. Ai përshkohet tërësisht nga parimi i barazisë midis bashkëshortëve. Të drejtat u njihen të dy bashkëshortëve pavarësisht nga dallimet gjinore, duke qenë kështu në përputhje me normat e parashikuara në nenin 16 të Konventës CEDAW, për të zgjedhur lirisht bashkëshortin dhe për të lidhur martesë vetëm me pëlqimin e vet, të lirë dhe të plotë.

Të drejtat dhe detyrimet e bashkëshortëve në martesë janë të njëjta. Detyrimi për të mbështetur bashkëshortin tjetër si moralisht dhe materialisht, për besnikëri dhe bashkëpunim është detyrim reciprok për të dy bashkëshortët.

Kodi i Familjes parashikon pëlqimin e lirë të bashkëshortëve si një nga kushtet thelbësore për lidhjen e martesës.¹¹⁹ Elementi i pëlqimit përbën një kusht të rëndësishëm i cili duhet të jetë i lirë. Mungesa e pëlqimit të lirë të bashkëshortëve në lidhjen e martesës parashikohet si një nga shkaqet për ta shpallur atë të pavlefshme juridikisht.¹²⁰

Pavlefshmëria e martesës. Kodi i Ri i Familjes shpall të pavlefshme martesën e lidhur me lajthim, martesën e lidhur nga një person që vuan nga një sëmundje e rëndë psikike ose ka zhvillim mendor të metë, martesën e lidhur në kushtet apo ndikimin e një kanosjeje, duke iu referuar pikërisht shkëljes së kushtit të pëlqimit të lirë të bashkëshortëve të ardhshëm.

¹¹⁸ Ligji Nr.7850, datë 29.07.1994, "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", neni.12.

¹¹⁹ Kodi i Familjes, Ligji nr.9062, datw 08/05/2003, neni 8

¹²⁰ Kodi i Familjes, Ligji.9062, datë 08/05/2003, neni 33

Kështu, duke e konsideruar si element thelbësor pëlqimin e bashkëshortëve, çdo martesë e lidhur nën ndikimin e një kanosjeje shpallet e pavlefshme.¹²¹ Legjislacioni penal e parashikon si kundravajtje penale çdo lloj shtrëngimi ose pengimi për të filluar ose vazhduar bashkëjetesën, apo për të zgjidhur martesën (dënimi me gjobë ose me burgim gjer në tre muaj).

Kodi i Familjes parashikon mirëkuptimin mes bashkëshortëve në administrimin e pasurisë, zgjedhjen e regjimit pasuror, zgjedhjen e banesës bashkëshortore.

Bashkëshortët janë të lirë të zgjedhin regjimin pasuror martesor dhe të lidhin kontratë martesore me akt noterial. Ndalohet të parashikojnë në marrëveshjet e tyre martesore dispozita që sjellin shmangien e tyre nga detyrimet që rrjedhin nga martesa. Bashkëshortët janë të lirë të ushtrojnë një profesion të caktuar, të disponojnë të ardhurat nga puna dhe të ardhurat e tjera, sipas regjimit martesor përkatës, pasi të kenë kontribuar në detyrimet që rrjedhin nga martesa. Bashkëshortët kanë të drejtë të administrojnë dhe të tjetërsojnë lirisht sendet e tyre vetjake.

Kodi i Familjes parashikon pëlqimin reciprok të bashkëshortëve për zgjidhjen e martesës kur martesa zgjidhet me pëlqimin e palëve.

Parimi i barazisë së bashkëshortëve shtrihet edhe në çështjet e pjestimit të pasurisë pas zgjidhjes së martesës. Kodi i Familjes parashikon detyrimin e njërit prej bashkëshortëve për të kontribuar në llogari të tjetrit, përveç detyrimit për ushqim duke e konsideruar këtë si një masë që të kompensojë pabarazinë që mund të sjellë ndarja e pasurisë në zgjidhjen e martesës. Gjykata çmon sipas rastit konkret masën e kontributit, pagesën e tij në mënyrë të menjëhershme ose periodike si dhe mënyrën e pagimit të këtij kontributi. Ndonëse paraqitet si një dispozitë mjaft e rëndësishme, nga monitorimi i çështjeve familjare rezulton se bashkëshortët, pak i referohen kësaj dispozite.

Me qëllim zbutjen e pabarazisë së krijuar të bashkëshortëve pas zgjidhjes së martesës, kur banesa familjare është në pronësi të njërit ish-bashkëshort dhe bashkëshorti tjetër nuk ka në pronësi banesë tjetër të përshtatshme, neni 153 i Kodit të Familjes parashikon që gjykata mund të lejojë përdorimin e banesës nga ish bashkëshorti jo-pronar në rastet që vijnë: i janë lënë fëmijët për rritje dhe edukim dhe kur ish-bashkëshorti pronar, me ndërprerjen e jetesës së përbashkët, është bërë shkak për zgjidhjen e martesës. Kjo dispozitë është bërë objekt debatesh, nëse në emër të parimit të barazisë së bashkëshortëve çenohet ose jo e drejta e pronësisë së ish- bashkëshortit pronar. Dispozita vazhdon të mbetet deklarative më shumë se sa e zbatueshme. Ndryshimi i rrethanave të ish bashkëshortëve u jep të drejtën këtyre të fundit, për t'ju drejtuar gjykatës.

Kodi i Familjes mbështetet tek parimi i rëndësishëm i interesit më të lartë të fëmijës dhe të barazisë së prindërve në ushtrimin e përgjegjësisë prindërore.

Të drejtat dhe detyrimet që kanë prindërit në lidhje me fëmijët e tyre, ku hyjnë mirërritja, edukimi, përfaqësimi ligjor, administrimi i pasurisë, arsimimi, etj., përbëjnë përgjegjësinë prindërore dhe prindërit e ushtrojnë këtë përgjegjësi në mënyrë të barabartë. Ky parim mbahet në konsideratë nga gjykata, e cila kur vendos për mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë, mbështetet në një analizë të thellë të interesave të fëmijës.

Kodi i Familjes përshtohet nga parimi i dëgjimit të fëmijës në çdo procedurë që i përket atij në përputhje me moshën dhe aftësitë e tij për të kuptuar.

Kushtetuta garanton mbrojtje të njëjtë për fëmijët e lindur në martesë dhe jashtë martesë. Në këtë mënyrë gruaja nuk diskriminohet për faktin se ka krijuar një familje pa martesë dhe aq më pak fëmija i lindur, nuk mund të diskriminohet për shkak se ka lindur jashtë martesës.

Kodi i ri i Familjes, realizon mundësi ligjore të barabarta nga pikëpamja moshore, si për burrat dhe për gratë, duke përcaktuar moshën 18 vjeç si moshë minimale për lidhjen e martesës.¹²² Kjo dispozitë që cakton moshën minimale për martesë është një dispozitë e rëndësishme që tregon se legjislacioni ynë i brendshëm është në përputhje me Konventën CEDAW.

121 Kodi i Familjes, Ligji.9062, datë 08/05/2003, neni 37

122 Kodi i Familjes, Ligji.9062, datë 08/05/2003, neni 7

Martesa e lidhur nga personi, që nuk e ka mbushur moshën e parashikuar në Kodin e Familjes është e pavlefshme dhe si e tillë nuk ka efekt juridik. Nëse gjykata konstaton se ka shkaqe të rëndësishme për lidhjen e martesës ajo e lejon martesën edhe para kësaj moshe. Si shkaqe me rëndësi mund të konsiderohen nga gjykata shtatzania, lindja e një fëmije, etj.

Martesa vendos detyrimin e bashkëshortëve për të mbajtur, arësimuar dhe edukuar fëmijët. Zgjidhja e martesës nuk prek të drejtat dhe detyrimet që kanë prindërit ndaj fëmijëve të tyre.¹²³ Prindi, që nuk i është lënë fëmija për rritje dhe edukim ruan të drejtën të mbikqyrë mbajtjen dhe edukimin e fëmijës e për pasojë të informohet dhe të konsultohet për zgjedhjet e rëndësishme që lidhen me jetën e tij. E drejta e vizitës dhe e banimit mund të refuzohen vetëm për arsye të rënda që dëmtojnë rëndë interesat e fëmijës.

Kodi i Familjes parashikon se përgjegjësia prindërore u përket dhe ushtrohet së bashku nga të dy prindërit në lidhje me fëmijët e tyre.

Bashkëshortët gëzojnë të drejtën e zgjedhjes së mbiemrit. Nuk ka asnjë dallim gjinor që të jetë përcaktues në këtë zgjedhje. Ata janë të lirë të zgjedhin si mbiemër të përbashkët njërin nga mbiemrat e tyre, ose secili është i lirë të mbajë mbiemrin e vet.

Mund të ndodhë që prindërit kanë mbiemra të ndryshëm. Në këtë rast fëmijët mbajnë një mbiemër, atë që vendosin prindërit me marrëveshje. Kur prindërit nuk arrijnë në një marrëveshje, fëmijët mbajnë mbiemrin e të atit. Neni 63 i Kodit të Familjes parashikon që secili nga bashkëshortët mund të ushtrojë lirisht një profesion.

Kodi Civil parashikon barazinë midis burrit dhe gruas në lidhje me zotërimin e tokës si pronë e përbashkët e anëtarëve të familjes bujqësore. Pavarësisht garantimit të kësaj të drejte me ligj, në praktikë gruaja diskriminohet duke mos gëzuar të drejta të barabarta mbi pronësinë, e në mënyrë të veçantë në lidhje me transaksionet e ndryshme, të cilat përbëjnë një të drejtë ekskluzive të burrit. Administrimi dhe rregullimi ligjor i të drejtave të pronësisë së anëtarëve të familjes bujqësore parashikohet në Kodin Civil në nenet 222-230.

Por janë disa aspekte ku shfaqet cënimi i të drejtave të grave në lidhje me pronën bujqësore:

1. Sipas të drejtës zakonore trashëgimia e tokës realizohet në vijën mashkullore, duke i përjashtuar vajzat si pjesë të familjes bujqësore.
2. Tjetërsimi i pasurisë së familjes bujqësore kryhet pa pëlqimin e gruas.
3. Procedurat e pjestimit të pasurisë ku përfshihet edhe toka janë të ndërlikuara. Mos njohja nga gruaja e këtyre procedurave rrezikon që ajo të humbasë të drejtën e pronësisë.

Kodi i Familjes parashikon të drejtën e secilit bashkëshort për administrimin e zakonshëm të pasurisë në bashkësi.

¹²³ Kodi i Familjes, Ligji.9062, datë 08/05/2003, neni 154

4. GRUAJA DHE MEDIA

A. Stereotipet dhe problemet që ekzistojnë për “Gratë në Media”¹²⁴

Prezantimi i grave dhe vajzave në media është një çështje tepër e ndjeshme e shoqërisë pasi media u jep formë perceptimeve të publikut, sepse ajo është një mjet i rëndësishëm komunikimi i cili influencon procesin e integritit gjinor duke mbështetur një parim kryesor të demokracisë: të drejtën e barabartë të përfaqësimit. Në shumicën e rasteve fokusi parësor i medias shqiptare ka qenë dhe mbetet sfera politike ndërsa aspektet e tjera anashkalohen apo trajtohen shkarazi. Në Shqipëri burrat shihen dhe përdoren si burime parësorë informacioni kur citohen nëpër artikuj, ndërsa gratë shihen si dytësore, “më të rëndësishme” se politika dhe ekonomia. Ky perceptim transferohet tek ata nga mbikqyrësit e tyre ose editorët të cilët në shumë raste vendosin se çfarë “përbën lajmin”. Sferat e influencës për gratë dhe burrat janë mjaft të qarta: për burrat është politika dhe biznesi ndërsa për gratë është moda, bukuria, shtëpia dhe kultura.

Burrat politikanë intervistohen dhe mbi çështjet më të imta ndërsa gratë politikane tërheqin shumë pak vëmendje dhe mendimet e tyre rrallë herë ekspozohen dhe për probleme të mëdha me të cilat përballen shoqëria shqiptare. Në gazeta pasqyrohet biografia e plotë e burrave politikanë duke iu dhënë një konsideratë dhe hapësirë e mjaftueshme, ndërsa një gjë e tillë nuk konstatohet për gratë politikane pasi biografitë e tyre pothuajse nuk ekzistojnë në artikuj.

Në shumicën e artikujve, gratë prezantohen në rolin e viktimës. Ajo është një personazh që ka përjetuar dhunë nga dikush tjetër (zakonisht burrat) apo është trafikuar dhe jo një individ që ka kontribuar në zhvillimin e shoqërisë. Femra paraqitet në mënyrë joprofesionale, jo vetëm nëpërmjet gjuhës së përdorur por edhe nëpërmjet mënyrës se si portretizohen ato nëpërmjet imazheve. Nuk referohen si burime informacioni, gjykohen negativisht dhe problemet e tyre të përditshme nuk prezantohen në publik. Edhe në rastet kur ato raportohen, vërehet një sjellje mashkullore dhe e egër ndaj përdorimit të tyre si burim informacioni. Kur flasim për vetë artikujt, në shumicën e rasteve, gratë thjesht injorohen duke mos qenë subjekt i ligjëratës, ose thjesht përfliten brenda disa kornizave të ngushta dhe sipërfaqësore. Ka mjaft raste kur gratë përshkruhen nëpërmjet një gjuhe diskriminuese duke nënvleftësuar kështu imazhin e tyre në familje dhe shoqëri. Ato përshkruhen si të varura prej burrave, të dobëta, të paafta për të kryer veprime profesionale dhe thjeshtë të afta për të bërë punët e shtëpisë. Shumë rrallë kushtet e vështira të jetesës, papunësia, ngacmimi seksual në punë, dhuna në familje, etj. bëhen pjesë e debatit publik. Dhe pse gratë janë pjesë e tij, rolin kryesor e luajnë burrat.

Gratë mund të injorohen në përdorimin e gjuhës thjesht duke mos qenë subjekt i ligjëratës. Termat mashkullorë mund të përdoren për t’iu referuar subjekteve të pacaktuara nga gjinia si shembujt më konkretë se si gjuha mënjanon gratë. Ato mund të përshkruhen brenda disa kornizave të ngushta dhe në mënyrë sipërfaqësore. Ky përshkrim i ngushtë i gjuhës mbi gratë lidhet me faktin se ato diskutohen më shpesh në lidhje me marrëdhëniet që kanë me të tjerët, ndërsa burrat shihen dhe diskutohen më shpesh mbi gjërat që ata bëjnë.

Kur flasim për imazhet e prezantuara në media për gratë mund të ndalemi në disa aspekte kryesore. Stereotipet që prezantohen nëpërmjet fotove të shpejta, imazheve disa-sekondëshe, njëra pas tjetrës i përcjellin audiencës mesazhin se cila gjini është “e dobët dhe e ndjeshme” dhe cila është “e fortë dhe e llogjikshme”. Shitja e imazheve nëpërmjet marketimit dhe bujshmërisë është një nga karakteristikat kryesore në median shqiptare. Gratë dhe vajzat e reja që i përshkatan “idealit” të bukurisë shesin gjithfarë produktesh në media nëpërmjet paraqitjes së jashtme dhe seksualitetit.

Pjesëmarrja e grave dhe burrave në masmedia është një çështje e rëndësishme lidhur me aksesin dhe kontrollin e medias. Ndërsa numri i grave në media në Shqipëri është rritur, burrat vazhdojnë të dominojnë në postet vendimmarrëse. Pengesat të cilat i mbajnë gratë larg posteve vendimmarrëse, kufizojnë të drejtën e grave për pjesëmarrje në jetën publike. Mënyra si gratë dhe burrat portretizohen në media mund të përforcojë apo sfidojë stereotipet gjinore. Për shembull, gratë dhe burrat politikanë shpesh përshkruhen në mënyrë të ndryshme: taktikat agresive që përdoren nga burrat shihen si shenja të qarta të “këmbënguljes dhe burrërisë” ndërsa nëse gratë përdorin të njëjtat mënyra si burrat, atëherë ato shihen dhe etiketohen si të papërshtatshme. Për më tutje, media fokusohet më shumë në paraqitjen fizike të grave politikane dhe

¹²⁴ Gjermani, E. dhe Bregu, M. “Monitorimi i shtypit mbi dhunën në familje 2001-2002”, Qendra e Gruas, Tiranë, 2003. / Picari, B. Turshilla, S. dhe Çausi, E. “Monitorimi i medias gjatë fushatës elektorale”, Aleanca Gjinore për Zhvillim, Tiranë, 2005. / Gjermani, E. dhe Picari, B. “Monitorimi i medias 2006”, Aleanca Gjinore për Zhvillim, Tiranë, 2006.

aspektin e tyre emocional sesa në kontributin e tyre dhe vlerat që ato mbështesin. Ky portretizim i grave dhe i burrave reflekton edhe kushtet socio-shoqërore, të cilat ndjekin rregullat e tyre, edhe në veçanti rregullat e tregut. Çështjet gjinore zakonisht perceptohen të jenë çështje “grash” dhe si rrjedhojë u lihet faqja e pasme e gazetave dhe revistave.

B. Prezantimi i grave në media gjatë zgjedhjeve

Konstatime të ngjashme vihen re në monitorimin e medias elektronike përgjatë fushatës elektorale të vitit 2005. Kronikat e fushatës elektorale të përqëndruara mbi politikanët burra përfshinë mbi 90 përqind të kronikave të përgjithshme si dhe zotëruan rreth 95 përqind të minutazhit kohor në median elektronike. Dhe pse shumica e gazetarëve/eve të televizioneve të ndryshme ishin gra dhe vajza, ata nuk u përqëndruan mbi problemet e politikaneve gra por përgjithësisht kanë trajtuar në tërësi tematikën e planit të partisë dhe liderit partiak. Në Shqipëri ka qenë dhe vazhdon të mbetet problematike ashpërsia e luftës politike. Në 80 përqind të rasteve të monitorimit të shtypit në artikuj të ndryshëm rezultojnë se ashpërsia e politikës shqiptare është kriteri numër një, që gruaja nuk del në sipërfaqe. Në zgjedhjet e 2005-ës u vërejt vetëm një rritje e papërfillshme në numrin e grave të zgjedhura (7,1 përqind) dhe këto zgjedhje mund të shihen si një tjetër mundësi e humbur për të trajtuar këtë problem.

Megjithëse media mund të mos jetë përgjegjëse për veprimet, qëndrimet ose sjelljet e individëve, ajo është padiskutim e plotfuqishme në formimin e opinionit publik, theksimin e çështjeve apo perspektivave që mund të jenë objekt i debateve publike. Pra si një mjet kaq i fuqishëm i komunikimit, media mund të luajë një rol kyç në integrimin e perspektivës gjinore dhe është një nga faktorët kryesorë në eliminimin e stereotipeve shoqërore me objektiv arritjen e barazisë gjinore. Kronikat e monitoruara mbi kandidatët/et e zgjedhjeve të 3 Korrikut janë përqëndruar më shumë në dy partitë e mëdha PS dhe PD, kandidatët e të cilave kanë patur mundësi të kenë një prezantim më cilësor në krahasim me përfaqësimin e kandidatëve të partive më të vogla si dhe kandidateve gra të tyre të cilat kanë qenë dhe më shumë të nënperfaqësuara.

Përveç kësaj, monitorimi nxori në pah se ekzistonte pabarazi mes partive të vogla, disa prej të cilave, u pasqyruan shumë më pak se të tjerat. Mund të theksojmë që dhe në kronikat ku përshkruhet kandidatja nuk flitet për të në mënyrë direkte, por theksohet gjerësisht rëndësia e pjesëmarrjes së grave në politikë duke komentuar se nëse këto gra do të përfshiheshin në të, politika do të ishte më e mirë sot. Në 80 përqind të rasteve të kronikave (121), kandidatet gra nuk kanë mundur as të vetëprezantohen dhe jo më të paraqesin axhendën e tyre politike. Në rastet në të cilat ato kanë mundur të vetëprezantohen apo të komentohen nga liderat partiakë (10% të kronikave) komentet kanë qenë jo cilësore duke nënvizuar stereotipet ekzistuese mbi rolin e grave në shoqërinë tonë. Kuptohet, fokusi i gazetarit gjatë një kronike mbi kandidimin politik shpeshherë i jep një ngjyrim të veçantë kronikës dhe mund të themi se shpesh “i jep drejtim” rrjedhës së saj. Në shumicën e rasteve, gazetarët nuk kanë patur një fokus të përcaktuar dhe si rrjedhojë disa qindra kronika janë mbështetur mbi planin partiak dhe jo vlerat e veçanta të kandidatëve të ndryshëm. Kjo gjë vjen si rrjedhojë dhe sepse media reflekton normat shoqërore.

Vëzhgimi dhe mënyra e trajtimit të medias Shqiptare ndaj grave në politikë përfaqëson një reflektim të drejtpërdrejtë të mentalitetit ekzistues mbi rolin e grave në sferën publike dhe pjesëmarrjen e saj në nivelet vendimmarrëse. Mediatizimi i dobët gjatë fushatës elektorale të zgjedhjeve të 3 korriut 2005 në Shqipëri të kandidateve gra krijoi një raport të përfaqësimit të dizbalancuar ndërmjet atyre dhe kandidatëve burra. Një nga arsytet e këtij problemi është vetë fakti se tregu i organeve të medias është nënpopulluar nga gratë dhe vajzat përse i përket pozicioneve drejtuese.

C. Media dhe dhuna ndaj grave dhe vajzave

Kur flasim në lidhje me trajtimin e rasteve të dhunës ndaj grave në media, imazhet dhe stereotipet janë tronditëse. Gratë dhe vajzat e reja janë viktimat kryesore të dhunës në familje por nuk ekziston njëfarë ndërgjegjësimit nga ana e gazetarëve për ti trajtuar këto çështje si një problem themelor i shoqërisë shqiptare. Dhuna në familje shihet si një çështje private dhe nuk trajtohet si problem shoqëror. Për më tepër, dhuna në familje manifestohet si një dhunë fizike dhe seksuale ndërsa dhuna psikologjike/emocionale edhe pse është prezente në masë të madhe nuk trajtohet gjerësisht nga media. Stereotipet e shoqërisë transmetohen nga mediat e ndryshme përmes imazheve dhe shkrimeve që përcillen tek publiku. Në shumicën e artikujve mungon analiza e problemeve apo zgjidhjeve të mundshme të tyre. Shumica e gazetave ekzistojnë për qëllime përfitimi në mënyrë që të shesin sa më shumë kopje të mundshme të gazetës së tyre. Përpjekja për të prezantuar lajme sensacionale, të cilat tërheqin vëmendjen e lexuesit dhe çojnë në shitjen e shpejtë të gazetave, krijon hapësira për të mos

respektuar parimet e etikës dhe profesionalizmit gazetaresk. Ndërkohë, gazetarët nuk marrin në konsideratë faktin se trajtime të tilla të problemeve dëmtojnë viktimën, abuzuesin, familjet dhe të gjithë komunitetin.

Është për të ardhur keq që trajtimi i gruas si pronë vazhdon të ekzistojë në shoqërinë shqiptare dhe është një nga faktorët që çon në viktimizimin e saj. Ky viktimizim thellohet më tej edhe gjatë trajtimit që gazetarë të ndryshëm i bëjnë këtij problemi. Pavarësisht nga përpjekjet për të realizuar trajtimin e këtij problemi, në artikujt e monitoruar mungojnë analizat e hollësishme për të zbuluar natyrën, shkaqet dhe mënyrat e parandalimit të tij. Artikujt mbeten thjesht informues pa u përpjekur të kryejnë një tjetër funksion të rëndësishëm të medias, atë edukues. Pavarësisht nga përpjekja për t'i dhënë një hapësirë të madhe trajtimit të problemeve të lidhura me dhunën në familje, media e shkruar nuk ka arritur që të ngrejë zërin mbi problemet e barazisë gjinore. Duke qenë se, media ka një ndikim të jashtëzakonshëm në ndryshimin e qëndrimeve dhe opinionëve, në formimin e perceptimeve ajo mund dhe duhet të ndihmojë në përmirësimin e statusit të gruas dhe nxitjen e krijimit të një shoqërie të mundësive të barabarta.

5. KONKLUZIONE

Konkluzione Neni 1

- Shqipëria nuk ka një legjislacion të veçantë që të ndalojë diskriminimin në Shqipëri dhe për pasojë shumë çështje që kanë të bëjnë me diskriminimin e vajzave dhe grave nuk paraqiten para sistemit të drejtësisë, megjithatë parimi i barazisë gjinore përshkon gjithë legjislacionin e brendshëm shqiptar.
- Mungojnë të dhënat që të tregojnë nëse sistemi gjyqësor në Shqipëri ka trajtuar ose jo kërkesa të individëve si pasojë e diskriminimit që mund të ketë ndodhur ndaj tyre.
- Shqipëria ratifikoi Konventën e CEDAW në 11 Maj 1994. Ratifikimi i kësaj konvente nënkupton gjithashtu që shteti shqiptar pranon përcaktimin e diskriminimit të përfshirë në këtë konventë që e përkufizon diskriminimin si “çdo dallim, përjashtim ose kufizim në bazë gjinie, që ka për pasojë ose për qëllim të dëmtojë ose zhvlerësojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin nga gruaja, cilado qoftë gjendja e saj martesore, mbi bazën e barazisë së burrit dhe gruas, të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, në fushat politike, ekonomike, shoqërore, kulturore e civile, ose në çdo fushë tjetër”.
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ndonëse nuk përmban përcaktimin e diskriminimit sanksionon në Nenin 18 se të gjithë janë të barabartë përpara ligjit dhe se askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore etj.

Konkluzione Neni 2

- Në mes të vitit 2004 Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin “Për një Shoqëri Gjinore të Barabartë”. Për shkak të një sërë mangësish të vërejtura gjatë përgatitjes së këtij ligji, Qeveria vendosi që të shikonte mundësinë e amendimeve të reja në këtë ligj. Deri në këtë moment Kuvendi i Shqipërisë nuk i ka marrë ende në shqyrtim amendimet e tij.
- Ndonëse në bazë të standarteve ndërkombëtare kërkohet që vrasjet në emër të nderit të ndiqen penalisht, në legjislacionin penal kombëtar nuk ka dispozita që parashikojnë dënim të tillë.
- Në Kodin Penal, Tortura (neni 86 i K.p.) dhe “Tortura me pasoja të rënda” (neni 87 i K.p.) konsiderohen krime kundër shëndetit dhe dënimet e parashikuara për këto vepra janë të rënda. Por nga monitorimi i procedimeve penale në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë në Tiranë dhe i çështjeve të gjykuara nga gjykata e shkallës së parë në Tiranë për periudhën 2000-2004 nuk rezultojnë të jenë zbatuar këto dispozita për mbrojtjen e grave nga dhuna në marrëdhëniet familjare.
- Përcaktimi jo i plote i torturës në Kodin Penal në lidhje me elemente të tilla, si subjektet, qëllimi i ushtrimit të aktit, shkalla e dhunës etj., mund të ndikojë në referimin dhe zbatimin e rrallë të kësaj dispozite.
- Legjislacioni i brendshëm nuk mundëson ndjekjen penale të rasteve përsa i përket veprave penale që kanë të bëjnë me dhunën në familje pa pasur një ankesë nga vetë viktimat.
- Në vitin 2003 Qeveria e Shqipërisë miratoi Strategjinë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Minoritetit Rom. Qëllimi i Strategjisë është përmirësimi i kushteve të jetesës së këtij minoriteti i cili vuan gjendjen e rëndë ekonomike e sociale në shoqërinë shqiptare. Strategjia Kombëtare i kushton një vëmendje të veçantë grave dhe vajzave rome, forcimit të pozitës së tyre në familjen rome, luftën e çdo forme diskriminimi ndaj grave dhe vajzave rome dhe programeve speciale për këtë grup synues.
- Deri më sot komuniteti egjiptian nuk është njohur si i tillë nga Parlamenti ose Qeveria shqiptare. Komuniteti egjiptian nuk ka gjuhë të vetën, por flet gjuhën zyrtare shqipe. Megjithatë ai dallon nga pjesa tjetër e popullsisë nga tiparet fizike dhe traditat e zakonet që ai ka. Gruaja në komunitetin egjiptian është

dyfish e diskriminuar. Diskriminimi i tyre ndjehet si brenda komunitetit, ashtu edhe nga shoqëria në përgjithësi. Përsa i përket punësimit të grave dhe vajzave egjiptiane, ai është i vështirë për disa arsye, ndër të cilat është niveli i ulët profesional dhe mospranimi i tyre për shkak të përkatësisë së tyre në këtë komunitet, bashkëshoqëruar me të gjitha karakteristikat e familjeve të varfra.

Konkluzione Neni 3

- Neni 17-të i Ligjit për Barazi Gjinore shfuqizon aktet nënligjore që krijojnë Komitetin për Mundësi të Barabarta dhe që përshkruanin organizimin dhe funksionimin e tij.
- Megjithë kërkesat e qarta dhe të vijueshme të organizmave ndërkombëtarë, Mekanizmi për Gruan në vendin tonë nuk është fuqizuar ndonjëherë siç duhet në këto vite, në përputhje me rekomandimet e dhëna në konferencat e ndryshme botërore për gruan, ku Shqipëria ka qenë palë, si dhe me nevojën shoqërore për progres dhe barazi të vërtetë. Padyshim që pamja do të ishte e ndryshme nga sa përjetojmë sot, nëse kërkesat për një status të ri të gruas shqiptare do të ishin vlerësuar si pjesë integrale e zhvillimit të vendit dhe e integritit në BE.

Konkluzione Neni 4

- Ligji për Barazinë Gjinore në Shqipëri (miratuar më 01.07.2004) plotëson kuadrin ligjor lidhur me të drejtat e barabarta mes burrit dhe gruas. Ligji për Barazinë Gjinore futi për herë të parë konceptin e masave të veçanta të përkohshme në legjislacionin shqiptar. Megjithatë, është e paqartë për çfarë procesesh vendimmarrjeje dhe në cilat institucione (zyrat shtetërore, institucionet publike apo private apo të gjitha së bashku) gjen zbatim kjo normë. Veç kësaj, termi “procedurë përzgjedhjeje” lë mjaft hapësirë për interpretim. Ligji duhet të saktësojë nëse trajtimi preferencial do të gjejë zbatim në procesin e marrjes në punë të nëpunësve civile apo të punonjësve të tjerë, apo do të zbatohet edhe për ngritjet në detyrë, trainimet për vendin e punës apo edhe specializime të mëtejshme.
- Barazia gjinore në pushtet dhe vendimmarrje ishte një prej drejtimeve të parashikuara në platformën e qeverisë shqiptare për barazinë midis gruas dhe burrit për periudhën 2002-2005. Por rezultojnë se deri tani nuk është bërë shumë në këtë drejtim pasi nëse shohim raportin femra-meshkuj në qeveri apo parlament rezultojnë se numri i grave është shumë më i vogël se ai i burrave.
- Pavarësisht masave politike dhe legjislative të ndërmarra, barazia mes burrit dhe gruas në realitetin shqiptar nuk egziston dhe është shumë e cënuar në të gjitha fushat e jetës. Kjo sepse nuk egzistojnë mekanizmat e përshtatshëm për monitorimin e zbatimit në praktikë të të gjitha masave të sipërcituara. Po kështu bëhet shumë pak përsa i përket sensibilizimit të vetë kategorive përfutuese dhe veçanërisht grave lidhur me mundësitë që ekzistojnë dhe janë të parashikuara ligjërisht për përmirësimin e situatës së tyre.

Konkluzione Neni 5

- Qeveria Shqiptare nuk ka organizuar fushata kombëtare informimi për të adresuar eliminimin e stereotipeve gjinore. Pjesa më e madhe e kësaj pune është ndërmarrë nga OJF-të që specializohen në çështjet gjinore. Sesione trainimi janë bërë pothuajse në të gjithë Shqipërinë dhe kanë synuar grupe të ndryshme grash dhe burrash të grupmoshave, niveleve arsimore dhe profesioneve të ndryshme.
- Duke qenë se gazetarët dhe reporterët vijnë nga një mjedis që është i mbushur me stereotipe që diskriminojnë gratë, ata janë të prirur të reflektojnë këtë realitet. Një studim që monitoroi se si media e shkruar përshkruante dhunën në familje në 2001-2002 arriti në përfundimin se media përforcon stereotipet gjinore të ndeshura në shoqërinë shqiptare duke etiketuar gratë, një përdorim jo profesional të fjalorit në përshkrimin e grave dhe të gjurmuarit e lajmit sensacional me shumë pak konsideratë për analizën e çështjeve gjinore.

Konkluzione Neni 6

- Ne vitin 2001 shohim një rizgjim të Shtetit shqiptar në luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore, ku më të prekurat ishin vajzat dhe gratë. Për këtë qëllim gjatë viteve 2002-2006, Qeveritë ne vazhdim miratuan një sërë strategjish dhe mekanizmash kombëtarë për të luftuar kundër trafikimit.
- Gjatë vitit 2005-2006 situata e zhvillimit të trafikimit të qënieve njerëzore në Shqipëri ka ndryshuar në formë dhe në përmbajtje. Edhe pse trafiku në vend po vjen në rënie, ai prezantohet tani në dy forma: a) Riciklimit të viktimave përsëri në trafik; b) Trafikimit të brendshëm që zhvillohet nëpërmjet prostitucionit ditor në vend. Nisur nga kjo situatë e krijuar mund të themi se Shqipëria vërtet nuk është më vend tranziti i fenomenit të trafikut të qënieve njerëzore, por ajo vazhdon të mbetet vend i origjinës së tij.
- Në vitin 2004, Parlamenti Shqiptar miratoi ligjin për mbrojtjen e dëshmitarit, ligj ky që ende nuk ka gjetur zbatim për asnjë viktimë të trafikimit dhe prostitucionit. Mangësitë e treguara në zbatim të ligjit si dhe zvarritjet burokratike bëjnë që gratë dhe vajzat të ndjehen të frikësuar dhe për këtë qëllim ato kërkojnë që të largohen përgjithnjë nga Shqipëria.
- Në situatën e vetëvrasjeve të kryera nga femrat ka ndikuar edhe moszbatimi sa dhe si duhet i nenit 99 të Kodit Penal “Shkaktimi i vetëvrasjes”, i cili parashikon se kur kjo veprë ose tentativa e vetëvrasjes është kryer si rrjedhojë e trajtimit të keq sistematik ose nga sjellje që prekin rëndë dinjitetin e personit, është kryer nga personi që e ka në vartësi materiale apo në varësi tjetër, ajo dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

Konkluzione Nenet 7, 8

- Përfaqësimi i grave në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë është në nivele të ulëta. Po bëhen përpjekje nga aktorë të ndryshëm të shoqërisë civile për të rritur pjesëmarrjen e grave në organet politike. Sistemet zgjedhore që praktikohen nuk janë në gjendje të ofrojnë një ekuilibër gjinor të përfaqësuesëve të zgjedhur. Vendosija e sistemit të kuotave po konsiderohet si një mekanizëm mjaft i rëndësishëm.
- Me gjithë arritjet e lëvizjes së gruas në Shqipëri, ajo ende përballet me sfida e vështirësi, si e gjithë shoqëria shqiptare. Ajo çka vihet re është nevoja për bashkëpunim dhe koordinim të aktiviteteve, programeve dhe projekteve, me qëllim që të shtohet impakti i kësaj lëvizjeje në zhvillimet sociale dhe politike të vendit.

Konkluzione Neni 9

- Shtetësia është një e drejtë e cila i garantohet në mënyre të barabartë si burrit dhe gruas në Shqipëri. Legjislacioni që e garanton është në koherencë të plotë me Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit të Gruas.

Konkluzione Neni 10

- Në disa raste legjislacioni shqiptar tregon kujdes të veçantë për arsimimin e grave. Për shembull, Kushtetuta shpall arsimimin e grave në vëshirësi ekonomike dhe sociale si një nga objektivat sociale të Shqipërisë. Kategoritë e personave që përfitojnë nga Ligji për Arsimin dhe Formimin Profesional përfshijnë vajzat-nëna të papuna, vajzat dhe gratë e trafikuar dhe gratë e divorcuara me probleme sociale.
- Arsimi është një nga prioritetet e Platformës së Qeverisë Shqiptare për Barazinë midis Burrit dhe Gruas 2002-2005, e cila përputhet edhe me objektivat e mijëvjeçarit. Përsa i përket çështjes së arsimit, kjo platformë synonte të hidhte hapa përpara në përfshirjen e perspektivës gjinore në të. Por që kjo të mund të arrihet është e rëndësishme që të gjithë në rradhë të parë të kenë të qarta konceptet bazë të barazisë gjinore, dhe kjo mund të realizohet vetëm duke filluar dhënien e këtyre koncepteve që në bankat e shkollës.

- Megjithë përmirësimet e bëra në fushën e arsimimit të minoritetit rrom, braktisja e shkollave nga fëmijët rromë mbetet në nivele të larta. Nisur nga vlerësimi i figurës së femrës në familjet rrome rezultoi se niveli i analfabetizimit të femrës është më i lartë se ai i meshkujve.

Konkluzione Neni 11

- Parimisht, grave në Shqipëri iu garantohen mundësi të barabarta punësimi. Kjo reflektohet në konkurrencën e hapur për pozicione të ndryshme pune në sektorin shtetëror apo privat. Megjithatë, është fakt që në sektorin privat, punësimi varet shumë më tepër nga preferencat e punëdhënësit, sesa nga respektimi i legjislacionit në fuqi. Megjithëse Kodi i rishikuar i Punës e ndalon diferencimin për zgjedhjen e punonjësve/eve në bazë të racës, moshës apo seksit, në realitet ndeshen një sërë praktikash diskriminuuese.
- Pavarësisht përpjekjeve dhe rezultateve pozitive të arritura nga një sërë OJF-sh që veprojnë në fushën e punësimin dhe formimit profesional, me qëllim trajnimin dhe lehtësimin e integritetit të grave nga zonat rurale që kanë migruar në zonat urbane në tregun e punës, nevojiten politika konkrete shtetërore në këtë drejtim.
- Në praktikë, zbatimi i parashikimeve dhe arritja e objektivave të cituara në Strategjinë Kombëtare të Punësimin dhe Formimit Profesional (SPFP), sikurse dhe realizimi me efektivitet i detyrave të institucioneve përkatëse në fushën e punësimin, pengohet dukshëm dhe nga mosnjohja në një masë shumë të madhe të vetë këtyre dokumentave dhe politikave të hartuara për këtë qëllim.
- Përsa i përket shpeshësisë së rishikimit të legjislacionit mbrojtës për të pasqyruar kërkimet dhe konkluzionet më të fundit shkencore, mund të thuhet se legjislacioni shqiptar përputhet pak ose aspak me kërkesat e Konventës së CEDAW-t. Rishikimi i kategorive të vendeve të punës që konsiderohen të rrezikshme për gratë, ndodh shumë rrallë, ose me iniciativën e ministrisë përkatëse, ose për shkak të trysnisë nga OJF-të apo organizatat ndërkombëtare
- Ligji për Barazinë Gjinore detyron punëdhënësit të ndërmarrin masa disiplinore dhe masa të tjera organizative për të luftuar ngacmimin seksual ndaj punonjësve të tyre. Mirëpo për t'i bërë këto të drejta efektive, nevojitet krijimi i mekanizmave proceduriale që i krijojnë mundësi viktimës së ngacmimit seksual të kërkojë mbrojtje gjyqësore, përfshirja në legjislacion e përkufizimit të ngacmimit seksual dhe ndoshta edhe transferimi i barrës së provës mbi punëdhënësin.
- Ministria e Punëve, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta ka organizuar tre programe për nxitjen e punësimin të grave dhe vajzave nga të cilat është siguruar punësimi i 500 grave dhe vajzave me probleme sociale. Nga ky numër, vetëm 86 janë vajza dhe gra rrome, pjesa tjetër i përket pjesës maxhoritare të popullsisë. Edhe pse Ministria është kujdesur të realizojë trajnime dhe kurse profesionale në tetë rrethe të vendit, përfshirja e vajzave rrome ka qenë e ulët. Përfshirja e vogël e grave dhe vajzave rrome në programet e punësimin lidhet ndërmjet të tjerave, me mungesën e ndërgjegjësimin dhe informacionin nga ana e tyre, mungesën e promovimit të kurseve të tilla, mungesën e informacionin dhe menaxhimin jo të mirë të zyrave lokale të punës për sigurimin e një përfshirjeje më të gjerë të këtij minoriteti

Konkluzione Neni 12

- Legjislacioni shqiptar për kujdesin shëndetësor dhe planifikimin familjar përputhet shumë pak me nenin 12 të CEDAW-t. Neni 55 i Kushtetutës shqiptare i garanton cilitdo të drejta të barabarta për kujdesin shëndetësor që ofrohet nga shteti. Gjithsesi, kjo dispozitë mbetet deklarative, ndërsa mungojnë edhe formulime të posaçme që ndalojnë diskriminimin në fushën e kujdesit shëndetësor. Ligji për Kujdesin Shëndetësor është mjaft i vjetër (1963) dhe reflekton një tjetër kulturë juridike. Ndryshime të tij apo edhe një ligj i ri për kujdesin shëndetësor është i domosdoshëm për të reflektuar standartet dhe angazhimet ndërkombëtare ku ka aderuar Shqipëria.

- Legjislacioni shqiptar i ofron mbështetje të posaçme dhe shërbime shëndetësore nënës dhe fëmijës. Megjithë formulimin e tyre, zbatimi i këtyre dispozitave, ashtu si edhe cilësia e shërbimit shëndetësor është e papërshtatshme.
- Legjislacioni shqiptar, ndonëse nuk i diskriminon gratë dhe vajzat e prekura me HIV/AIDS, nuk krijon premisa për të ndihmuar kujdesin, mbrojtjen dhe integrimin e tyre në shoqëri. Dhuna në familje dhe ekspozimi i grave dhe vajzave ndaj fenomeneve si trafikimi dhe shfrytëzimi seksual, janë ndër faktorët më të mundshëm të prekjes së grave nga virusi.
- Dhuna ndaj grave dhe vajzave është një ndër shkaqet dhe pasojat kryesore të infektimit me HIV/AIDS. Këtu kemi parasysh trafikimin e qenieve njerëzore dhe përdorimin e grave dhe vajzave për qëllime të shfrytëzimit seksual, që i ekspozon ato ndaj virusit HIV, punonjëset e seksit etj. Këtu duhet synuar në ndryshimin e nocioneve të stereotipeve të maskilizmit dhe feminizmit që i bën gratë të nënshtruara ndaj burrave jo vetëm në vendim-marrjen. Varësia ekonomike e grave ndaj burrave i bën ato të mos ndjehen të barabarta në familje dhe si rrjedhojë edhe më pak të mbrojtura.
- Gratë në zonat e largëta rurale ende lindin në shtëpi. Në disa raste, personeli mjekësor paguhet nën dorë, ç'ka do të thotë që jo të gjithë pacientët kanë të njëjtën vëmendje për kujdes shëndetësor. Nënave të reja nuk u jepet training në kujdesin e bebeve. Gratë inkurajohen të lënë maternitetin brenda 24 orëve të lindjes.
- Pjesa më e madhe e shërbimeve të planifikimit familjar, duke përfshirë informacionin për planifikimin familjar, ofrohen falas, por jo të gjitha gratë përfitojnë nga këto pasi ato nuk janë të informuara dhe të sigurta që fshehtësia e tyre do të ruhet nga personeli shëndetësor. Aborti është shfaqur gjerësisht si metodë kontrceptive. Nga raport i vitit 2004 i klinikës Mary Stopes/Nesmark rezultoi që 17,000 aborte bëhen çdo vit nga femrat e moshës 25 - 35 vjeç, megjithëse femrat që nga mosha 14 ose 15 vjeç abortojnë. Aborti i bazuar në seksin e fetusit është evidentuar si një dukuri serioze. Ndërsa shërbimet e abortit ofrohen, fushatat që përqëndrohen në pasojat e abortit për shëndetin e femrave janë të nevojshme.

Konkluzione Neni 13

- Legjislacioni shqiptar nuk e përmend shprehimisht barazinë apo mosdiskriminimin e grave në fushën e së drejtës civile. Megjithatë Kodi Civil, legjislacioni bankar dhe ligje të tjera përdorin gjuhë neutrale nga pikëpamja gjinore, të tilla si “çdo person”, “palët”, “personat fizikë”. Kështu Kodi Civil përcakton se të gjithë personat fitojnë zotësinë për të vepruar kur mbushin moshën 18 vjeç dhe që nga ai moment mund të kryejnë lirisht çdo lloj veprimi juridik. Ka raste kur Kodi Civil përdor terma të tilla si “kreditor” apo “pronar” në gjininë mashkullore. Por kjo ndodh kudo në tekstet e ligjeve në Shqipëri. Ndonëse të gjithë, përfshi edhe juristët, me këto terma nënkuptojnë të dy gjinitë, të paktën për ligjet e ardhshme duhet të fillojë të përdoret një gjuhë e veçantë për të dy gjinitë dhe hartuesit duhet të ndërjegjësohen më shumë për problemet gjinore dhe lidhjen e tyre me legjislacionin.
- Kushtetuta shqiptare i garanton kujtdo lirinë artistike dhe krijuese si dhe pjesëmarrjen në kërkimet shkencore (neni 58) ndërsa neni 59 parashikon lirinë e pjesëmarrjes në sporte dhe veprimtari zbatimëse. Sërish gjuha e përdorur është neutrale nga pikëpamja gjinore, por mungojnë dispozitat e posaçme për barazinë dhe mosdiskriminimin e grave në këto fusha të jetës ekonomike e sociale.
- Gratë rrallë aplikojnë për kredi, sepse ato perceptohen zakonisht sikur kanë një rol mbështetës në aktivitetet e biznesit. Gjithashtu, për shumë banka, politika e huasë kërkon që aplikuesi/sja të ketë kapital, ndërsa në të vërtetë pak gra e kanë një gjë të tillë. Mungesa e informacionit kontribuon gjithashtu në paaftësinë për të përdorur efektivisht bankat.

Konkluzione Neni 14

- Në asnjë prej ligjeve dhe akteve nënligjore në Republikën e Shqipërisë nuk bëhet ndonjë diferencim midis gruas në zonat rurale dhe asaj në zonat urbane. Si rrjedhojë gruaja në zonat rurale gëzon të njëjtat

mundësi dhe të drejta si edhe gruaja në zonat urbane. Megjithatë realiteti dëshmon ndryshe. Nisur nga kushtet ekonomike dhe sociale të drejtat që gëzon gruaja në zonat rurale janë shumë herë më të limituara se ajo në zonat urbane. Legjislacioni shqiptar nuk bën ndonjë dallim mes grave të zonave bujqësore apo jobujqësore, ndonëse në praktikë jeta e grave fshatare mund të jetë më e vështirë. Po të kemi parasysh vështirësitë që hasin gratë fshatare, është e rekomandueshme të ndërmerren masa legjislative dhe të tjera që t'u ofrojnë atyre më shumë mundësi.

- Gratë në zonat rurale në Shqipëri mund të jenë të interesuara që të marrin pjesë aktive në planifikimin e zhvillimit në të gjithë nivelet, por ndryshimet strukturore dhe në teknologji kanë sjellë përgjegjësi të reja në familjen rurale, sidomos për gratë. Ngarkesa e dyfishtë e punës prodhuese dhe riprodhuese sot i lë grave pak kohë dhe energji për të marrë pjesë aktivisht në çështjet komunitare.
- Gratë i referohen qendrave mjekësore në qytet, kur kujdesi mjekësor profesionist nuk është i disponueshëm në zonat rurale, por këto janë rrallë të përballueshme financiarisht për to. OJF-të në bashkëpunim me qeverinë vendore, punojnë për të mbushur hendekun informativ në kujdesin e përgjithshëm shëndetësor dhe në veçanti atë për shëndetin riprodhues. Në zonat e largëta është vënë re një mërgim i gjerë ose largim nga detyra prej stafëve mjekësore. Një sërë qendrash shëndetësore janë mbyllur ose punojnë me orar të reduktuar. Qendrat shëndetësore po ndërtohen në komunitete të mëdha prej 2,000-3,000 banorësh.
- Shumica e grave në zonat rurale janë të vetë-punësuar dhe nuk kanë dëshirë ose janë të keqinformuara për të paguar sigurimet shoqërore vetë, që të mund të përfitojnë në moshë të thyer.
- Vajzat në zonat rurale e kanë të vështirë të vazhdojnë arsimin në shkollë të mesme. Në fakt, numri i vajzave në zonat fshatare që ndjekin shkollat e mesme është zvogëluar. Kërkimet tregojnë se në zonat rurale brezi i ri i grave në fshat do të vuajë dënimin shtesë të analfabetizmit.
- Vazhdon të jetë i konsiderueshëm numri i vajzave që braktisin arsimin e detyrueshëm për arsye mentaliteti.

Konkluzione Neni 15

- Në praktikën tonë ligjore gratë dhe burrat kanë mundësi të barabarta për ta paraqitur çështjen pranë gjykatës kompetente. De jure burrat nuk mund të gëzojnë privilegje në krahasim me gratë për shkak të seksit dhe asnjë palë nuk mund të diskriminohet për këtë arsye. Për çdo shkelje të kësaj të drejte gratë mund ti drejtohen Gjykatës Kushtetuese. E drejta për një proces të rregullt ligjor kërkon për shembull gjyqtarë të trainuar mirë, prokurorë, avokatë dhe policë, si dhe burgje të përshtatshme e të tjera lehtësira. Pavarësisht se kjo e drejtë garantohet me ligj, zbatimi në praktikë i legjislacionit ekzistues i cënon gratë nga gëzimi i kësaj të drejte.

Konkluzione Neni 16

- Kodi i Ri i Familjes solli transformime të mëdha në të drejtën familjare, me qëllim eliminimin e diskriminimit të gruas në çështje që kanë të bëjnë me martesën dhe marrëdhëniet familjare. Ai përshkohet tërësisht nga parimi i barazisë midis bashkëshortëve. Të drejtat u njihen të dy bashkëshortëve pavarësisht nga dallimet gjinore, duke qenë kështu në përputhje me normat e parashikuara në nenin 16 të Konventës CEDAW, për të zgjedhur lirisht bashkëshortin dhe për të lidhur martesë vetëm me pëlqimin e vet, të lirë dhe të plotë. Të drejtat dhe detyrimet e bashkëshortëve në martesë janë të njëjta. Detyrimi për të mbështetur bashkëshortin tjetër si moralisht dhe materialisht, për besnikëri dhe bashkëpunim është detyrim reciprok për të dy bashkëshortët.
- Me qëllim zbutjen e pabarazisë së krijuar të bashkëshortëve pas zgjidhjes së martesës, kur banesa familjare është në pronësi të njërit ish-bashkëshort dhe bashkëshorti tjetër nuk ka në pronësi banesë tjetër të përshtatshme, neni 153 i Kodit të Familjes parashikon që gjykata mund të lejojë përdorimin e banesës nga ish bashkëshorti jo-pronar në rastet që vijojnë: i janë lënë fëmijët për rritje dhe edukim dhe kur ish-

bashkëshorti pronar, me ndërprerjen e jetesës së përbashkët, është bërë shkak për zgjidhjen e martesës. Kjo dispozitë është bërë objekt debatesh, nëse në emër të parimit të barazisë së bashkëshortëve çenohet ose jo e drejta e pronësisë së ish- bashkëshortit pronar. Dispozita vazhdon të mbetet deklarative më shumë se sa e zbatueshme. Ndryshimi i rrethanave të ish bashkëshortëve u jep të drejtën këtyre të fundit, për t'ju drejtuar gjykatës.

- Kushtetuta garanton mbrojtje të njëjtë për fëmijët e lindur në martesë dhe jashtë martesë. Në këtë mënyrë gruaja nuk diskriminohet për faktin se ka krijuar një familje pa martesë dhe aq më pak fëmija i lindur, nuk mund të diskriminohet për shkak se ka lindur jashtë martesës.
- Kodi Civil parashikon barazinë midis burrit dhe gruas në lidhje me zotërimin e tokës si pronë e përbashkët e anëtarëve të familjes bujqësore. Pavarësisht garantimit të kësaj të drejte me ligj, në praktikë gruaja diskriminohet duke mos gëzuar të drejta të barabarta mbi pronësinë, e në mënyrë të veçantë në lidhje me transaksionet e ndryshme, të cilat përbëjnë një të drejtë ekskluzive të burrit.
- Administrimi dhe rregullimi ligjor i të drejtave të pronësisë së anëtarëve të familjes bujqësore parashikohet në Kodin Civil në nenet 222-230. Por ka disa aspekte ku shfaqet cënimi i të drejtave të grave në lidhje me pronën bujqësore.

Konkluzione – Gruaja dhe Media

- Roli i medias duhet të jetë ai i informimit të publikut në mënyrë objektive. Si rrjedhojë, pasqyrimi i lajmeve nuk duhet të jetë diskriminues, paragjykes apo mbështetës ndaj stereotipeve ekzistuese shoqërore por duhet të jetë i ndjeshëm ndaj çështjeve të përkatësisë gjinore. Media mund të luajë një rol të rëndësishëm për të arritur ndryshim shoqëror dhe promovuar barazinë gjinore. Prandaj, media mund të jetë një instrument i mirëpërdorur për të emancipuar statusin e grave dhe për të edukuar barazinë midis burrave dhe grave. Eliminimi i këtyre stereotipeve është një përbërës parësor në arritjen e barazisë gjinore, duke promovuar demokraci dhe zhvillim.
- Media ka një rol kyç në paraqitjen e imazheve të individëve dhe si e tillë nuk duhet të veprojë si pasqyrë tradicionale e stereotipeve të krijuara në shoqëri, por duhet të kthehet në një agjent ndryshimi nëpërmjet përfaqësimit ndaj gruas ose paraqitjes të drejtë të aktiviteteve të saj. Media duhet të marrë pjesë në krijimin e një dimensionit të ri të ndarjes të roleve ndërmjet gjinive dhe jo të bjerë pre e mentalitetit ekzistues.
- Mungojnë mekanizmat monitorues për median (sidomos atë të shkruar) për të identifikuar imazhet që janë diskriminuese apo që dhunojnë të drejtat themelore të njeriut gjatë informimit, reklamimit dhe marketimit. Përveç kësaj, nuk ka programe të ndjeshme gjinore të cilat janë të targetuara drejt burrave dhe grave gazetarë për të inkurajuar barazinë dhe shumëllojshmërinë në portretizimin e burrave dhe grave në media. Ajo ç'ka duhet përmendur më veçanërisht është përdorimi i gjuhës mashkullore kur i referohet subjekteve femërore.
- Gazetarët duhet të synojnë për të shqyrtuar dhe prezantuar rrënjën e problemit dhe jo për t'i dhënë lexuesit/es një fashë për të mbuluar problemin. Prezantimi i lajmeve në një mënyrë të cekët, tejet të thjeshtëzuara ose të njëanshme është joetike dhe dhunon të drejtat e individit.
- Duhet medoemos që të zbatohet një kod etik pune në lidhje me çështjet e përfaqësimit në media të individëve pasi një mori artikujsh akuzojnë individë dhe institucione të pabazuar në fakte duke diskriminuar në këtë mënyrë mundësinë e një përfaqësimi të drejtë në media.
- Personeli i medias që nga kryeredaktorët e deri tek reporterët, nga botuesi deri tek gazetari i thjeshtë, duhet të ndërjegjësohen se historitë që ata publikojnë në artikujt e tyre shpesh dhunojnë balancën gjinore e cila është shumë e rëndësishme në konsolidimin e plotë të demokracisë dhe strukturave të saj mbështetëse. Media ka një rol kyç në rritjen e rolit të gruas në procesin demokratik dhe duhet të përpiqet të transmetojë këtë mesazh me çfarëdo lloj mënyre të mundur.

6. REKOMANDIME

Rekomandime Neni 1

- Qeveria dhe Parlamenti shqiptar të nxisë hartimin dhe miratojë një ligj të veçantë për ndalimin e diskriminimit në Shqipëri.
- Krijimi i një database-i me rastet, e marra në shqyrtim dhe të trajtuara nga sistemi gjyqësor në Shqipëri, të individëve si pasojë e diskriminimit që mund të ketë ndodhur ndaj tyre.
- Përfshirja në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të përkufizimit të diskriminimit sipas përcaktimit të bërë në Konventën e Cedaw-t.

Rekomandime Neni 2

- Kuvendi i Shqipërisë të marrë në shqyrtim amendimet e ligjit "Për një Shoqëri Gjinore të Barabartë".
- Në legjislacionin penal kombëtar të futen dispozita që parashikojnë ndjekje penale për vrasjet në emër të nderit.
- Gjykata të zbatojë dispozitat e Kodit Penal në rastet kur një grua dhunohet në marrëdhëniet familjare dhe kjo dhunë ka në përbërje elementet përcaktuese të torturës.
- Të plotësohet përcaktimi i qartë i torturës në Kodin Penal .
- Të bëhen ndryshime në legjislacionin e brendshëm me qëllim që ai të mundësojë ndjekjen penale të rasteve përsa i përket veprave penale që kanë të bëjnë me dhunën në familje pa pasur një ankesë nga vetë viktima.
- Qeveria të marrë masa për zbatimin në kohë dhe me efikasitet të Strategjisë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Minoritetit Rom.
- Parlamenti dhe Qeveria shqiptare të marrin masa për të njohur komunitetin egjiptian si të tillë.

Rekomandime Neni 3

- Këshilli i Ministrave duhet të nxjerrë vendime të reja për krijimin e Komitetit për Barazi Gjinore dhe të rregullojë organizimin dhe funksionimin e tij. Këto masa nënligjore duhet të ndërmerren sa më parë sepse Komiteti për Mundësi të Barabarta (tashmë i quajtur Komiteti për Barazi Gjinore) tani për tani nuk ka status *de jure*.
- Ligjvënësit dhe qeveritarët të qartësojnë dhe fuqizojnë idetë dhe perspektivat përsa i përket mekanizmit shtetëror për gruan dhe mundësitë të barabarta midis grave dhe burrave.

Rekomandime Neni 4

- Parlamenti të miratojë ndryshimet në Ligjin për Barazinë Gjinore.
- Qeveria shqiptare të marrë masa për rritjen e numrit të grave në përbërje të saj, gjithashtu edhe për të detyruar partitë politike të rrisin numrin e kandidatëve femra si për zgjedhjet lokale ashtu dhe ato të pergjithshme.

- Të vendosen dhe funksionojnë mekanizmat e përshtatshëm për monitorimin e zbatimit në praktikë të të gjitha masave politike dhe legjislative të ndërmarra përsa i përket barazisë mes burrit dhe gruas.
- Të rritet sensibilizimi i grave lidhur me mundësitë që ekzistojnë dhe janë të parashikuara ligjërisht për përmirësimin e situatës së tyre.

Rekomandime Neni 5

- Qeveria shqiptare të organizojë fushata kombëtare informimi për të adresuar eliminimin e stereotipeve gjinore.
- Media të punojë për të rritur etikën e saj dhe për ta trajtuar lajmin me konsideratë për analizën e çështjeve gjinore.

Rekomandime Neni 6

- Shteti shqiptar të marrë masa për eliminimin e trafikimit të brendshëm që zhvillohet nëpërmjet prostitucionit ditor në vend.
- Shteti të bëjë të mundur zbatimin me efikasitet të ligjit për mbrojtjen e dëshmitarit si dhe aprovimin e akteve të tjera ligjore me qëllim që ky ligj të interpretohet në mënyrë korrekte.

Rekomandime Nenet 7, 8

- Të vihen në funksionim mekanizma që do të bëjnë të mundur rritjen e përfaqësimit të grave në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.
- Organizatat e grave të rrisin bashkëpunimin mes tyre dhe koordinimin e aktiviteteve, programeve e projekteve.

Rekomandime Neni 10

- Të zbatohet me efikasitet legjislacioni shqiptar për arsimimin e grave dhe veçanërisht Ligji për Arsimin dhe Formimin Profesional që përfshin si kategori përfituese vajzat-nëna të papuna, vajzat dhe gratë e trafikuar dhe gratë e divorcuara me probleme sociale
- Të bëhet e mundur futja në kurikulën e arsimit të detyruar 9-vjecar e koncepteve bazë të barazisë gjinore dhe të luftohet stereotipizimi gjinor në programet dhe tekstet shkollore të të gjitha niveleve.
- Të sigurohet një ndarje e barabartë e grave dhe burrave në hartimin, planifikimin, vendimarrjen, menaxhimin, administrimin dhe shpërndarjen e edukimit dhe sigurimin e përfitimeve të njëjta për burrat dhe gratë në terma të aksesit, pjesëmarrjes dhe shpërndarjes së burimeve.
- Të rritet angazhimi i strukturave shtetërore, shoqërisë civile dhe vetë komunitetit rrom për të ulur nivelin e braktisjes së shkollës nga fëmijët rrom dhe analfabetizmit të gruas rrome.

Rekomandime Neni 11

- Të vendosen mekanizma monitorues për zbatimin në praktikë dhe me efizienz të legjislacionit në fuqi përsa i përket punësimit të vajzave dhe grave.

- Shteti të marrë përsipër hartimin e politikave konkrete me qëllim trajnimin, punësimin dhe lehtësimin e integritit të grave nga zonat rurale që kanë migruar në zonat urbane.
- Shteti të marrë masa për njohjen e ekzistencës dhe përmbajtjes së Strategjisë Kombëtare të Punësimin dhe Formimit Profesional (SPFP), si nga grupet përgjegjëse për zbatimin e saj ashtu edhe nga grupet përfituese.
- Të merren masa për të bërë ndryshime dhe rishikimin e shpeshtë të legjislacionit për sa i përket kategorive të vendeve të punës që konsiderohen të rrezikshme për gratë si dhe për tu përshtatur me kërkimet dhe konkluzionet më të fundit shkencore që ndikojnë në këtë aspekt.
- Të krijohen mekanizmat procedurialë që i japin mundësi viktimës së ngacmimit seksual në 137 vendin e punës të kërkojë mbrojtje gjyqësore si dhe të merren masa për përfshirjen në legjislacion të përkufizimit të ngacmimit seksual.
- Qeveria dhe veçanërisht Ministria e Punëve, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta të marrë masa për nxitjen dhe rritjen e numrit të grave rrome të përfshira në programet e punësimin dhe kurset e trainimit dhe formimit profesional.

Rekomandime Neni 12

- Qeveria dhe Parlamenti të marrë masa për ndryshime dhe rregullime në legjislacionin shqiptar të kujdesit shëndetësor dhe planifikimit familjar, në mënyrë që të jetë në përputhje me standartet e kërkuara ndërkombëtare.
- Shteti të marrë masa për të përmirësuar cilësinë e shërbimit shëndetësor veçanërisht për gratë që presin të bëhen nëna dhe nënat me fëmijë.
- Të organizohen fushata ndërgjegjësuese për sa i përket planifikimit familjar si dhe fushata që të përqëndrohen në pasojat e abortit për shëndetin e femrave.
- Hartimi i politikave të qarta parandaluese të infeksionit HIV midis vajzave adoleshente, fokusuar sidomos në rritjen e aksesit për shëndetin riprodhues;
- Reduktimi i dhunës ndaj grave duke promovuar tolerance zero ndaj të gjithë formave të dhunës ndaj grave dhe vajzave.
- Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave humane të grave dhe vajzave. Mbrojtja e të drejtave njerëzore të grave dhe vajzave është gjithashtu mbrojtje e tyre nga HIV/AIDS-i.
- Sigurimi i aksesit për kujdes, trajtim dhe mbështetje për gratë dhe vajzat që janë HIV pozitiv. Fuqizimin e kujdesit bazë me fokus të veçante tek gratë dhe vajzat.
- Promovimi i aksesit të zhvillimeve të fundit të teknologjisë në fushën e parandalimit të transmetimit të virusit HIV. Shtimi i njohurive për këto metoda forcon jo vetëm respektin dhe përgjegjësinë në një marrëdhënie seksuale, por njëkohësisht ndikon dhe në fuqizimin e grave dhe vajzave të mbrojnë vetveten dhe partnerin e tyre seksual.
- Mbështetja dhe promovimi i programeve që synojnë forcimin e rolit të grave dhe edukimin e tyre në mënyrë që tek vajzat adoleshente dhe gratë të rritet shkalla e njohurive në fushën e parandalimit të infeksionit HIV.
- Hartimi dhe promovimi i politikave të përparandalimit të transmetimit të virusit HIV nga nëna tek fëmija si një faktor i rëndësishëm për të patur një brez të ri larg HIV/AIDS-it. Fuqizimi i kontrollit dhe marrjes së masave për parandalimin e transmetimit nga nëna tek fëmija do të ndihmojë gjithashtu në uljen e stigmës dhe diskriminimit ndaj grave HIV pozitive që konsiderohen si vektore të transmetimit të virusit.

Rekomandime Neni 13

- Të bëhen ndryshime dhe rregullime në legjislacionin shqiptar që të përmenden shprehimisht barazia dhe mosdiskriminimi i grave në fushën e së drejtës civile dhe gjithashtu të përdoret një gjuhë e veçantë për të dy gjinitë duke u ndërgjegjësuar për problemet gjinore dhe lidhjen e tyre me legjislacionin.
- Të hartohen e miratohen dispozita të posaçme në nenet 58 e 59 të Kushtetutës për barazinë dhe mosdiskriminimin e grave në fusha të tilla të jetës ekonomike e sociale si sporti, veprimtaritë zbavitëse, krijimtaria, shkenca etj.
- Shteti në bashkëpunim me bankat të krijojë politika që të lehtësojnë procedurat dhe t’ju japin përparësi grave në marrjen e huave apo kredive.

Rekomandime Neni 14

- Të hartohet dhe miratohet legjislacion i veçantë për gratë fshatare dhe të krijohen mundësitë për ta aksesuar dhe zbatuar ligjin duke u nisur nga fakti që për gratë në zonat rurale mundësitë janë shumë herë më të kufizuara, për shkak të kushteve që lidhen edhe me zakonet dhe traditat në zonat rurale.
- Shteti të marrë masa për të inkurajuar dhe lehtësuar pjesëmarrjen e grave fshatare në planifikimin e zhvillimit në të gjithë nivelet në çështjet komunitare.
- Shteti të marrë masa për të mbushur hendekun informativ të grave fshatare në kujdesin e përgjithshëm shëndetësor dhe në veçanti atë për shëndetin riprodhues si dhe të bëjë të mundur funksionimin e qendrave mjekësore edhe në zonat e largëta rurale.
- Të organizohen fushata sensibilizuese në zonat rurale për të ndërgjegjësuar gratë fshatare për rëndësinë e kontributeve shoqërore për të përfituar pension pleqërie.
- Shteti të marrë masa për të sensibilizuar dhe rritur numrin e vajzave fshatare që ndjekin shkollën e mesme.
- Të zbatohet ligji nga Drejtoritë e shkollave dhe njësitë Vendore Bashkiake apo Komunitat, për gjatësinë e familjarëve që i detyrojnë fëmijët e tyre të braktisin shkollën.

Rekomandime Neni 15

- Shteti të marrë masa për zbatimin me efikasitet në praktikë të legjislacionit ekzistues që garanton të drejtën e grave për një proces të rregullt ligjor. Të merren masa për trainimin e gjyqtarëve, prokurorëve, policëve etj., që mund të ndikojnë në zbatimin e kësaj të drejte.

Rekomandime Neni 16

- Shteti të marrë masa për zbatimin në praktikë të nenit 153 të Kodit të Familjes, i cili parashikon që gjykatat mund të lejojnë përdorimin e banesës nga ish bashkëshorti jo-pronar në disa raste të përcaktuara, pasi kjo dispozitë vazhdon të mbetet deklarative më shumë se sa e zbatueshme.
- Shteti të marrë masa për të zbatuar në praktikë Kodin Civil, për ti garantuar gruas të drejta të barabarta me burrin mbi pronësinë, në lidhje me zotërimin e tokës si pronë e përbashkët e anëtarëve të familjes bujqësore e në mënyrë të veçantë në lidhje me transaksionet e ndryshme.
- Të bëhen ndryshime dhe rregullime në nenet 222-230 të Kodit Civil që parashikojnë administrimin dhe rregullimin ligjor të të drejtave të pronësisë së anëtarëve të familjes bujqësore pasi ka disa aspekte ku shfaqet cënimi i të drejtave të grave në lidhje me pronën bujqësore.

Rekomandime Gruaja dhe Media

- Qeveria të ristrukturojë politikën e saj të përfshirjes së grave në politikë dhe pasqyrimin e tyre në median elektronike dhe atë të shkruar për të siguruar mundësi të barabarta vizibiliteti të të dyja gjinive.
- Qeveria të marrë masa për përfshirjen e punonjësve të medias në trajnime apo programe të ndryshme për të kuptuar rëndësinë e promovimit të barazisë gjinore, për portretizimin e grave jo-tradicionale si dhe vënia në qendër të vëmendjes e fakteve se çfarë dëmsh ekonomike dhe shoqërore shkakton nënvlerësimi i gruas në shoqëri.
- Të stimulohet zhvillimi dhe përdorimi i metodave të informimit publik si dhe fushatave mediatike të ndryshme mbi rolin e burrave dhe grave me tendencë arritjen e barazisë gjinore në kuadër të arritjes të mundësive të barabarta për të dy palët.
- Të vendosen mekanizma monitorues për median për të identifikuar imazhet që janë diskriminuese apo që dhunojnë të drejtat themelore të njeriut gjatë informimit, reklamimit dhe marketimit.
- Gazetarët të bashkëpunojnë me profesionistë të fushave të ndryshme për të dhënë informacion në brendësi të çështjes kur ky i fundit nuk është i mjaftueshëm.
- Shteti të marrë masa për të vendosur dhe zbatuar një kod etik pune në lidhje me çështjet e përfaqësimit në media të individëve.

ANEKS 1

DATABASE I OJF-VE QE PUNOJNE PER GRATE DHE VAJZAT

DATABASE I OJF-ve QE PUNOJNE PER GRATE DHE VAJZAT

TIRANE

1. SHOQATA “REFLEKSIONE”

Person kontakti: Monika Asllani
Adresa: Rr. e Elbasanit, Pall. “Fratari”, Tershan 2, Kati 1, Tirane
Tel. 04 340433/4
E-mail: refleksione@albnet.net refleksione@icc-al.org
Web page: www.refleksioneassoc.org

2. QENDRA E KESHILLIMIT PER GRA DHE VAJZA

Person kontakti: Iris Luarasi
Adresa: Rr. : Sami Frasheri”, Tirane
Tel. 04 233408/9
E-mail: qkgv@albnet.net

3. QENDRA E ALEANCES GJINORE PER ZHVILLIM

Person kontakti: Eglantina Gjermani
Adresa: Rr. “Abdyl Frasheri”, Pall. 10, shk. 1/3, Tirane
Tel. 04 255514/5
E-mail: qdi@gadc-al.org info@gadc-al.org
Web page: www.gadc-al.org

4. QENDRA PER NISMA LIGJORE QYTETARE

Person kontakti: Aurela Anasatasi
Adresa: Rr. “Vaso Pasha”, Pall. 12, Shk.1, Ap.1, Tirane
Tel. 04 259795
E-mail: avokatore@albmail.com
Web page: www.qag-al.org

5. FORUMI I PAVARUR I GRUAS SHQIPTARE

Person kontakti: Valbona Kaso
Adresa: Rr. “Brigada VIII”, Pall. Tekno Projekt, Shk.1, Ap.5/3, Tirane
Tel. 04 228181/ 228309
E-mail: fgpsh@albnet.net

6. QENDRA SHQIPTARE PER POPULLSINE DHE ZHVILLIMIN

Person kontakti: Elona Gjebrea
Adresa: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Kompleksi “Tirana 2000” Kulla IV, Tirane
Tel. 04 224269
Cel. 0682053255
E-mail: egjebrea@acpd-al.org
Web page: www.acpd-al.org

7. NE DOBI TE GRUAS SHQIPTARE

Person kontakti: Sevim Arbana
Adresa: Rr. “Naim Frasheri”, Nr. 8, Tirane
Tel. 04 223001
Cel. 0692095973
E-mail: sevim@icc-al.org cfsh@icc-al.org

8. GRATE DHE MEDIA

Person kontakti: Elsa Xhaji
Adresa: Radio Tirana, Tirane
Tel. 04 250582
Cel. 0682210064

9. GRUPI SHQIPTAR I GAZETAREVE

Person kontakti: Briseida Mema
 Adresa: Rr. "Muhamet Gjollështa", Pall. 69, Ap.28, Tirane
 Tel. 04 235978
 Cel. 0682020731
 E-mail: briseida.mema@afp.com

10. INSTITUTI I POLITIKAVE TE APLIKUARA GJINORE

Person kontakti: Miranda Fishkaj
 Adresa: Rr. "Shyq yri Bercolli", Nr.1, Tirane
 Tel. 04 225298
 E-mail: mfishka@icc-al.org

11. NE NDIHME TE FEMIJEVE JETIME

Person kontakti: Hajrie Hasanaj
 Adresa: Bulevardi "Zogu I", Godina 55, Kati III, Nr.10, Tirane
 Tel. 04 259593
 Cel. 0682150878
 E-mail: hajriehasanaj@yahoo.com

12. SHOQATA "GRATE NE ZHVILLIM"

Person kontakti: Jeta Katro
 Adresa: Rr. "Abdyl Frasheri", Pall. 9, Shk. 5, Tirane
 Tel. 04 227747
 E-mail: jkatro@albmail.com

13. PER GRATE DHE FEMIJET

Person kontakti: Rajmonda Prifti
 Adresa: Rr. "H. Cenaj", Vila 5, mbrapa ish-mapos, Kombinat, Tirane
 Tel. 04 352830
 E-mail: genderkombinat@albaniaonline.net mondaprifti@albmail.com

14. FEDERATA E GRAVE SHQIPTARE PER PAQE BOTERORE

Person kontakti: Katarzina Minollari
 Adresa: Rr. "P. Budi", Pall. 72/7, ap.7, Kutia postare 8354, Tirane
 Tel. 04 340248
 E-mail: kasiamin@yahoo.co.uk

15. QENDRA PER ZHVILLIMIN E GRAVE RURALE

Person kontakti: Drita Babameto
 Adresa: Rr. "M. Gjollështa", Pall. 64/1, shk.1, ap.11, Tirane
 Tel. 04 230270
 Cel. 06924 02527
 E-mail: cdrw@albmail.com

16. NE NDIHME TE FEMIJEVE TE VECANTE

Person kontakti: Zhuljeta Demi
 Adresa: Rr. "Labinoti", Pall. Fratari 2/8 C, Tirane
 Tel. 04 373072
 E-mail: demizh@yahoo.com

17. KOMITETI LOKAL I GRAVE BAHAI

Person kontakti: Vera Shiko
 Adresa: Rr. "Dibres", nr. 59, Tirane
 Tel. 04 240464 / Cel. 0682020994
 E-mail: spartash@icc-al.org

18. SHOQATA "GRA PA PERKRAHJE"

Person kontakti: Marie Vjollca
 Adresa: Rr. e Elbasanit, Pall. Fratari Tershana 2, shk.1, Tirane
 Tel. 04 344743
 E-mail: grapaperkrahje@abissnet.com.al

19. SHOQATA E NENAVE ME FEMIJE JETIME

Person kontakti: Angjelina Dine
 Adresa: Rr Kavajes, God. e Librit dhe Filmit, Kutia postare 2415, Tirane
 Tel. 04 230916
 Cel. 0682889081

20. SHOQATA E GRAVE PROFESIONISTE DHE AFARISTE TE SHQIPERISE

Person kontakti: Flutura Xhabija
 Adresa: Rr “Duresit”,nr. 36, kt. II, Tirane
 Tel. 04 235726
 Cel. 0682763344
 E-mail: shgpa@icc-al.org
 Web page: www.shgpa.org.al

21. NDIHMONI JETEN

Person kontakti: Aferdita Seiti
 Adresa: Rr “Hoxha Tasim”,nr. 187/1, Tirane
 Tel. 04 345859
 Cel. 0692217430
 E-mail: ndihmonijeten@interalb.net

22. SHOQATA KOMBETARE E NENAVE ME FEMIJE JETIME NE SHQIPERI

Person kontakti: Engjellushe Dushollari
 Adresa: Rr. “Thanas Ziko”, Pall. 65, shk.1, ap. 12, Tirane

23. SHOQATA “PERTHYERJA”

Person kontakti: Marinela Sota
 Adresa: Rr “Don Bosko”, sheshi “Miqesia”, prane shkolles “Qazim Turdiu”, Kutia postare 2989, Tirane
 Cel. 0682167154
 E-mail: sotamarinela@hotmail.com

24. SHOQATA SHQIPTARE “GRUAJA KRYEFAMILJARE”

Person kontakti: Luljeta Hysa
 Adresa: Rr “Mihal Grameno” pall. 12, shk. 2/27, Tirane
 Tel. 04 235844/224431
 Cel. 0682702463
 E-mail: flourtirana@albaniaonline.net

25. SHOQATA KRISTIANE E GRAVE SHQIPTARE

Person kontakti: Donika Godaj
 Adresa: Rr “Mujo Ulqinaku”, nr. 2/1, Kutia postare 2970, Tirane
 Tel. 04 248699/271642
 Cel. 0692062051
 E-mail: ywca@abissnet.com.al

26. QENDRA KULTURORE “LINDART”

Person kontakti: Eleni Laperi
 Adresa: Rr “Siri Kodra”, pall. 9, shk. 1, ap. 4, Tirane
 Tel. 04 237579
 Cel. 0692190505
 E-mail: lindart@abissnet.com.al
 Web page: www.lindart.org

27. MEDICA MONDIALE

Person kontakti: Neta Lohja
 Adresa: Rr. “Qemal Stafa”, nr.62, Tirane
 Tel. 04 220509
 E-mail: medicamondiale@icc-al.org
 Web page: www.medicamondiale.org

28. STREHEZA PER GRATE DHE VAJZAT E DHUNUARA

Person kontakti: Edlira Haxhiymeri
 Adresa: Tirane
 E-mail: edlira1960@yahoo.com ela_kulluri@yahoo.com

29. QENDRA PER MBROJTJEN E TE DREJTAVE TE FEMIJEVE NE SHQIPERI - CRCA

Person kontakti: Altin Hazizaj
 Adresa: P. O. Box 1738, Tirane
 E-mail: crca@crca.org.al
www.crca.org.al

RRETHE

1. QENDRA E KESHILLIMIT PER GRA DHE VAJZA, BERAT

Person kontakti: Liljana Çela
 Adresa: Pallati i Kultures Berat
 Tel. 032 31004
 E-mail: qkgvberat@yahoo.com

2. SHOQATA PER MBROJTJEN E TE DREJTAVE TE GRAVE QYTETARE DHE FSHATARE

Person kontakti: Arta Dyrmishi
 Adresa: Shtepia e Oficereve, Kt. 2, Berat
 Cel. 0682298134
 E-mail: artadyrmishi@yahoo.com

3. QENDRA E GRUAS BERAT

Person kontakti: Lefteri Kosova
 Adresa: Lgj. 22 Tetori, Berat
 Tel. 032 31004

4. SHOQATA E GRAVE ME PROBLEME SOCIALE

Person kontakti: Bajana Çeveli
 Adresa: Rr. “Baki Çelmeta”, Durres
 Tel. 052 23815
 E-mail: gendraekeshillimit@yahoo.com

5. QENDRA KOMUNITARE PER INTERGRIMIN E FEMIJEVE DHE NENAVE NE NEVOJE “DELFINET E VEGJEL”

Person kontakti: Fabiola Egro
 Adresa: Rr. “Prokop Sorra”, Lgj. e ish-Kenetes, Durres
 Tel. 052 32709
 E-mail: dolphins_durres@yahoo.com
uaw@icc-al.org

6. KUJDESI I GRUAS

Person kontakti: Doriana Papajani
 Adresa: Bulevardi Kryesor, Lgj. 11, Pall. 358, Ap. 4, Durres
 Tel. 052 27355
 E-mail: woman2alorg@yahoo.com

7. FORUMI I GRUAS ELBASAN

Person kontakti: Shpresa Banja
 Adresa: Rr. “28 Nentori”, Lgj. “Aqif Pasha”, Pall. 77/5, Elbasan
 Tel. 054 54516
 E-mail: ccawgel@enet.org.al

7. NE DOBI TE GRUAS SHQIPTARE, ELBASAN

Person kontakti: Bukuroshe Manaj
 Adresa: Rr. "11 Nentori", Lgj. "Sytja Dylgjieri", Elbasan
 Tel. 054 57582
 E-mail: manajb@enet.org.al

8. SHOQATA "GRUAJA DHE E ARDHMJA"

Person kontakti: Sabrie Xhaferri
 Adresa: Lgj. "Luigj Gurakuqi", Pall. 42/A, Elbasan
 Tel. 054 56473

9. SHOQATA "NENA, FEMIJET, E ARDHMJA"

Person kontakti: Natasha Buzali
 Adresa: Rr."Kryengritja e Qershorit", Nr. 4, Korce
 Tel. 082 42239

10. SHOQATA "SHPRESA"

Person kontakti: Evelina Mitace
 Adresa: Rr."Kristaq Kirka", Nr. 11, Korce
 Tel. 082 44216

11. KLUBI SOCIAL KORCE

Person kontakti: Violeta Tici
 Adresa: Rr."Sotir Gura", Nr. 14/1, Korce
 Tel. 082 50538
 E-mail: leta@albmail.com

12. GRUAJA KORCARE

Person kontakti: Klara Çela
 Adresa: Rr."Dhimiter Derasi", Nr. 3, Korce
 Tel. 082 43563/43353

13. GRUAJA NE ZHVILLIM KUKES

Person kontakti: Lumturie Baja
 Adresa: Kukes
 Tel. 0242 2216

14. QENDRA E KESHILLIMIT, POGRADEC

Person kontakti: Afroviti Gusho
 Adresa: Rr."Reshit Çollaku", Pogradec
 Tel. 083 22140
 E-mail: viti@adanet.com.al

15. SHOQATA "REFLEKSIONE", POGRADEC

Person kontakti: Lindita Merolli
 Adresa: Rr."Reshit Çollaku", Lgj. 1, Pogradec
 Tel. 083 22115
 E-mail: refleksionepo@albnet.net

16. UNE, GRUAJA

Person kontakti: Irena Kacori
 Adresa: Rr."Reshit Çollaku", Pogradec
 Tel. 083 25104
 E-mail: une_gruaja@yahoo.com

17. QENDRA E KESHILLIMIT PER GRA DHE VAJZA, SHKODER

Person kontakti: Diana Lekaj
 Adresa: Rr."13 Dhjetori", Shkoder
 Tel. 022 42213
 E-mail: qkgv@albnet.net

18. SHOQATA “REFLEKSIONE” SHKODER

Person kontakti: Aferdita Mushani
Adresa: Rr.”Marlin Barleti”, Lgj. “Ndoc Madhi”, Pall. 166, Shkoder
Tel. 022 48444
E-mail: refleksioneshk@albnet.net

19. GRUAJA NE ZHVILLIM, SHKODER

Person kontakti: Anila Trebicka
Adresa: Rr.”Marlin Barleti”, Lgj. “3 Heronjte”, Pall. 161, Shkoder
Tel. 022 47525
E-mail: widanila@albnet.net

20. GRUAJA TEK GRUAJA

Person kontakti: Majlinda Angoni
Adresa: Rr.”Marlin Barleti”, siper Kristalit, Shkoder
Tel. 022 41154
E-mail: gtg@adanet.com.al

20. QENDRA E GRUAS “HAPAT E LEHTE”

Person kontakti: Alketa Leskaj
Adresa: Rr.”Branko Kadia”, Lgj. “3 Heronjte”, Shkoder
Tel. 022 44022
E-mail: qendragruash@adanet.net

21. QENDRA PSIKO-SOCIALE “VATRA”

Person kontakti: Vera Lesko
Adresa: Rr.”Pirro Bisha”, Vlore
Tel. 033 27509
E-mail: Q.P.S-Vatra@aul.sanx.net

22. GRUAJA PER ZHVILLIMIN E TURIZMIT

Person kontakti: Nertila Sadedini
Adresa: Rr.”Ali Demi”, Lgj. “Partizani”, Nr. 532, Vlore
Tel. 033 25842
E-mail: nerti71@yahoo.com

23. GRUPIMI “VATRA E GRUAS VLONJATE”

Person kontakti: Liljana Gjika
Adresa: Biblioteka e qytetit, Vlore
Tel. 033 24070